

NDIKIMI I KOMUNIKIMIT POLITIK MEDIATIK NË KRIJIMIN E SOVRANITETIT SHTETËROR TË KOSOVËS GJATË PERIUDHËS 1998 -2008

NJOMZA KRASNIQI

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Sociale, me profil Shkenca Politike dhe Marrëdhënie
Ndërkombëtare, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof.Asoc.Dr. Gilman Bakalli**

Numri i fjalëve: 54,886

Tiranë, Janar 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj dhe konfirmoj se ky punim i doktoraturës me titull “Ndikimi i komunikimit politik mediatik në krijimin e sovranitetit shtetëror të Kosovës, gjatë periudhës 1998-2008”, është një studim i realizuar nga unë dhe si i tillë, paraqet rezultatin e punës sime origjinale, bazuar në hulumtimet që kam bërë dhe në literaturën që kam lexuar, të cilat janë deklaruar tek pjesa e referencave dhe bibliografisë.

Studimi në fjalë, më parë nuk është dorëzuar pjesërisht apo në tërësi, për ndonjë gradë tjetër shkencore në këtë universitet, apo në ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë.

Gjithashtu, deklaroj se punimi nuk përmban material të shkruar apo të botuar nga një autor i tretë. Është respektuar e drejta e autorit në të gjitha të dhënat që përfshijnë ide të autorëve të tjerë, duke ua njohur autorësinë në formë reference dhe citimi, sipas rregullave të shkrimit akademik.

Me përgjegjësi të plotë deklaroj se ky disertacion është punë imja origjinale dhe në përputhje me parimet etike të publikimeve dhe se jam e vetëdijshme për pasojat e një deklarimi të rrejshëm.

Tiranë, Qershor 2015

Emri i autorit:

Doktorante Njomza KRASNIQI

Nënshkrimi _____

DEDIKIMI

Ky punim i dedikohet familjes sime, në veçanti dy personave që nuk janë më në këtë botë, por që në vazhdimësi ishin nxitësit e mi drejt suksesit.

FALËNDERIME

Para së gjithash, falënderimet ia dedikoj Universitetit Evropian të Tiranës, për mundësinë që më ofroi për të qenë pjesë e Programit të Doktoratës. Në veçanti, jam mirënjohëse ndaj stafit akademik të UET, pa mbështetjen e të cilëve nuk do të arrija këtu.

Falënderime të përzemërta i kushtoj udhëheqësit të temës, PhD. Gilman Bakalli, idetë, këshillat, sugjerimet dhe kritikën e të cilit më kurorëzuan me suksesin. Gjithashtu, vlerësoj shumë kontributin e pjesëtarëve të tjerë të stafit akademik të UET, që me ekspertizën dhe përvojën e tyre më ndihmuan në strukturimin dhe përmbylljen e këtij rrugëtimi të gjatë. Veçanërisht, falënderoj PhD. Henri Çili, Dr. Belina Budini dhe të gjithë ata që më ndihmuan, në një mënyrë apo tjetër, për formulimin, strukturimin dhe përmbylljen e këtij punimi.

Falënderoj familjen time për nxitjen dhe mbështetjen gjatë gjithë kohës, prindërit e mi dhe gjyshen time, që më edukuan me një dashuri ndaj shkollës dhe shkencës.

Mirënjohje dhe falënderime gëzojnë edhe persona të tjerë të zemrës, miq, të cilët në formë të ndryshme më kanë mbështetur në vazhdimësi, pa të cilët sukcesi do të ishte i përgjysmuar.

Së fundmi, dëshiroj të theksoj se optimizmi dhe motivimi i vazhdueshëm drejt këtij sukcesi, është kontribut i të gjithë atyre që më qëndruan pranë dhe që më janë përgjigjur në momente sa të vështira, po aq të rëndësishme për mua. Për të gjithë ju, emrat e të cilëve nuk i kam përmendur, por që për mua jeni të paharruar, ju jam mirënjohëse!

Faleminderit

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Numri i artikujve për Kosovën, gjatë periudhës 1990-1998, të ndarë sipas tematikës sociale, politike, keqtrajtim i shqiptarëve.

Tabela 2: Numri i artikujve për Kosovën, gjatë periudhës 1999, të ndarë sipas tematikës humane dhe raportim lufte.

Tabela 3: Numri i artikujve për Kosovën gjatë periudhës 2000, të ndarë sipas tematikës humane dhe raportim lufte.

Tabela 4: Numri i artikujve për Kosovën gjatë periudhës 2001-2007, të ndarë sipas tematikës humane, raportim lufte, zhvillime politike.

Tabela 5: Të dhënat për përmendjen e Kosovës në mediat ndërkombëtare gjatë periudhës kohore 2008-2012, të ndarë sipas tematikës sociale, politike, krime lufte.

Tabela 6: Videot e analizuar të BBC për periudhën 1990-1998, cilësimet për Kosovën.

Tabela 7: Videot e analizuar të BBC për periudhën 1999, cilësimet për Kosovën.

Tabela 8: Videot e analizuar të BBC për periudhën 2000, cilësimet për Kosovën.

Tabela 9: Videot e analizuar të BBC për periudhën 2001-2007, cilësimet për Kosovën.

Tabela 10: Videot e analizuar të BBC për periudhën 2008-2012, cilësimet për Kosovën.

Tabela 11: Videot e analizuar të CNN për periudhën 1990-1998, cilësimet për Kosovën.

Tabela 12: Videot e analizuar të CNN për periudhën 1999, cilësimet për Kosovën.

Tabela 13: Videot e analizuar të CNN për periudhën 2000, cilësimet për Kosovën.

Tabela 14: Videot e analizuar të CNN për periudhën 2001-2007, cilësimet për Kosovën.

Tabela 15: Videot e analizuar të CNN për periudhën 2008-2012, cilësimet për Kosovën.

Tabela 16: Videot e analizuar të REUTERS për periudhën 1990-1998, cilësimet për Kosovën.

Tabela 17: Videot e analizuar të REUTERS për periudhën 1999, cilësimet për Kosovën.

Tabela 18: Videot e analizuar të REUTERS për periudhën 2000, cilësimet për Kosovën.

Tabela 19: Videot e analizuara të REUTERS për periudhën 2001-2007, cilësimet për Kosovën.

Tabela 20: Videot e analizuara të REUTERS për periudhën 2008-2012, cilësimet për Kosovën.

Tabela 21: Burimet e informacionit të përdorura nga BBC, CNN, REUTERS, në periudha kohore të ndara në vite.

Tabela 22: Lista dhe funksionet e të intervistuarve.

Tabela 23: Krahësimi i Kosovës me Pakistanin (Jammu, Kashmire) dhe Tajvanin. Analizë e përdorimit të cilësimeve: pavarësi, gjenocid (përndjekje), refugjatë, në periudha kohore të ndryshme, në tri mediumet në studim.

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

BBC	British Broadcasting Company (Kompania Britanike e Transmetimeve)
CNN	Cable News Network (Rrjeti Kabllor i Lajmeve)
BE	Bashkimi Evropian
NATO	North Atlantic Treaty Organization
WDR	World Development Reports – World Bank
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
KE	Këshilli i Evropës
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNHCR	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

ABSTRAKT

Studimi trajton pasqyrimin mediatik të Kosovës dhe funksionin e mediave ndërkombëtare në procesin e shtetformimit dhe krijimit të sovranitetit të ri shtetëror të Kosovës. Periudha e përfshirë në studim është 1998-2008 (faza e konfliktit në Kosovë, deri në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008). Është pikërisht periudha kohore ndërmjet viteve '98-'99, ajo që pëson ndryshimin më të madh në formatin e trajtimit mediatik dhe në mënyrën se si perceptohet Kosova. Por, pse ndodhi kjo, çfarë realiteti u ndërtua për Kosovën në këtë periudhë? Si krijoi media precedentë ndërkombëtarë për konfliktin në Kosovë?

Impakti i medias në politikat e jashtme botërore, apo i quajtur ndryshe 'The CNN Effect', nuk është më thjesht një risi, por është kthyer në një rutinë faktike. Këndi i trajtimit mediatik ndaj Kosovës ndryshoi si pasojë e prezencës së gazetarëve ndërkombëtarë në vend të ngjarjes.

Në këtë studim është paraqitur edhe mënyra se si media cilësoi dhe ndërtoi imazhin e Kosovës ndër vite, brenda periudhës së përfshirë në studim.

Bazimi faktik i studimit është kryesisht tek arkivi i mediave elektronike që kanë luajtur një rol kryesor në pasqyrimin e ngjarjeve në Kosovë, që janë CNN, BBC dhe REUTERS.

Metodat e kërkimit të aplikuara janë: Rishikimi i literaturës si vështrim i teorive dhe hulumtimeve shkencore ekzistuese; Analizë teksti dhe ligjërimi që aplikohet te artikujt për Kosovën; Analizë sasiore në funksion të evidentimit të pasqyrit mediatik konstant dhe ndryshimeve të pësura në vite të caktuara; Intervista cilësore.

Fjalë kyçe: Media, Impakti, Roli i Medias, Sovraniteti, Kosova, Kriza.

ABSTRACT

The study treats an overview of media in Kosovo and the functioning of foreign media in the process of statehood and establishment of the new state sovereignty of Kosovo. The period referred to in the study is from 1998 to 2008 (i.e. the phase of conflict in Kosovo up to the Declaration of Kosovo's Independence on 18 February, 2008). It was the period between 1998 – 1999 the time when Kosovo underwent greater changes in the format of media coverage and the way in which Kosovo was perceived. But how did this come about, and what kind of reality was created towards Kosovo during this period? How did the foreign media create a precedent for the conflict in Kosovo?

The impact of media in the global foreign policies, also known as “The CNN Effect”, is no longer a novelty, but instead it has become a factual routine. The angle of media coverage changed as a result of the presence of foreign reporters at the scene.

This study shows also the way according to which the media described and constructed the image of Kosovo over the years, within the period indicated in the study.

The factual basis of the study is mainly focused on the electronic media archive which played a leading role at the reflection of the events in Kosovo, such as CNN, BBC and REUTERS.

The applied research method will be: literature revision by reviewing existing scientific research and theories; textual analysis and language applied to articles on Kosovo; quantitative analysis in function of the recording of constant media coverage and of the changes occurred during specific years; qualitative interviews.

Key words: Media, Impact, Role of the Media, Sovereignty, Kosovo, Crises.

Përmbajtja e lëndës

DEKLARATA E AUTORËSISË.....	III
DEDIKIMI	IV
FALËNDERIME.....	V
LISTA E TABELAVE.....	VI
LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT	VIII
ABSTRAKT	IX
ABSTRACT	X
Përmbajtja e lëndës	XI
KAPITULLI I: HYRJE	1
1.1 Si u trajtua Kosova nga mediat ndërkombëtare?	1
1.2 Roli i medias në krizën e Kosovës (<i>Objekti i studimit</i>)	2
1.3 Hipoteza dhe pyetja kërkimore	5
1.4 Kufizimet e studimit	8
1.5 Metodologjia	9
1.5.1 Kufizimet metodologjike dhe vështirësitë gjatë kërkimit	17
1.6 Organizimi dhe struktura e punimit.....	26
KAPITULLI II: SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK.....	30
2.1 Debate bashkohore mbi metoda dhe teori të aplikuara	30
2.3 Gjeneza dhe evoluimi në shoqëritë masmediatike	36
2.4 Media si institucion social.....	37
2.5 Efikasiteti i mediave dhe roli i tyre	40
2.6 Media, ndikimi në qeverisje	46
2.7 Teoritë klasike dhe moderne	51
2.7.1 Teoria autoritare	51
2.7.2 Libertarianizmi ose teoria e shtypit të lirë.....	52
2.7.3 Teoria - Përgjegjësia Sociale.....	53
2.7.4 Teoria e plumbit magjik (stimulimi i përgjigjes)	53
2.7.5 Teoria e përdorimit nga kënaqësia	54
2.7.6 Zhurma	55
KAPITULLI III: KONTEKSTI HISTORIK.....	57
3.1 Një histori e shkurtër	57

3.2. Historia e ngjarjeve të Kosovës e paraqitur sipas BBC, CNN dhe REUTERS	58
KAPITULLI IV: ANALIZA EMPIRIKE	62
4.1 British Broadcasting Company (Kompania Britanike e Trasmetimeve) – BBC	64
4.2 Cable News Network – CNN	68
4.3 REUTERS	73
4.4 Roli dhe ndikimi i mediave në luftën në Kosovë	74
4.5 Pjesa I – Tabelat e të dhënave për përmendjen e Kosovës në mediat ndërkombë-tare gjatë periudhës kohore 1990-2012, të ndara sipas tematikës	77
4.6 Pjesa II – Analizë e gjuhës gazetareske	86
4.7 Pjesa III – Tabelat me të dhënat e burimeve të informacionit nga tri mediat BBC, CNN dhe REUTERS	89
KAPITULLI V: ANALIZA E LIGJËRIMIT	92
5.1 Analizë e artikullit nga CNN	93
5.2 Analizë e fotografive nga REUTERS	102
5.3 Analizë e artikullit nga BBC	105
5.4 Precedentët ndërkombëtarë të krijuar nga CNN, BBC, REUTERS	106
KAPITULLI VI: ANALIZË E INTERVISTAVE KUALITATIVE	112
6.1 Intervistat cilësore	112
6.1 Roli i mediave	139
6.3 Pse Kosova në qendër të vëmendjes dhe jo Pakistani apo Tajvani?	146
KAPITULLI VII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	155
Rekomandime	159
BIBLIOGRAFIA	160
BURIME ELEKTRONIKE	165
SHTOJCA 1	170
SHTOJCA 2	186
SHTOJCA 3	187
SHTOJCA 4	188
SHTOJCA 5	192
SHTOJCA 6	196

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Si u trajtua Kosova nga mediat ndërkombëtare?

Pasqyrimi mediatik ndërkombëtar i Kosovës nuk ka munguar që në vitet e '90-ta. Artikuj të ndryshëm, përfshirë lajme, fotolajme, reportazhe e dokumentarë, gjejnë hapësirë në tre mediat ndërkombëtare të përfshira në studim (CNN, BBC dhe Reuters). Mirëpo, ndryshimet sistematike në mënyrën e paraqitjes së Kosovës ndër vite, që kanë prodhuar këto media, nuk janë marrë në studim deri më tani. Për më tepër, roli i medias në këtë drejtim, është shfrytëzuar pak nga autorët shqiptarë si objekt studimi.

Punimi doktoral *“Ndikimi i komunikimit politik mediatik në krijimin e sovranitetit shtetëror të Kosovës gjatë periudhës 1998-2008”*, është një vështrim evolutiv i paraqitjes së Kosovës në këto media për periudhën në fjalë, dhe njëherit një përpjekje për të trajtuar një element tjetër që ndikoi në shtetformimin e Kosovës. Ky kënd i trajtimit është ndjekur në rrugë mediatike, përmes tri mediave ndërkombëtare në studim. Prandaj, është me interes të paraqitet një analizë e përmbajtjes mediatike dhe komunikimit mediatik të tre mediave, lidhur me rolin e tyre në zhvillimin e ngjarjeve në Kosovë, në periudhën e përzgjedhur për studim.

Të konsideruara si ndër mediat elektronike më me ndikim, si për nga audienca, ashtu edhe nga teknologjia e avancuar që kanë, CNN, BBC dhe REUTERS, janë referuar edhe nga studiues të ndryshëm, lidhur me rolin dhe ndikimin e tyre në politikën e jashtme, veçanërisht CNN, që ka prodhuar debate rreth efektit të saj në zona konflikti.

Si objekt studimi, është shqyrtuar roli i pasqyrimit mediatik të Kosovës nga tre mediat në fjalë, duke përdorur nënvariente të ndryshme të mënyrës së referimit të tyre ndaj Kosovës, jo vetëm përmendja si emër, por edhe cilësimet që janë përdorur më së shumti, referuar popullatës shumicë të këtij vendi dhe ngjarjeve gjatë periudhës së përfshirë në studim, të tilla si *“krahina”* *“gjenocid ndaj shqiptarëve”*, *“protesta paqësore”*, *“konflikt fetar”*, *“të*

drejtat e shqiptarëve”, “*sulme kriminale të shqiptarëve*”, “*UÇK organizatë terroriste*”, “*refugjatë*”, “*Kosova Protektorat*”, “*UÇK si ushtri*”, etj., dhe ndryshimet e ktyre cilësimeve ndër vite.

Investigimi i paraqitjes mediatike të Kosovë në këto tre media është përzgjedhur për disa arsye, përcaktuar në bazë të disa kriterëve të radhitura në vijim. Fillimisht, mbi arsyen metodologjike, për një studim të thellë të paraqitjes së Kosovës në media me shtrirje globale, që edhe sot përbëjnë burime ndërkombëtare të informacionit.

Kriteret në të cilat është bazuar përzgjedhja metodologjike janë: kriteri i një rasti studimor që përbënte lajm ndërkombëtar të rëndësishëm në periudha të ndryshme kohore historike, kriteri prezencës së Kosovës (qoftë si krahinë autonome, apo më vonë edhe si shtet), frekuenca dhe cilësimet e përmendjes në periudha të ndryshme kohore, si dhe kriteri i përcaktimit periodik, për shkak të ndryshimeve të mëdha që reflekton në paraqitjen mediatike të Kosovës.

Arsyeja e dytë është për faktin e vetë prestigjit të tyre, shtrirjes globale, audiencës së gjerë dhe kriterin e rëndësisë që kanë fituar historikisht këto media. Si rrjedhojë, më vonë ky rol dhe ky ndikim mediatik do të njihet si *Efekti CNN*.

Në rastin e Kosovës, mediat ishin ato që krijuan precedentë ndërkombëtarë, duke paraqitur si lajme kryesore masakrat ndaj popullatës civile dhe spastrimin etnik që po bëhej (përmes refugjatëve), perspektivë kjo që e nxiti politikën ndërkombëtare për ndërhyrje dhe vendimmarrje mbi çështjen e Kosovës.

1.2 Roli i medias në krizën e Kosovës (Objekti i studimit)

Pavarësisht mënyrës se si është paraqitur dhe sasisë së artikujve, Kosova rezulton e njohur për mediat botërore që në vitet ‘90. Që në këtë periudhë, artikuj të ndryshëm me përmbajtje kryesisht mbi zhvillime politike dhe çështje sociale, gjejnë vend në tre mediat në studim. Mirëpo, çfarë ishte pasqyrimi mediatik ndaj Kosovës, në çfarë termash është

raportuar, cilat kanë qenë vitet me frekuencë përmendjeje më të madhe, si dhe pse kanë ndryshuar këto ndër vite, cilat ishin cilësimet më të shpeshta referuar ngjarjeve dhe zhvillimeve në Kosovë në tërësi, do të paraqesim të dhënat e shtjelluara në kapitujt e analizave në vijim.

Përmes rastit të Kosovës, bëhet përpjekje të pasqyrohet roli i mediave, sidomos atyre ndërkombëtare, të cilat duke evoluar nga një ‘institucion denoncimi dhe social’, drejt një ‘institucioni vendimmarrës’ (përmes impaktit që kanë), ndikojnë në vendimmarrjen e politikave botërore. Shembull për vërtetimin e kësaj teorie mirret mënyra e raportimit ndaj zhvillimeve në Kosovë (në periudhën e përfshirë në studim), sasia e artikujve (ngritjet, rëniet), cilësimet më të shpeshta (ndryshimet ndër vite), tematikat në të cilat është raportuar, burimet e informacionit, elementë këto që tregojnë funksionin dhe interesin e medias për zhvillimet në Kosovë, dhe efektin e tyre në procesin e shtetformimit dhe krijimit të sovranitetit shtetëror të Kosovës. Periudha e përfshirë në studim është konflikti në vitin 1998 (përfshirë ndërhyrjen ushtarake të NATO-s), periudha pas përfundimit të luftës në vitin 1999, kur Kosova ishte nën administrimin e plotë të bashkësisë ndërkombëtare, deri në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008.

Është interesante të studiohet se si evoluar raportimi dhe cilësimi ndaj Kosovës, bazuar në informacionet që janë ofruar nga terreni, dhe se si në bazë të këtij ndryshimi, ka ndryshuar edhe perceptimi politik ndaj Kosovës dhe popullatës së këtij vendi në tërësi.

Analiza e të dhënave të këtij studimi fokusohet në qasje sasiore dhe përmbajtësore, ndërsa është bazuar kryesisht tek arkivi i mediave elektronike, me theks të veçantë në arkivat qendrore të BBC, CNN dhe REUTERS, për periudha të ndryshme kohore. Mirëpo, janë shqyrtuar dhe përfshirë në forma të tjera, të dhëna nga burime të hapura (dokumentarë, lajme me qasje të hapur, fotografi), si dhe është bërë përpjekje të paraqiten disa shembuj krahasimi me struktura të ngjashme botërore në një kuadër të kufizuar, me vende që ndajnë

pak a shumë të njëjtën histori, por që nuk përfituan nga politika ndërkombëtare sikurse Kosova. Këtu i referohemi periudhës kohore kur Kosova me shpalljen e pavarësisë fitoi sovranitetin e ri shtetëror.

Analizimi i të dhënave është kryesisht empirik, përfshin numër të përgjithshëm të artikujve, frekuencë përmendjeje, analizë teksti, të dhënash, cilësime, tematika, dhe intervista cilësore. Në veçanti, duhet theksuar se ndonëse ka material të mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion specifik, kjo përmbledhje e bazuar në të dhëna empirike mund të interpretohet dhe në mënyra të tjera.

Pavarësisht nga ky kufizim, sërish analizimi i të dhënave vërteton se Kosova përbënte lajm ndërkombëtar që në vitet '90 dhe se mediat ndërkombëtare ndryshuan frekuencën e përmendjes së Kosovës në periudhën e konfliktit, gjë që paralelisht solli edhe ndryshime në statusin politik të Kosovës. Ndërsa, besohet se kjo është një provë e mënyrës se si po evoluojnë mediat në kushtet aktuale të zhvillimit teknologjik dhe se si strukturat e tjera ndërkombëtare dhe kombëtare po ndikohen nga influenca gjithmonë e më në rritje e organeve mediatike. Natyrisht, qëllimi kryesor i këtij studimi mbetet të vërtetojë se si mediat dhe komunikimi luajtën rol në zhvillimet politike të Kosovës dhe ndryshuan këndin e trajtimit mediatik ndaj këtij vendi. Ndonëse synimi fillestar ishte vërtetimi se media ishte faktor ndikues në krijimin e Sovranitetit shtetëror të Kosovës, matja e ndikimit në këtë aspekt mund të jetë më shumë supozuese, por vështirë i matshëm, për shkak të përfshirjes së faktorëve të ndryshëm në këtë zhvillim. Gjithsesi mbetet edhe një qëllim dytësor për ta argumentuar, që lidhet me procesin se si po evoluon media duke u transformuar nga një organ informues, drejt një 'institucioni vendimmarrës', për më tepër drejt një institucioni social, rol ky që shpjegohet përmes rastit të Kosovës si shembull. Por, në rastin e këtij studimi, të dhënat janë të mjaftueshme për të hedhur një hipotezë në këtë drejtim dhe jo për

ta vërtetuar si teori, pasi për një arritje të tillë duhen shumë më tepër raste studimi dhe krahasimi.

Ndër të tjera, studimi është i bazuar vetëm në pjesën analitike të mbledhur nga media, literatura dhe persona të lidhur me median. Nëse do të ishte përfshirë dhe pjesa tjetër e faktorëve që ndikuan në Sovranitetin e Kosovës, atëherë ky studim do duhej të përfshinte edhe metoda tjera hulumtimi të matjes së ndikimit të medias dhe faktorëve të tjerë, dhe si i tillë do të ishte shumë më i gjerë, gjithpërfshirës, dhe do kërkonte më shumë kohë për t'u përfunduar.

Pyejte tjera kërkimore në këtë studim janë:

- Si është pasqyruar Kosova në vitet 1998-2008?
- Si krijoi media precedentë ndërkombëtarë për krizën në Kosovë?
- Sa shpesh është përmendur Kosova në periudhën 1998-2008?
- Pse ndryshoi numri i artikujve për Kosovën në periudha kohore të ndryshme?
- Çfarë realiteti u ndërtua për Kosovën?
- Me çfarë tematikash kryesisht raportojë?
- Çfarë cilësimesh kanë përdorur më së shumti këto tre media për të karakterizuar popullatën e vendit dhe Kosovën në përgjithësi?
- Çfarë ishin burimet e informacionit?
- Çfarë ishte imazhi ndërkombëtar i krizës në Kosovë gjatë periudhës 1998-1999?
- Pse Kosova në vitin 1999 ishte në qendër të vëmendjes në mediat ndërkombëtare të përfshira në studim?
- Cili ishte funksioni i medias në krijimin e sovranitetit të ri shtetëror?

1.3 Hipoteza dhe pyetja kërkimore

Argumenti kryesor i objektit të studimit, mbështetur si nga analiza e të dhënave empirike në periudha historike të ndryshme, analizë përmbajtësore, ashtu edhe nga intervistat me

personalitete të medias, mëton se komunikimi dhe përfaqësimi mediatik ndërkombëtar i Kosovës ndryshoi në periudhën e konfliktit (1998-1999), si rrjedhojë e prezencës së gazetarëve ndërkombëtarë në vendin e ngjarjes, të cilët duke raportuar me burime dhe filmime drejtpërdrejtë nga terreni, ndryshuan formatin e pasqyrimit mediatik të Kosovës. Për më tej, duke sjellë Kosovën si lajm ndërkombëtar kryesor, luajtën rol në zhvillimet politike të asaj kohe dhe në shtetformimin e Kosovës (2008). Natyrisht, që ka edhe faktorë të tjerë që ndikuan në këtë proces, por për studim është përzgjedhur roli i medias. Për të argumentuar këtë, të dhënat analitike në studim janë ndarë në disa periudha kohore, për të krijuar një pasqyrë të qartë të ndryshimeve historike të trajtimit të Kosovës, në tre mediat në studim. Megjithëse janë periudha historike të ndara në analiza, që paraqesin edhe këndvështrime të ndryshme të trajtimit të Kosovës, theksohet qartë se pikërisht krijimi i precedentëve ndërkombëtarë në vitin 1999, si ‘presion’ mediatik nxiti ndryshime në statusin e Kosovës.

Pyetja themelore kërkimore që shtjellohet në këtë studim është: ***Si krijoi media precedentë ndërkombëtarë që luajtën rol në shtetformimin e Kosovës?***

Teza kryesore e ngritur si përgjigje e pyetjes kërkimore është:

- Kosova trajtohet në kontinuitet nga mediat ndërkombëtare në periudhën 1990-2012. Këndi i trajtimit mediatik të saj ndryshoi si pasojë e prezencës së gazetarëve ndërkombëtarë në vend të ngjarjes, gjatë periudhës së konfliktit (1998-1999) e më pas (2008), dhe se termat në të cilat u trajtua Kosova luajtën rol në shtetformimin e Kosovës.

Hipoteza e mësipërme mbështetet edhe në argumente tjera:

- Pasqyrimi konstant në periudha të ndryshme kohore dhe me kënde të ndryshme trajtimi, dëshmon përfaqësimin mediatik të subjektit të Kosovës në mediat ndërkombëtare.

- Përmbajtja mediatike rreth subjektit të Kosovës dëshmon funksionin që ka pasur media ndërkombëtare në procesin e zhvillimeve në Kosovë, në periudha historike të ndryshme.

Argumente plotësuese mbi tezën e paraqitur janë të dhënat nga analiza empirike e numrit të artikujve mbi Kosovën, termat në të cilat është pasqyruar, burimet e informacionit, frekuenca e përmendjes dhe ndryshimet ndër vite, ku nëpërmjet statistikave për periudhën në studim, është bërë përpjekje të paraqiten treguesit dhe ndryshimet gjatë periudhave kohore, sipas ngjarjeve dhe fazave të procesit të shtetformimit të Kosovës. Mbështetje tjetër janë intervistat me personalitete të medias, si dhe teoritë klasike dhe ato moderne të studiuesve të ndryshëm, të referuar në këtë punim, të cilët japin një bazë konceptuale teorike për të mbështetur studimin lidhur me evoluimin e medias dhe mënyrën se si ajo po ndryshon sferën e saj të influencës, duke marrë shembull rastin e Kosovës.

Si rrjedhojë, fillimisht punimi synon të argumentojë tezën sipas së cilës në aspektin evolutiv historik, Kosova në mënyrë konstante përbën lajm ndërkombëtar në tre mediat në studim (në periudhën 1990-2012), veçanërisht në periudhën 1998-2008; evoluimi përfshin si ndryshimet në numrin e artikujve, ashtu edhe cilësimet e ndryshme në kornizimin e Kosovës.

Së dyti, studimi synon të provojë se pavarësisht që edhe para vitit 1998 ka ekzistuar një interes dhe rrjedhje e informacionit për Kosovën, edhe pse informacioni ka qenë i pakët dhe kryesisht i referuar në organe zyrtare të asaj kohe nga Beogradi, nga të dhënat analitike vërehet se në vitin 1999, ekziston një shtim i menjëhershëm i raportimeve për Kosovën me ç'rast ndryshojnë edhe termat e raportimit. Duke konsideruar që kjo filloi nga fundi i vitit '98 dhe mori një rritje të menjëhershme në periudhën brenda një viti, është i rëndësishëm edhe këndi i ri i trajtimit të saj, me përqendrim kryesor të raportimeve në tematikë humane dhe raportim lufte. Pikërisht në këtë periudhë, burime informacioni janë vetë përjetuesit e

ngjarjeve, përfshirë fikserët lokalë, siç quheshin shoqëruesit vendorë të korrespondentëve ndërkombëtarë të mediave që mblidhnin informacione nga terreni. Në këtë periudhë kohore, pavarësisht mundësive të kufizuara për lëvizje brenda territorit të Kosovës, ishin pikërisht masakrat dhe refugjatët e dëbuar që u bënë precedentë ndërkombëtarë, duke tërhequr vëmendjen e diplomacisë ndërkombëtare drejt Kosovës. Ky argument mbështetet me analizë sasiore të burimeve të informacionit dhe me të dhënat nga intervistat cilësore.

Së fundmi, vet sasia e artikujve, termat në shkrimet gazetareske dhe gjuha ligjërimore, flasin për paraqitjen mediatike ndërkombëtare të Kosovës, duke përfshirë formate të ndryshme të pasqyrimin për zhvillimet historike brenda periudhës në studim.

1.4 Kufizimet e studimit

Duhet pranuar se në këtë punim ka disa kufizime, meqë studimi trajton paraqitjen mediatike dhe rolin e komunikimit nëpërmjet medias, si faktor në krijimin e sovranitetit të Kosovës, ndërsa nuk janë marrë parasysh ndikime të tjera të komunikimit, sikurse ai diplomatik dhe Konventat ndërkombëtare.

Në këtë studim është zhvilluar dhe analizuar komunikimi dhe përfaqësimi mediatik, ndërsa janë cekur në mënyrë sipërfaqësore elementët e tjerë të komunikimit. Gjithashtu, studimi është kufizuar në një periudhë të caktuar kohore dhe nuk është trajtuar në tërësinë e tij më gjerësisht, që nga fillimi i viteve 1900, kur Kosova përmendet si problem politik në arenën ndërkombëtare. Ndër të tjera, duhet pranuar se mediat e përzgjedhura në trajtim janë vetëm tre më kryesoret të konsideruara me ndikim, ndërsa nuk janë përfshirë media të tjera që kanë pasur funksion, në një mënyrë apo tjetër, në zhvillimet në Kosovë. Për më tepër, nuk janë marrë parasysh edhe faktorë të tjerë që kanë mundur të ndikojnë, qoftë nga arena politike ndërkombëtare, qoftë nga ajo vendore.

Gjithashtu, duhet theksuar se për analizë janë përzgjedhur artikuj me tematikat dhe cilësimet më të përmendura gjatë raportimit kur i referohen Kosovës dhe nuk janë analizuar tërësisht të gjithë artikujt e ndarë në të gjitha drejtimet.

Pjesa më e rëndësishme dhe problematike e matjes në këtë studim, është paraqitja faktike se si ka ndryshuar perceptimi i Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe rolin që luajti media në këtë ndryshim. Për arsye se është e vështirë të pasqyrohet vetëm në një periudhë të shkurtër, ky ndryshim është pasqyruar i shtrirë në një hapësirë kohore më të gjerë, duke përfshirë ndryshimet kryesore politike në këto periudha kohore. Kjo ka ardhur edhe si pasojë e volumit të vogël të lajmeve që ka pasur para viteve '90 për Kosovën. Në të vërtetë, periudha që më së miri e pasqyron ndikimin mediatik është ajo gjatë viteve 1999 dhe pas, por për të pasur një pasqyrë sa më të pastër të situatës, një hulumtim i publikimeve mediatike gjatë viteve '90 është i domosdoshëm.

Në pjesën metodologjike ka një përshkrim të metodave të hulumtimit, me të gjitha instrumentet që janë përdorur, për mbledhjen e të dhënave, marrjen e mostrave, analizën e të dhënave dhe rezultatet nga hulumtimi; dhe përfundon me konkluzionet, listën e kufizimeve dhe rekomandimet për studiuesit në të ardhmen.

Si përfundim, ndonëse media po merr trajtat e një institucioni social, studimi kufizohet vetëm në rastin e krizës në Kosovë, ndërsa kërkohet më shumë kohë dhe studime të mëtejshme për të vërtetuar këtë evoluim.

1.5 Metodologjia

Metodat e kërkimit të aplikuara në këtë studim, synojnë të argumentojnë hipotezat e ngritura dhe të japin përgjigje në qëllimet e këtij punimi.

Studimi mbështetet tek qasja metodologjike e kombinuar cilësore dhe sasiore e përmbajtjes mediatike. Analiza e përmbajtjes të artikujve është realizuar përmes leximit nga afër të lajmeve dhe duke përdorur teknika të identifikimit të fjalëve kyçe, stilit gazetaresk dhe formave të

shprehurit, cilësimeve më shumë dhe më shpesh të përdorura, mënyrës së konstruksionit të lajmit dhe burimet e referuara. Ky aspekt fokusohet në evoluimin e përmbajtjeve mediatike ndër vite, brenda periudhave kohore të ndryshme.

Studimi është një përjasje empirike dhe teorike e ndarë në disa drejtime. Drejtimi i parë, është analiza e numrit të përgjithshëm të artikujve për Kosovën, në periudha të ndryshme kohore (brenda periudhës 1990-2012) të ndarë sipas tematikës në të cilën ka pasur më së shumti artikuj për zhvillimet në Kosovë, të tilla si sociale, politike, raportim lufte, humane dhe të tjera. Tematika është përcaktuar sipas mundësisë që të krijon logimi në arkivat qendrore të tre mediave dhe në bazë të kriterit mbi numrin më të madh të raportimeve. Ky seleksionim është bërë për të treguar sa interes po shfaqej ndaj aspektit human, apo zhvillimit të luftës dhe pasojave të saj ndaj popullsisë civile, kundrejt aspektit politik. Kjo analizë është kryer duke hyrë në arkivat qendrore të këtyre tre medimeve. Për sa i përket pjesës teknike të kryer pas aksesimit, vetë arkiva të jep mundësinë e qasjes dhe përzgjedhjes në bazë të zonës (në rastin e këtij kërkimi Ballkani, Kosova), më pas në bazë të fushës sociale, politike, konflikt ose luftë, apo të tjera. Pas kësaj përzgjedhjeje, është dashur të shqyrtohen të paktën 80 deri në 100 artikujt e parë, për të nxjerrë në mënyrë të përgjithshme cilësimet që janë përdorur më së shumti për të përshkruar situatën në Kosovë, dhe së fundmi janë bërë kërkime për secilin cilësim që të dokumentohen të dhëna numerike se sa herë janë përmendur në një periudhë të caktuar, sipas ndarjes në vite. Edhe në përcaktimin dhe analizimin e burimeve është ndjekur e njëjta procedurë, por duke qenë më e thjeshtë, pasi në sajë të motorëve të kërkimit të databazës, ka qenë më i thjeshtë identifikimi i lajmeve nga burime zyrtare dhe ato jo zyrtare, pasi citohen si të tilla nga vetë media.

Si rrjedhojë e këtyre vështirësive, është dashur të merren në studim video, që gjenden lehtësisht në faqe interneti 'You Tube', për të vërtetuar vazhdimësinë e vërtetësisë së kërkimit. Pavarësisht se këto ekzistojnë në formën e dokumentarëve për luftën, që janë

realizuar pas kohës së krizës, pamjet që përdorin i përkasin kohës së konfliktit. Kjo është një provë tjetër që përdoret në këtë studim, sepse në këta dokumentarë jo gjithmonë janë autorë vetëm gazetarët ndërkombëtarë që kanë mbuluar krizën, por edhe ata vendorë, që tregojnë lidhjen dhe ndikimin mes dy palëve, që më vonë është pasqyruar tek intervistat. Kërkime të hollësishme janë orientuar duke parë nga afër dokumentarët dhe duke lexuar nga afër lajmet, ilustruar përmes dy shembujve, me dy tekste (njëri në periudhën e luftës, tjetri pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës) dhe një album me fotografi, ku bëhet përpjekje të ofrohet një përmbledhje e cilësimeve dhe mënyrës se si është trajtuar Kosova. Drejtimi i dytë metodologjik ka të bëjë me analizë sasiore e numrit të përgjithshëm të artikujve, të ndarë sipas produktit (lajme, dokumentarë dhe fotografi), tematikës, dhe analizë cilësimesh në terma sasiore.

Drejtimi tjetër, është realizuar duke analizuar mënyrat dhe format e të raportuarit, fjalët dhe fjalitë kyçe, cilësimet që janë bërë dhe më e veçanta që del nga kjo, është raportimi nga këndvështrimi i refugjatëve të dëbuar jashtë territorit të Kosovës, që i përgjigjet hipotezës së ngritur.

Drejtim i radhës për argumentimin e hipotezës janë intervistat cilësore, të realizuara me ‘fikserët’ vendorë¹ të periudhës në studim, si një mënyrë efektive e kuantifikimit të të dhënave nga një grup mostër, duke pasqyruar hollësisht të dhënat faktike të tyre si pjesë e ngjarjes, emocionet dhe reagimet e tyre si të dhëna dytësore, për metodën e hulumtimit bazuar në opinion.

Mënyra e përzgjedhjes së artikujve për analizë sasiore është bërë duke llogaritur çdo artikull për përmendjen e Kosovës (tek rubrika e Ballkanit), pavarësisht tematikës, ndërsa pastaj, të dhënat empirike të përgjithshme janë paraqitur në tabela të veçanta, të ndara në tri pjesë. Pjesa e parë përfshin një tabelë me numrin e plotë të artikujve për Kosovën në periudhën kohore 1990-1998,

¹ Me termin ‘Fikserë’ janë punësuar dhe janë cilësuar të intervistuarit në këtë studim. Ky emërtim është përdorur nga vetë mediat në fjalë, duke iu referuar ndihmësve apo producentëve vendorë.

klasifikuar sipas tematikave. Këtu janë përfshirë edhe video-incizime dhe fotografi të përzgjedhura sipas tematikës së klasifikuar. Numri i shkrimeve të nxjerra nga arkivi është paraqitur i ndarë më vete si shkrime, ndërsa numri i fotografive dhe videove është llogaritur i përbashkët. Kjo është bërë qëllimisht, meqë artikujt kanë qenë të kohës, ndërsa fotografitë dhe video-incizimet (përfshirë lajme dhe dokumentarë janë publikuar edhe më vonë sesa ngjarja).² Në një tabelë të dytë janë paraqitur të dhënat empirike të vitit 1999, të ndara sipas tematikës humane dhe raportim lufte. Ky vit është lënë qëllimisht i ndarë, për shkak të shumëfishimit të numrit të artikujve për Kosovën dhe ndryshimin tashmë të tematikës, pavarësisht se konflikti kishte filluar në vitin 1998. E njëjta metodë është përdorur edhe për vitin 2000, pavarësisht se numri i artikujve për Kosovën ka një rënie, por tematika sërish mbetet kryesisht e përqendruar te ajo humane dhe raportim lufte. Në një tabelë tjetër janë paraqitur të dhënat empirike për periudhën kohore 2001-2007, sipas varësisë së tematikës, humane, raportim lufte, zhvillime politike. Ndërsa, tabela e fundit për këtë pjesë paraqet të dhëna empirike të klasifikuara sipas tematikës sociale, politike, krime lufte. Pjesa e dytë analitike e të dhënave empirike, përmban analizë të gjuhës gazetareske të video-incizimeve (lajme të kërkuara online), konkretisht janë klasifikuar cilësimet kryesore të përdorura në raportimet për Kosovën, duke treguar se sa herë janë përmendur këto cilësime në artikuj, të ndarë në tabela të veçanta, për periudha të ndryshme kohore brenda viteve 1990-2012. Edhe tek kjo pjesë vitet 1999 dhe 2000, janë paraqitur të ndara si periudha kohore më vete, pikërisht për shkak të ndryshimit të cilësimeve për Kosovën dhe rritjes së numrit të tyre. Këto tabela janë përfshirë tek pjesa e shtojcave, për arsye të numrit të madh të cilësimeve dhe tabelave të ndara sipas viteve.

Paraqitja dhe zbërthimi i gjuhës së artikujve përmes analizës së ligjërit (analizë teksti dhe fotografi në studim)

² Shumë nga dokumentarët dhe lajmet në formë të video-incizimit, mund të gjenden pa pagesë, në faqen e internetit You Tube.

Në këtë pjesë janë përzgjedhur dy artikuj për analizë të përmbajtjes së tekstit, një nga CNN dhe një nga BBC, ndërsa nga REUTERS është bërë analizë e fotografive të periudhës së konfliktit, të përmbledhura në një album të fotografive që karakterizon luftën në Kosovë (duke përfshirë refugjatë, të vrarë, masakrat dhe elementë tjerë të aspektit human, të popullatës civile). Arsyeja e përzgjedhjes është për të ilustruar një shembull nga shumë të ngjashëm në mënyrën e stilit gazetaresk të përdorur nga këto tre media kur trajtojnë Kosovën.

Analiza është fokusuar tek titujt, nëntitujt, përmbajtja e tekstit, fotografitë e përdorura dhe mesazhet e dhëna përmes tyre, përshkrimi tekstual nën fotografi, fraza dhe fjalë kyçe, cilësimet që ndeshen më shpesh, burimet e informacionit, duke ndërtuar në këtë formë një pasqyrë të gjuhës gazetareske të përdorur.

Kriteri i përzgjedhjes së artikujve është bërë duke përzgjedhur një artikull të periudhës më të rëndësishme për Kosovën, për periudhën në studim, kur u mor dhe vendimi për ndërhyrjen ushtarake humanitare të NATO-s. Artikulli është i datës 17 prill 1999, publikuar nga CNN³ dhe për burim informacioni kryesisht i referohet refugjatëve kosovarë, që ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre në drejtim të shteteve fqinje, të cilët ishin edhe dëshmitarë të masakrave e vrasjeve të tjera selektive që ishin kryer nga ushtria dhe paramilitarët serbë. Ky artikull ka një përputhje edhe me të dhënat në terma sasiorë, ku del qartë se në vitin 1999 cilësimi ‘*refugjatë*’ është ai që dominon lajmet referuar Kosovës (kryetituj, nëntituj, fotolajme).

Nga REUTERS, në studim është marrë një album i fotografive me titullin *Lufta e Kosovës*, publikuar më 17 shkurt 2009, por që përmban fotografi të periudhës 1998-1999. Kryesisht është vënë re se ky medium, luftën e Kosovës e paraqet duke përshkruar pamje të masakrave ndaj popullatës civile dhe numri më i madh i fotografive paraqet refugjatët shqiptarë duke u larguar nga Kosova. Janë përzgjedhur disa fotografi për studim më të

³ Artikulli i botuar nga CNN, i titulluar “*Refugjatët thonë se mijëra kosovarë të tjerë janë vrarë*”, mund të gjendet edhe përmes kërkimit të hapur në internet. Pra, është i qasshëm publikisht. Linku i plotë i këtij artikulli është vendosur edhe tek pjesa e referencave, ndërsa versionin origjinal i tij në gjuhën angleze, është bashkëngjitur tek shtojcat në fund të këtij punimi.

thelluar, të cilat janë të vendosura tek pjesa e shtojcave. Ky album është marrë në analizë pikërisht për të dhënë një shembull nga shumë tjerë të ngjashëm, që përputhet me të dhënat sasiore të analizuara.

Nga BBC është përzgjedhur një artikull me titullin *Realiteti i ftohtë pas tre viteve të pavarësisë së Kosovës*, publikuar më 17 shkurt 2011. Përzgjedhja është bërë për të treguar një shembull të ndryshimit të qasjes së raportimit ndaj Kosovës (nga shumë të tjerë të ngjashëm) pas shpalljes së Pavarësisë, më 17 shkurt 2008. Artikulli në fjalë, pavarësisht se përfshin të dhëna më shumë mbi zhvillime politike dhe akuza për krime lufte, sërish e raporton Kosovën para audiencës si viktimë, ndërsa luftën e Kosovës e cilëson si një fushatë të spastrimit etnik, të iniciuar nga autoritetet serbe. Varianti origjinal i këtij artikulli është përfshirë tek pjesa e anekseve, ndërsa faqja e publikimit është vendosur tek pjesa e referencave dhe është i aksesueshëm pa pagesë.

Artikujt e përzgjedhur në studim vërtetojnë të dhënat empirike të analizuara mbi përfaqësimin mediatik ndërkombëtar të Kosovës, cilësimet që janë përdorur më së shumti dhe ndryshimi i tyre ndër vite. Gjithashtu, mund të vërehet se pas vendosjes në Kosovë, të institucioneve të OKB-së dhe atyre të Bashkimit Evropian, përmes organizatave të ndryshme diplomatike ndërkombëtare, numri i lajmeve për Kosovën bie, cilësimet ndryshojnë nga viti në vit, ndërsa edhe formulimet gjuhësore rreth Kosovës marrin një formë tjetër të të raportuarit, duke e trajtuar atë si një shtet në zhvillim e sipër.

Nga këto të dhënat vihet re se Kosova gjatë kohës së krizës ka qenë lajmi kryesor ndërkombëtar dhe raportohej në edicione speciale. Pikërisht ndryshimi i raportimit dhe trajtimit të Kosovës në këtë periudhë, përmes formulimeve gjuhësore me fokus në tematika humane, duke e paraqitur Kosovën si një vend që po shkon drejt një katastrofe humane nga vrasjet masive dhe spastrimi etnik, ishte ajo çka solli ndryshime në statusin e këtij vendi në vitin 1999. Kjo u realizua me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s dhe më vonë me praninë

diplomatiqe ndërkombëtare për të ndihmuar ndërtimin e institucioneve vendore, proces që u përmbyll me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008.

Intervistat Cilësore - Dokumentimi i rolit të fikserëve vendorë, në krijimin e precedentëve ndërkombëtarë, që ndikoi në trajtimin e Kosovës nga politika ndërkombëtare në një këndvështrim tjetër (aspekti human, jo politik)

Në pasqyrimin e ngjarjeve në Kosovë, në veçanti kur vërehet një kthesë e dukshme e vëmendjes për Kosovën (viti 1999 dhe 2000) me numrin e artikujve për Kosovën, por edhe këndi i trajtimit të saj, një rol të rëndësishëm e kanë luajtur edhe aktorët vendorë. Në një tabelë të vendosur tek pjesa e anekseve, janë listuar të intervistuarit, identiteti i tyre dhe pozicioni i tyre në periudhën në studim. Janë paraqitur të dhënat mbi mediat ku ata kanë shërbyer, në periudha kohore të ndryshme të përfshira në këtë studim, dhe llojin e raportimit që kanë asistuar apo mbuluar me korrespondentët ndërkombëtarë, që kishin ardhur për të mbuluar ngjarjet në Kosovë. Arsyeja e përzgjedhjes së tyre për intervistim ka të bëjë me faktin se këta qytetarë të Kosovës, si përjetues të ngjarjeve, duke ndihmuar korrespondentët ndërkombëtarë, kryesisht në formë të pavetëdijshme, kanë ndikuar në paraqitjen e rastit të Kosovës nga një këndvështrim tjetër. Përderisa deri në atë kohë, një pjesë dërmuese e korrespondentëve citonin si burime informacioni kryesisht mediat serbe, si burim nga terreni, tashmë ata ndiqnin situatën edhe vetë nga vendi i ngjarjes. Fikserët vendorë ishin ata që kishin rolin e përkthyesit (shqip-anglisht dhe anasjelltas), por dhe ndihmonin korrespondentët në terren.

Intervistat janë përshkruar në formë rrëfimtare, duke cituar pothuajse të tërë deklarin e të intervistuarve, qëllimisht, meqë vetë deklarimi i tyre jep shpjegime dhe mesazhe të qarta, pa pasur nevojë për koment.

Për të ilustruar impaktin që media pati në arenën ndërkombëtare, është sjellë përmendja e Kosovës krahasuar me dy konflikte të tjera që janë zhvilluar në një periudhë kohore të

përafërt, e që statusi i tyre edhe sot mbetet i pazgjidhur. Krahاسimi është bërë përmes analizimit të cilësimeve që mediat në studim u kanë bërë këtyre tre konflikteve.

Në këtë pjesë, të dhënat cilësore janë paraqitur në një tabelë të veçantë, duke parashtruar sa herë janë përmendur cilësimet *Pavarësi*, *Gjenocid* dhe *Refugjatë*, në raportimet ndër vite, duke krahasuar Kosovën me Pakistanin (ishujt Jammu dhe Kashmir) dhe Tajvanin. Këto cilësime janë përzgjedhur për krahasim, meqë pikërisht këto paraqesin fakte ku dhe përfundojnë ngjashmëritë ndërmjet këndit të trajtimit të tyre nga BBC, CNN dhe REUTERS, krahasuar me Kosovën. Pavarësisht natyrës së ndryshme të konflikteve të këtyre vendeve, fillimisht është bërë një përshkrim i ngjarjeve historike të tyre, duke iu referuar të dhënave nga tre mediat në studim, ndërsa është trajtuar aspekti i të përbashkëtave të tyre me Kosovën, konkretisht ngjashmëritë në përpjekjet dhe zhvillimet politike. Nëse bëhet një krahasim i tyre me Kosovën, vihet re se këto vende ndajnë të njëjtat tipare, vende të shkëputur nga shteti amë, nën administrimin e një pale të tretë, vende që gëzojnë një lloj autonomie në periudha të ndryshme historike dhe ajo çfarë është veçuar si e përbashkëta themelore, duan pavarësi. Pikërisht këtu dhe përfundojnë ngjashmëritë ndërmjet tyre, sepse Kosova e fitoi pavarësinë dhe sovranitetin si shtet, ndërsa krahinat e Jammu, Kashmir dhe ishulli i Tajvanit, janë ende nën të njëjtin sovranitet. Kjo pjesë është paraqitur si shembull krahasimi, e integruar brenda kapitullit, por jo si analizë më vete, meqë për të bërë analizë krahasimi, duhen më shumë raste studimi për të vërtetuar çështjen.

Pjesa teorike përfshin një rishikim të detajuar të literaturës në lidhje me fazat e evoluimit të medias dhe ndikimit që ka ajo në shoqërinë masmediatike, e cila sjell njohuri mbi mënyrën se si media shqyrton dhe filtron informacionin, ndërton imazhe që sjellin ndikim në përcaktimin e agjendës në politikën ndërkombëtare dhe shpeshherë nxit në vendimmarrje diplomacine ndërkombëtare. Përfundon me dy të dhënat bazë, duke bërë përpjekje argumentimin e rolit denoncues të saj, përmes denoncimit social që bëri media në arenën ndërkombëtare ndaj

gjenocidit në Kosovë dhe këndi i trajtimit të saj si një vend-shtet i ri. Pjesa teorike, paraqet faktorët bazë që përbëjnë ndryshimin e mënyrës se si vepron media në shekullin XXI, që janë teknologjia, lëkundja e besimit tek tre pushtet tjera dhe globalizimi i jetës njerëzore.

Gjithashtu, për të argumentuar përzgjedhjen e këtyre tri medimeve në studim, është paraqitur një historik i formimit dhe veprimit të tyre, duke nxjerrë në pah kriterin e rëndësisë, audiencës dhe ndikimit të tyre global.

Si konkludim, metodat e kërkimit të zbatuara janë: Rishikimi i literaturës si vështtrim i teorive dhe hulumtimeve shkencore ekzistuese, të cilat në forma të ndryshme mund të lidhen me objektin e kërkimit, ndërsa zbatohen kryesisht në kapitullin historik dhe në interpretimin e rezultateve të gjetura; Analizë teksti dhe ligjërimi që aplikohet te pjesa analitike cilësore e artikujve për Kosovën, me qëllim zbërthimin e përmbajtjeve dhe stilit gjuhësor të artikujve, në funksion të evidentimit të ligjërimeve specifike dhe atyre në kontinuitet; Analizë sasiore në funksion të evidentimit të pasqyrimin mediatik konstant dhe ndryshimeve të pësura në vite të caktuara; Intervista cilësore të realizuara me gazetarë që kanë lidhje me pasqyrimin mediatik të Kosovës në tre mediat në studim që njëherit argumentojnë të gjeturat nga kërkimi.

1.5.1 Kufizimet metodologjike dhe vështirësitë gjatë kërkimit

Në mënyrë të përmbledhur, të dhënat empirike janë mbështetur në bazën e të dhënave private të arkivave të tre mediave kryesore të kësaj periudhe, që janë CNN, BBC dhe REUTERS. Janë përzgjedhur këto tre media, jo vetëm se kanë qenë të pranishme gjatë krizës, por edhe se kanë mbuluar lajme për Kosovën qoftë para qoftë pas krizës, si dhe vazhdojnë të publikojnë lajme për Kosovën edhe sot, ndonëse këto të fundit nuk janë përfshirë në këtë studim. Mbledhja e këtyre informacioneve konsiderohet pjesa më e vështirë për realizim, jo vetëm për shkak të ruajtjes dhe analizimit të të dhënave, por edhe për faktin e kostos financiare (është dashur të bëhet abonim me pagesë në bazat qendrore të

të dhënave të tyre, për të pasur mundësinë e njohjes me të gjithë gamën e mundshme të asaj periudhe).

Ndër vështirësitë për të realizuar këtë studim, ishte edhe përzgjedhja e metodave dhe instrumenteve të përshtatshëm, nga metodat e ndryshme të hulumtimit shkencor, për të bërë matjen e pyetjes kërkimore dhe argumentimin e hipotezës së ngritur. Ka kaq shumë faktorë për t'u studiuar dhe vlerësuar, saqë është e vështirë të përzgjidhen instrumentet e saktë për të realizuar matjet. Pyetja hulumtuese, etika, koha dhe buxheti, janë të gjitha arsye që duhen marrë në konsideratë në çdo studim, por ndoshta më tepër në këtë rast, për arsye të kohës historike kur ka ndodhur ngjarja në studim. Për pasojë, në këtë studim nuk ka qenë e mundur të eksplorohej, analizohet dhe të përfshihen të gjithë elementët ndikues të teksteve dhe fotografive që paraqesin historikisht Kosovën në këto media, për të mbështetur më shumë pyetjen kërkimore. Gjithashtu, pavarësisht interesit që përmes rastit të Kosovës të argumentohet roli dhe ndikimi i medias, jo vetëm si denoncuese sociale, por edhe influencën në rritje që ka në vendimmarrje, kjo në këtë rast është e kufizuar.

Meqë ngjarja e Kosovës e përzgjedhur për studim, është zhvilluar në të kaluarën, është kaluar direkt në mbledhjen e të dhënave sasiore.

Në vijim, janë listuar disa nga vështirësitë, sipas zhvillimit kronologjik që është ndjekur për të zhvilluar studimin. Këto vështirësi janë ndarë në pesë etapa.

Etapa e parë, fokusimi

Ndër pjesët më të vështira ka qenë fokusimi në një periudhë të caktuar kohore për të vërtetuar tezën e parashtruar. Ka shumë kërkime dhe publikime për Kosovën dhe ndikimin që pati media gjatë konfliktit, por për të bërë një studim të detajuar dhe për të nxjerrë në pah efektin që pati media, është shumë e vështirë të gjejmë një fokus specifik kohor. Kjo më shumë si pasojë e faktit që Kosova ka qenë gjithmonë në një mënyrë ose një tjetër në fokusin e mediave ndërkombëtare edhe para se të fillonte kriza. Si pjesë e ish bllokut

komunist lindor, ajo ka figuruar deri diku në mediat ndërkombëtare dhe mund të thuhet se ndryshimi i perceptimit të saj nga gazetarët ndërkombëtarë ka ardhur në mënyrë graduale, por nuk është e mundur që të përfshihen në këtë punim të gjitha këto të dhëna, pasi do të kërkonte më tepër kohë dhe zgjerim të përshkrimit të faktorëve historikë.

Sidoqoftë, vlen të përmendet fakti se gjatë fazës paraprake të fokusimit kohor, në kërkim kanë dalë të dhëna për Kosovën që nga vitet e '90-ta, e kjo tregon interesin që kanë pasur mediat ndërkombëtare që në atë kohë për pjesën e Ballkanit. Pavarësisht kësaj, vështirësia ishte të përcaktimi i periudhës kohore ku duhej të fokusohet studimi. Specifike për këtë studim nuk është thjesht fakti për të treguar rolin që pati media në krizën e Kosovës, por shqyrtimi i një prej faktorëve kyç që ndihmoi në sovranitetin e këtij vendi, duke e ruajtur identitetin e tij etnik. Për këtë arsye, studimi nuk mund të fokusohet vetëm tek pjesa e luftës, por ishte e domosdoshme të studioheshin edhe etapat e tjera, para dhe pas luftës, pasi që sovraniteti i Kosovës kërkon një gamë më të gjerë studimi, se sa thjesht pjesa e luftës.

Ekzistojnë shumë studime mbi rolin e medias në kriza lufte, madje teoritë e reja promovojnë faktin se media ka ndryshuar mënyrën se si bëhet lufta, duke e futur atë në perceptime të reja (De Franco, 2012), por më pak studime fokusohen në faktin se media nuk po ndryshon vetëm mënyrën se si po zhvillohen luftërat, apo influencon politikat e jashtme ndërkombëtare, por ajo ka arritur të ketë aftësinë të “legjitimojë” ose të “delegjitimojë” tiparet themelore se si ne perceptojmë ligjin ndërkombëtar dhe atë kombëtar, si dhe nocione të tjera bazë që themelojnë perceptimin tonë ligjor dhe historik (Robertson, 2005). Lidhur me këtë, është dashur të përfshihet periudha 1990-2012, pavarësisht se përqendrimi analitik është fokusuar nga viti 1998 e deri në shpalljen e Pavarësisë në vitin 2008. Interesi ishte që të pasqyrohej në përgjithësi mënyra se si media perceptonte Kosovën, jo vetëm në periudhën para dhe gjatë

luftës, që është një periudhë e studiuar në përgjithësi, por edhe periudhën kohore para dhe pas shpalljes së pavarësisë.

Etapë e dytë, literatura

Vështirësia e dytë që është hasur në rrugëtimin e këtij punimi, ishte përzgjedhja e literaturës. Si temë është relativisht e vështirë për t'u provuar dhe ishte e domosdoshme të gjesh literaturën e duhur, për të arritur interpretimin e rezultateve sa më të sakta, të cilat do të krijojnë mundësinë e një analize të qartë të asaj çfarë synon studimi të vërtetojë. Me literaturën që kemi në dispozicion në kohët e sotme është e lehtë që të humbasësh drejtimin, për shkak të gamës së gjerë që tashmë ekziston.

Duke qenë se në rastin e Kosovës kemi tre rrafshë të ndikimit të medias, që janë media si faktor ndikues në politikat ndërkombëtare, media si faktor ndikues në perceptimin e luftës nga ana e audiencës, dhe media si faktor ndikues në ndryshimin që po sjell në mënyrën se si ligjet dhe nocionet ligjore ndërkombëtare po ndryshojnë, kjo ishte një nga pikat që më së shumti është hasur vështirësi të argumentoj. Ekzistojnë teori dhe studime të shumta lidhur me median, sa që është një sfidë të përzgjedhësh ato që janë të aplikueshme për të argumentuar hipotezën e ngritur dhe përputhjen me faktet empirike.

Megjithatë, gjatë këtij kërkimi, pavarësisht vështirësive, ishte dhe një mënyrë e re për t'u njohur me disa prej teorive më të reja dhe perceptimeve të reja që ka për median dhe ndikimin e saj gjithmonë e më të madh, në sferat ku më parë impakti më i madh është bërë nga ana e faktorëve të tjerë, sikurse janë elitat dhe sistemet bazë të qeverisjes. Përzgjedhja më e vështirë ishte tek literatura për teoritë e medias, pasi si të tilla ato evoluojnë pothuajse çdo ditë. Këto teori, të cilat janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e medias, janë gjithmonë e më shumë në ndryshim, pikë së pari lidhur me mënyrën se si po zhvillohet media, dhe së dyti lidhur me zgjerimin e hapësirës se ku ajo po përhap ndikimin e saj.

Nëse deri para viteve '90 media perceptohej në formën bazë më së shumti, që ishin gazetat, radiot dhe televizionet, tashmë ajo ka një shtrirje shumë më të gjerë, kryesisht për shkak të zhvillimit teknologjik dhe mënyrës se si ajo e ka vënë në përdorim këtë teknologji. Si shembull më ekstrem të kësaj mund të marrim mediat sociale. Deri në vitet '90, ato luanin një rol të përciptë në përhapjen dhe ndikimin e informacionit, duke filluar me forma të thjeshta si 'chat room', por pas kësaj periudhe ajo fillon e merr një nocion krejt të ri, duke arritur në instanca të tilla, sa që sot mund të themi se mediat sociale luajnë një nga rolet më të rëndësishme në përhapjen e informacionit dhe ndikimin e tij. Ndoshta do të ishte interesante të përfshihej edhe kjo pjesë në studim, por kjo do ta zgjeronte së tepërmi studimin dhe do të ishte gati e pamundur që të nxirren të dhëna të sakta dhe koncize në këtë aspekt.

Pjesa e studimit më shumë e fokusuar është pjesa që analizon funksionin e medias në krijimin e sovranitetit të Kosovës, duke analizuar rolin e saj, para, gjatë, dhe pas luftës, kështu që fokusimi për periudhën e botimeve ishte i vështirë për arsye të periudhës të përzgjedhur në studim, ndërsa duhej theksuar evoluimi i informacionit për mënyrën e pasqyrimit të Kosovës në periudha historike të ndryshme. Pikërisht për këtë arsye, janë shqyrtuar botime që u referoheshin zhvillimeve të medias në periudhën kohore 1990-2012. Ndoshta kjo e ka bërë më të vështirë paraqitjen koncize të studimit, por ishte e rëndësishme fokusimi këssoj, për të pasur një matës të qartë, për të dhënë sa më shumë detaje dhe për të paraqitur sa më qartë strukturën e kërkimit.

Nëse fokusimi do bëhej vetëm në publikime mediale që janë para ose gjatë luftës, atëherë kërkimi nuk do të rezultonte i plotë, për vetë faktin se shumë nga të dhënat mund të analizohen vetëm nëpërmjet teorive që vijnë pas viteve 2005, ku filluan dhe botimet më të rifreskuara për sa i përket evoluimit të medias dhe ndryshimeve që sjell ajo në perceptimin e përgjithshëm të realitetit.

Etapa e tretë, mbledhja e të dhënave

Ndër pjesët më të vështira në kërkim, ishte mbledhja e të dhënave për të bërë të mundur analizimin e fakteve për këtë studim. Pavarësisht epokës teknologjike që jetojmë, është e vështirë të mblidhen të dhënat e duhura për këtë studim. Gjetja e të dhënave është bërë duke përdorur resurse që jo gjithmonë janë në dispozicion. Nëpërmjet bashkëpunëtorëve të huaj, më është mundësuar hapja e një llogarie që mund të qasej direkt në arkivat bazë të tre mediave kryesore në studim, CNN, BBC dhe REUTERS. Por, pavarësisht kësaj, kërkohej që të dhënat të grumbullohen dhe të shqyrtohen nga interneti, sepse të printosh një databazë të tërë të këtyre mediave është e pamundur, ndërsa vetëm letra dhe ngjyra që do duheshin për këtë, do të mjaftonin për të shtypur tre enciklopedi.

Arkivat bazë të këtyre tre mediave, të cilët janë të lirë për t'u vizituar kundrejt një pagese, të japin mundësinë e kërkimit në mënyrë specifike. Pasi regjistrohesh (log in) në arkivin qendror, ke mundësinë që të përzgjedhësh zonën për të cilën ke interes të lexosh, pastaj mund të kalosh në vendin dhe së fundmi mund të zgjedhësh periudhën kohore. Varianti i fundit që të ofrojnë është mundësia që të zgjedhësh artikuj në bazë të një fjale të caktuar. Kjo ishte mënyra që u përdor për të mbledhur informacionin e paraqitur në tabelat tek pjesa analitike e këtij studimi. Por, pavarësisht kësaj, përsëri është dashur të analizohen artikujt një më një, pasi kërkimi të mundëson të shohësh se sa artikuj ka që përmbajnë fjalën që ke kërkuar, dhe jo sa herë është përdorur ajo fjalë. Kështu që je i detyruar ta lexosh artikullin nga fillimi në fund që pastaj të mund të nxjerrësh se sa herë është përmendur ajo fjalë brenda artikullit. Një tjetër burim i rëndësishëm kanë qenë videot nga faqja e internetit 'You Tube', ku janë publikuar një pjesë e konsiderueshme e dokumentarëve për Kosovën, nga këto tre media. Mirëpo edhe kjo më vete paraqet një vështirësi, pasi një pjesë e mirë e këtyre dokumentarëve janë publikuar pas ngjarjes së konfliktit, pavarësisht se i dedikohen më së shumti periudhës së luftës. Si të tillë, kërkon një përjasje të artikujve të ngjashëm të gjetur në arkivat private të CNN, BBC dhe REUTERS, me videot e gjetura në internet, sepse këta dokumentarë nuk janë gjë tjetër pos një përmbledhje e

lajmeve dhe videove e fotografive, të mbledhura para, gjatë dhe pas luftës, dhe të redaktuara rishtas në formën e dokumentarëve në një periudhë të mëvonshme. Gjithashtu, ato kanë edhe një veçori tjetër, autorët nuk janë vetëm një ose dy, por ka raste që janë dhe pesë deri në gjashtë bashkautorë, duke bërë gati të pamundur specifikimin e një autori të vetëm. Kjo është një dukuri që ka ardhur si pasojë e bashkëpunimit të ngushtë që kanë pasur gazetarët ndërkombëtarë me ata vendorë. Kësisoj, edhe burimi i informacionit është pak a shumë i njëjtë, ndërsa si pasojë edhe mënyra e perceptimit e njëjtë, prandaj kërkon një analizim të detajuar për të arritur deri tek pjesa e dëshiruar për të bërë verifikimin dhe mbledhjen e saktë të të dhënave.

Duhet theksuar se ka qenë e pamundur ruajtja për një kohë të gjatë e qasjes në bazën e të dhënave qendrore të këtyre tri mediave, për dy arsye: e para është se kërkohet qasja me pagesë, e cila është e vlefshme vetëm për një vit, dhe e dyta është që mund të përdoren vetëm nëpërmjet kompjuterëve me IP të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për shkak të problemeve që ekzistojnë sot lidhur me piraterinë dhe vjedhjen e identitetit, çka gjithashtu mund të bëhet vetëm me pagesë duke u regjistruar në një VPN, i cili është një server që gjeneron IP-të amerikane për rrjetet ndërkombëtare.

Etapa e katërt, intervistimi i gazetarëve

Një tjetër pjesë e vështirë gjatë ndërtimit të këtij studimi, ishte realizimi i intervistave cilësore me gazetarët. Kjo jo vetëm për arsye se ka kaluar shumë kohë nga periudha e luftës në Kosovë, por edhe sepse në fillim të këtij hulumtimi synohej intervistimi i gazetarëve ndërkombëtarë që kishin shërbyer gjatë asaj periudhe në Kosovë. Pavarësisht eksplorimit të mundësive për të rënë në kontakt virtual me disa prej tyre, një gjë e tillë ishte e pamundur, për faktin se shumica e tyre tashmë me karrierë ishin nëpër botë. Por ajo që u shfaq si edhënë e re gjatë kërkimeve për kontakt me gazetarët ndërkombëtarë, është se ndonëse ata kanë qenë raportuesit dhe kameramanët e drejtpërdrejtë të këtyre mediave, si ndihmës interpretues fillimisht dhe me vonë si raportues të këtyre lajmeve, kanë qenë gazetarët vendorë. Ky është një proces që është shpjeguar

më hollësisht tek intervistat kualitative. Gjithashtu, vështirësia e intervistimit rezulton në gjetjen e saktë të mënyrës së thurjes së pyetjeve të intervistës, për të vërtetuar ose jo hipotezën e ngritur.

Së pari, ishte e vështirë të fokusi i intervistës, sepse po flasim për një periudhë që ka disa vite që ka përfunduar dhe vetëm kujtesa kompjuterike mund të jetë e saktë, por jo domosdoshmërisht ajo njerëzore; dhe e dyta, askush nuk dëshiron të rikujtojë ngjarjet dramatike të luftës së Kosovës kur i ka përjetuar ato drejtpërdrejtë. Për këtë arsye, edhe struktura e intervistës është ndarë në tre pjesë në përputhje me periudhat e marra në studim, si dhe në përputhje me të dhënat e mbledhura paraprakisht. Si të tilla, mund të them se ndonëse intervistat kanë dalë të gjata dhe deri diku mbase mund të jenë të lodhshme për lexuesin, sërish të dhënat që nxirren prej tyre, nëse përquasen me të dhënat e mbledhura nga burimet e tjera, japin një pasqyrë të plotë të situatës dhe mënyrës se si ka evoluar pasqyrimi mediatik i Kosovës.

Nga gazetarët e përzgjedhur për intervista, një pjesë nuk është arritur të kontaktohen për shkak të ndryshimeve të adresave dhe numrave të kontaktit, një pjesë mbase edhe ishin larguar jashtë vendit, dhe pjesa tjetër nuk kishte qenë shumë i përfshirë në raportimet nga terreni. Disa prej tyre vazhdojnë të jenë reporterë për Kosovën edhe sot e kësaj dite për këto media. Duke qenë se kanë raportuar për disa media, intervista është përqendruar te ata që kanë qenë më së shumti aktivë gjatë asaj periudhe, e që vazhdojnë dhe sot e kësaj dite të kenë një emër në mediat e Kosovës, si dhe vazhdojnë të jenë reporterë për media ndërkombëtare sikurse Reuters, AP, Al Jazeera, BIRN, dhe të tjera.

Vlen të përmendet fakti se këta gazetarë, pavarësisht se e filluan punën si pjesë e personelit ndihmës, u trajnuan dhe e morën profesionin nga gazetarët ndërkombëtarë që shoqëronin bashkë në shumë raste në vijën e parë gjatë krizës në Kosovë. Në këtë mënyrë, lidhjet që u krijuan natyrisht se kanë ndikuar në mënyrën se si gazetarët ndërkombëtarë e kanë parë situatën e Kosovës dhe se si e kanë raportuar atë në mediat ndërkombëtare. Pavarësisht

kësaj, duhet theksuar se të dhënat e nxjerra nga intervistat me gazetarët janë rastësore, dhe nuk ka një mënyrë efikase për të mbledhur të dhëna tjera të drejtpërdrejta nga terreni, por meqenëse këto përputhen me pjesën tjetër të gjetjeve, atëherë mund të theksojmë se këto reflektojnë fenomenin.

Etapja e pestë, renditja e informacionit

Pjesa e fundit që ka kërkuar një kujdes të veçantë dhe me mjaft vështirësi për t'u kaluar, ka qenë pjesa e gjetjes së një mënyre efikase për të paraqitur informacionin e mbledhur. Duhet pranuar se orientimi për këtë është shqyrtuar nga libri i autores Belina Budini "Tre kohë të Shqipërisë në syrin e "TIME" 1923-2013", por edhe nga literatura tjetër e shqyrtuar.

Ekszitojnë edhe shumë të dhëna të cilat duke qenë e pamundur të vërtetohen, janë lënë jashtë këtij studimi. Këtu mund të përfshihet si një nga informacionet më të vështira për t'u vërtetuar, fakti se ndonëse është vërtetuar ndikimi që kanë pasur gazetarët vendorë ndaj gazetarëve ndërkombëtarë, është shumë e vështirë të analizohet nëse ky ndikim ka qenë i kalkuluar nga ana e tyre, apo ka qenë diçka e pavetëdijshme, bazuar mbi lidhjet e ngushta mes njerëzve që janë dëshmitarë të ngjarjeve të rënda. Pra, është gati e pamundur të vërtetohet nëse kanë ndikuar në mënyrë rastësore gazetarët vendorë në mënyrën se si korrespondentët ndërkombëtarë filluan të perceptojnë Kosovën. Po të realizohej mundësia e kontaktit me korrespondentët ndërkombëtarë që kanë mbuluar ngjarjet e Kosovës në studim, për të realizuar të njëjtën intervistë, për të mësuar opinionin e tyre, mbase të dhënat mund të përqaseshin apo mund të argumentoheshin më shumë apo në formë tjetër.

Gjithashtu, një sfidë tjetër ishte gjetja e një strukture dhe mënyre koncize, që do të bënte të mundur një paraqitje ritmike të informacionit, për arsye se ky është një studim empirik i bazuar në mbledhjen e të dhënave të drejtpërdrejta dhe si i tillë është shumë i zgjeruar. Mbase mënyra që është zgjedhur për të paraqitur të dhënat faktike, do të kishte nevojë për më shumë përpunim, por synohej që faktet të flasin më shumë se sa fjalët, prandaj u vlerësua renditja e

informacionit në tabela që tregojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë se si rrodhi pjesa historike dhe se si e reflektoi media këtë, se sa ta komentohej me shumë fjalë. Kjo renditje informacioni, bën të mundur që të vendoset theksi në fjalët kyçe të përdorura nga media kur përshkruan Kosovën në këto tre faza. Është përzgjedhur formati i tabelave për arsye të thjeshtë se janë praktike dhe të lehta për t'u analizuar, ndërsa si të tilla i japin një mundësi më të madhe lexuesit që ta ndjekë autorin në atë çfarë ka dashur të faktojë. Duhet theksuar se është lënë jashtë studimit edhe një pjesë e informacionit të mbledhur, pasi ka qenë e pamundur të vërtetohej nëse ky informacion i siguruar dhe roli që kanë luajtur edhe media vendore siç është Koha Ditore, ka qenë i vetëdijshëm në manipulimin (nëse mund ta quajmë kështu), që ka bërë kundrejt audiencës ndërkombëtare apo jo. Pavarësisht se si një media vendore nuk ka pasur shumë emër në atë kohë në arenën ndërkombëtare, apo thënë më mirë në opinionin publik ndërkombëtar, sërish është një medium që ka pasur një rol aktiv gjatë luftës në Kosovë.

Si përfundim, duhet pranuar se ndonëse ka pasur të dhëna të mjaftueshme për të argumentuar se media ka ndikuar në ndryshimet e zhvillimeve politike të Kosovës, se ajo ka patur një rol në krijimin edhe fitimin e sovranitetit të Kosovës, si dhe që gazetarët vendorë kanë pasur një rol të rëndësishëm së veçantë për krijimin e këtij ndikimi, është gati e pamundur që të vërtetohet nëse ky ndikim ka ardhur në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme nga ana e këtyre gazetarëve. Megjithatë, fakti që ka pasur një rol të konsiderueshëm është i pamohueshëm.

1.6 Organizimi dhe struktura e punimit

Punimi është strukturuar në shtatë kapituj, ku pjesa e parë nis me një “Hyrje”, ku trajtohet në formë të përmbledhur objekti i studimit, qëllimi, hipoteza, pyetjet kërkimore, bazimi teorik dhe ai analitik, kufizimet dhe të dhëna tjera, që japin një vështrim të përgjithshëm mbi objektin e studimit. Ndër të tjera, kapitulli trajton edhe metodologjinë me instrumentet e përdorur për t'i dhënë përgjigje pyetjes kërkimore dhe me qëllim argumentimin e tezës. Në këtë

kapitull, është bërë një përshkrim i hollësishëm i mënyrës së kërkimit, mbledhjes së të dhënave dhe paraqitjes së tyre për të argumentuar tezën e ngritur.

Kapitulli i dytë, skeleti teorik dhe modeli analitik, trajton hollësisht rishikimin e literaturës, mbështetur në teoritë e shqyrtuara lidhur me objektin e studimit. Aspekti teorik i trajtimit është bazuar në teoritë klasike dhe moderne të komunikimit, por pjesa e analizës është përqendruar më së shumti tek ato moderne, jo vetëm se janë më aktuale, por se sqarojnë dhe referojnë analizimin e të dhënave të mbledhura nga mediat.

Kapitulli i tretë përfshin një përmbledhje nga konteksti historik mbi evoluimin e medias dhe të komunikimit, mbështetur në teori të komunikimit, duke përdorur disa shembuj konkretë. Në këtë kapitull, është përfshirë një kronologji e ngjarjeve historike të Kosovës, sipas këndit të trajtimit nga tre mediat në studim (BBC, CNN dhe REUTERS) dhe terminologjisë së përdorur nga ana e tyre.

Kapitulli i katërt, përfshin një historik të tre mediave të përzgjedhura në studim, për të ndërtuar një profil mbi historikun e tyre, shtrirjen dhe ndikimin e tyre global. Për më tepër, ky kapitull trajton rolin dhe ndikimin e këtyre mediave në krizën e Kosovës, duke paraqitur edhe një kronologji të ngjarjeve të përshkruar sipas tyre, në periudha të ndryshme kohore që përbëjnë objektin e studimit.

Pjesa analitike në këtë kapitull është e ndarë në tre pjesë. Seksioni i parë përmban të dhëna sasiore për përmendjen e Kosovës në këto tre media, në periudha të ndryshme kohore. Nga kjo vihet në dukje se Kosova njihet dhe ishte objekt trajtimi nga mediat ndërkombëtare, por theksi i veçantë i analizës është tek mënyra e ndryshimit të këndit të trajtimit në varësi të tematikës së raportimit, që do t'i bëjnë më vonë gjatë periudhës së krizës dhe pas. Nga kjo vërehet se nuk ishin të panjohura ngjarjet politike dhe keqtrajtimi që i bëhej palës shqiptare të popullit të Kosovës nga regjimi i atëhershëm jugosllav (i referohemi viteve '90), mirëpo trajtohej me një numër të vogël të artikujve mediatikë. Kjo mbase dhe për faktin e interesit dhe qasjes më të

kufizuar të mediave ndërkombëtare në informacionet mbi zhvillimet e asaj kohe. Më vonë, në periudhën e krizës, me theks të veçantë në fund të vitit '98, kjo qasje ndryshon tërësisht dhe fokus raportimi bëhen ngjarjet me tematikë humane, duke paraqitur popullatën civile shqiptare si viktimë të regjimit, represionit dhe dhunës së ushtruar nga pushteti serb. Seksioni i dytë përmban analizë të gjuhës gazetareske, konkretisht cilësimet që kanë përdorur më së shumti mediat ndërkombëtare në studim, gjatë referimit ndaj Kosovës dhe popullatës së vendit. Pavarësisht se në vitet '90 vihet re që ekzistonin cilësime të tilla si '*gjenocid ndaj shqiptarëve*', '*të drejta të shqiptarëve*', të përdorura në raportime për ngjarjet në Kosovë, sërish raportimi anonte më shumë duke cilësuar zhvillimet si '*konflikt fetar*', dhe ngjarje të tjera të ngjashme. Ndërsa, në vitin 1995 do të vihet re një cilësim tjetër shumë i shpeshtë, që është '*sulme terroriste të shqiptarëve*'. Dy vite më vonë, konkretisht në vitin 1997, në raportime për Kosovën fillon të përdoret cilësimi '*UÇK organizatë terroriste*', ku kjo e fundit do të ndryshojë në vitin 1999. Disa nga faktorët që ndikuan në ndryshimin e gjuhës së përdorur dhe cilësimeve ndaj ngjarjeve në Kosovë, janë parashtruar më hollësisht tek pjesa e analizës në kapitullin e katërt. Në po këtë kapitull, pjesa e tretë e analizës, përfshin të dhëna mbi burimet e informacionit të përdorur në periudha të ndryshme kohore, nga këto tre media. Kjo analizë paraqet një element tjetër të rëndësishëm, për faktin se pikërisht vetë prezenca e korrespondentëve ndërkombëtarë në Kosovë gjatë konfliktit, ndryshon dhe burimet e informacionit, çka ndikon edhe në mënyrën e ndërtimit të lajmeve për Kosovën.

Kapitulli i pestë përmban një analizë ligjërimi, dy artikuj (një nga BBC dhe një nga CNN) dhe disa fotografi (nga Reuters) të përzgjedhura për analizë, që janë publikuar në data të ndryshme, brenda periudhës në studim.

Sa i përket pjesës analitike, secila periudhë ka karakteristikat që lidhen me zhvillimet, por dallimi kryesor në ndërtimin e raportimeve për Kosovën, qëndron pikërisht në fund të vitit 1998 dhe gjatë vitit 1999 e më pas.

Kapitulli i gjashtë përmban intervistat cilësore të realizuara me persona të lidhur me median. Kjo pjesë paraqet një faktor të ri ndikues në mënyrën e raportimit për Kosovën dhe perceptimin e opinionit publik ndërkombëtar. Në të vërtetë, kjo paraqet një karakteristikë të veçantë, se si persona të rinj në moshë, përjetues të ngjarjeve në mënyra të ndryshme gjatë krizës dhe pa përvojë të mirëfilltë në gazetari, arritën të ndikojnë në paraqitjen dhe raportimin e ngjarjeve në një këndvështrim tjetër.

Kapitulli i shtatë paraqet një përmbledhje të përgjithshme të objektit të studimit, gjetjeve dhe përfundimeve.

Në fund të punimit është paraqitur bibliografia që përfshin burimet parësore dhe dytësore të shfrytëzuara gjatë realizimit të studimit. Ndërsa tek pjesa e shtojcave është bashkëngjitur formati i pyetësorit, artikujt e analizuar, fotografitë e analizuara dhe disa artikuj të tjerë ilustrues mbi ato çfarë janë trajtuar në realizimin e këtij studimi.

KAPITULLI II: SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK

2.1 Debate bashkohore mbi metoda dhe teori të aplikuara

Është më se e pranueshme që në ditët e sotme jetojmë në epokën e komunikimit dhe njerëzimi ka arritur që fantazitë e përrallave t'i kthejë në realitet, duke investuar në dije dhe teknologji; kështu që edhe format e mëhershme të komunikimit vazhdojnë të jenë efektive, por i janë përshtatur teknologjisë së re të aplikuar. Gjithashtu, si shumë tipare të trashëguara që po evoluojnë, edhe vetë komunikimi është në evoluim dhe sidomos njësia më bazë e tij në kohët moderne, që është media. Në këtë aspekt, një nga pjesët kryesore të këtij studimi është një kapitull i veçantë vetëm sa i përket evoluimit të komunikimit dhe mënyrës se si e ka detyruar edhe shoqërinë tonë të përshtatet. Më tepër është shprehur interes jo vetëm në evoluimin e komunikimit, por edhe në atë se si janë evoluuar teoritë e ndryshme të tij. Theksohet ky vështrim për faktin se ndonëse në pamje të parë krijohet përshtypje se objekt studimi janë dy kërkime të veçanta, që janë 'media si institucion' dhe mënyra se si ajo po transformohet, duke sjellë trajta të reja të rolit dhe ndikimit të saj, gjithsesi ky mbetet një studim që ka për qëllim të vërtetojë se paraqitja mediatike ndërkombëtare e Kosovës, është një faktor që nxiti ndryshime në statusin e sovranitetit shtetëror të Kosovës dhe nuk është vetëm një evoluim i thjeshtë i ngjarjeve historike që çuan në këtë sovranitet.

Në pjesën e parë të këtij kërkimi bëhet një parashtrim i tyre, për arsye se pjesa teorike kërkimore e doktoratës është bazuar pikërisht në këto teori dhe në mënyrën se si ato u aplikuan në rastin e Kosovës.

Literaturë me debate mbi mënyrën se si në shoqëritë liberale efekti i mediave nxit në vendimmarrje politikën e jashtme, është shkruar gjerësisht në shkencat sociale. Ndër debatet e diskutueshme mbetet shpjegimi i mekanizmit të influencës ndërmjet medias dhe

qeverisë. Në shumë raste, dijetarët trajtojnë këtë raport ndërmjet tyre si shkak dhe pasojë, por pa shpjeguar si saktësisht media mund të ndikojë apo të bëjë 'presion' mbi qeverinë. Për disa studiues media është ajo që ushtron presion mbi qeverinë, për disa të tjerë qeveria është ajo që manipulon dhe kontrollon median, ndërsa për një pjesë tjetër ekziston një lloj influence e përbashkët ndërmjet tyre në procese të vendimmarrjes (Miller, 2007).

Një pjesë e madhe e studimeve rreth efektit të mediave në politikën e jashtme, datojnë nga vitet '90. Studiuesit Steven Livingston dhe Tod Eachus kanë sjellë në debat *Efektin CNN*, të cilën e përshkruajnë si teoria e humbjes së kontrollit të politikës (nga elita vendimmarrëse) në lajme të medias. Ata realizuan një rast studimi të thellë lidhur me operacionin ushtarak të SHBA-së në Somali. Në vitin 1992, Shtetet e Bashkuara ndërhyjnë në Somali për të ndihmuar popullatën e këtij vendi, pas rënies së qeverisë kur anarkia goditi shtetin (Miller, 2007). Livingston dhe Eachus donin të dinin nëse me të vërtetë presioni nga televizioni dhe media e shkruar kishte çuar në vendimet e para në lidhje me ndërhyrjen e SHBA-së në Somali. Fillimisht ata kryen një analizë të përmbajtjes së llogarive të lajmeve për Somalinë në media të ndryshme, ndërmjet fundit të vitit 1991 dhe dhjetorit 1992. Së dyti, ata intervistuan zyrtarët dhe gazetarët lidhur me ngjarjet, dhe arritën në përfundimin se vendimi për të ndërhyrë ishte rezultat i veprimeve diplomatike dhe burokratike, me mbulim të lajmeve që vijnë në përgjigje të këtyre vendimeve (Miller, 2007).

Livingston dhe Eachus hodhën poshtë konkludimet e mëparshme se vendimi fillestar për të ndërhyrë në Somali është shkaktuar nga media, siç kishte sugjeruar Kennan, një konkluzion ky që bëri jehonë nga Piers Robinson në librin e tij mbi *Effektin CNN* (2002). Ajo çfarë ata tregojnë është se mbulimi mediatik i Somalisë është në përputhje me teorinë e W. Lance Bennett të 'indeksimit të lajmeve', e cila thotë se raportet e lajmeve kanë tendencë për të ndjekur ngjarjet e veprimeve zyrtare dhe deklaratat e elitave politike.

Rreth rastit të Somalisë, Jonathan Mermin paraqet një vështrim të ndryshëm nga Livingston dhe Eachus. Ai thotë se argumenti që televizioni i ka kontribuar ndërhyrjes së SHBA-së në Somali, është mbështetur nga kronologjia e ngjarjeve dhe lajmeve të paraqitura, dhe se nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se paraqitja e Somalisë në televizionin amerikan para ndryshimeve të mëdha në politikën e SHBA-së, në gusht dhe nëntor të vitit 1992, ka ndikuar në vendimin e administratës së Bushit për të vepruar. Por sipas tij, ajo që nuk është e qartë, është se pse Somalia u shfaq në televizion në vendin e parë, një pyetje kjo për të kuptuar qëllimin dhe karakterin e ndikimit të televizionit në politikën e jashtme (Miller, 2007).

Një tjetër studim, nga autorët John Zaller dhe Dennis Chui, i quajtur "Government's Little Helper: US Press Coverage of Foreign Policy Crises, 1945–1991", mbështeti teorinë e indeksimit të W.L. Bennett. Zaller kritikon Bennett duke theksuar se studimi i tij ka dështuar të zhvillojë një matje të pavarur të opinionit të kongresit. Kjo matje e pavarur do të ishte e rëndësishme për shkak se do të kishte bërë të qartë distancën në mes mendimeve zyrtare dhe mënyrës se si ato janë raportuar. Zaller argumenton se gazetarët mund të kenë përdorur burime informacioni zyrtare, në mënyrë selektive ose duke shtrembëruar qëndrimet e tyre, në mënyrë që të prodhojnë rezultatet që gazetarët dëshirojnë dhe jo ato që burime kanë kërkuar (Miller, 2007).

Piers Robinson shkroi një artikull duke theksuar se çfarë nënkuptohet me termin 'CNN Effect' në lidhje me ndërhyrjen perëndimore në krizat humanitare. Duke iu referuar modelit të propagandës së Herman dhe Chomsky, ai argumenton se nëpërmjet mjeteve shtrënguese dhe shpesh të fshehta, qeveria përcakton axhendën e medias dhe tregon se ajo është në përputhje me modelin e *Efektit CNN*.

Robinson prezanton një ‘model’ të bashkëveprimit media-politikë dhe argumenton se hulumtimi në *Efektin CNN* dështon për të sqaruar nëse lajmet e medias janë apo jo, ato që kanë shkaktuar ndërhyrjet e fundit humanitare.

Zaller dhe Chui janë të interesuar kryesisht në çështjen e komunikimit, se si fjalët e medias, tingujt dhe imazhet mund të ndikojnë në procese të vendimmarrjes së politikës së jashtme. Ndërsa Herman dhe Chomsky janë të interesuar për ‘fushën e lojës’ në të cilën aktet e komunikimit janë duke u zhvilluar. Sipas tyre, kufizimet strukturore të tilla si pushtet i centralizuar dhe pronësia e shtëpive mediatike, përcaktojnë se çfarë mund dhe çfarë nuk mund të adresohet.

Diskutimi rastësor në marrëdhëniet media-qeveri dhe vendimmarrje, ka një tendencë të dukshme për të theksuar fuqinë e medias për t’i dhënë formë axhendës së qeverisë, në mënyrë të tërthortë përmes mekanizmit të opinionit publik. Në të vërtetë, studiuesit e interesuar në hulumtime empirike apo në ndërtimin e teorisë në lidhje me çështjen e ndikimit të medias në vendimmarrje, theksojnë se është teknologjia dhe përparimet teknologjike në komunikim, që kanë ngritur pyetje dhe debate sot në lidhje me fuqinë e medias dhe ‘presionin’ në vendimmarrje.

2.2 Masmedia, prodhimi social i lajmit dhe efektet e mediave

“Masmediat kanë aftësinë që ta transferojnë interesin për artikujt nga axhenda e tyre e lajmeve tek axhenda publike.” (M. McCombs dhe D. Shaw)⁴

Meqenëse mundësitë për komunikim të drejtpërdrejtë në mes të qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre janë të kufizuara, masmedia shërben si lidhje kryesore ndërmjet tyre (Veltmer, 2006). Megjithatë, mediat nuk janë vetëm kanale që transmetojnë mesazhet të cilat politikanët duan që ata t’i komunikojnë me votuesit, por është e rëndësishme edhe mënyra se si ato paraqesin çështjet politike. Mediat kanë një ndikim të rëndësishëm në atë

⁴ Cituar nga libri *Vështrim i parë mbi Teorinë e Komunikimit* (botimi i nëntë) të autorëve E. Griffin, A. Ledbetter, G. Sparks, B. Budini dhe B. Gjergji; fq. 371.

që komunikohet në sferën publike dhe në atë çfarë lënë jashtë, duke vendosur axhendën e debatit politik (Votmer, 2006).

Një mënyrë e mirë se si gazetarët arrijnë të ndërtojnë një lajm tërheqës për syrin dhe veshin e audicencës, është dramatizimi dhe personalizimi i ngjarjes që ata bëjnë, sidomos në formatet e paraqitjes së konflikteve (Votmer, 2006).

Teoricientët e konstruksionit social të realitetit, Thomas Luckmann dhe Peter Berger sugjerojnë se vet shoqëria është një konstrukt dhe realiteti ndërtohet shoqërisht. Sipas teorisë së tyre, sistemi social është ai që prodhon përmbajtjen mediatike, pra vet organizatat mediatike dhe personeli i tyre janë prodhuesit e lomit (duke vendosur se çfarë përbën lajm), ndërsa përzgjedhja dhe përgatitja e lajmeve përcaktohet nga disa faktorë, të tillë si personeli i tyre profesional, lidhjet dhe burimet e informacionit (Budini, 2014). Rasti i Kosovës në studim, është bërë përpjekje të referohet në qasjen e konstruksionit në nivel tekstual.

Studiuesit dhe autorët e teorisë së përcaktimit të axhendës, Maxwell McCombs dhe Donald Shaw, sugjerojnë se nuk janë reporterët profesionalë ata që influencojnë ‘qëllimshëm’ audiencën, por është vet audienca ajo që kërkon çështjet dhe lajmet për t’u kushtuar vëmendje, mbështetur në reputacionin e medias dhe të reporterëve të pavarur.⁵ Edhe Walter Lippman argumentoi se mediat veprojnë si ndërmjetësuese të asaj çfarë shohim në media dhe mënyra se si e përceptojmë.

Efektet e mediave lidhen ngushtë me teknologjinë gjithmonë në zhvillim, ndërsa studiuesit e komunikimit përpiqen vazhdimisht të dokumentojnë efektet e këtyre ndryshimeve. Pavarësisht se studimet lidhur me efektet dhe ndikimin e medias vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, kërkime dhe argumente të ndryshme se si përmbajtja e mediave ndikon sjelljen, datojnë që në periudhën 1980-1990. Studiuesi i mediave Dolf Zillmann thekson ndikimin

⁵ Cituar nga libri *Vështrim i parë mbi Teorinë e Komunikimit* (botimi i nëntë) të autorëve E. Griffin, A. Ledbetter, G. Sparks, B. Budini dhe B. Gjergji; fq. 371.

në aspektin emocional që televizioni transmeton tek audienca. Ai thekson se ‘*televizioni ka fuqinë që të ngjallë ndjenja të forta*.’⁶

Një shembull konkret i një ndikimi emocional është rasti i konfliktit të Kosovës, kur imazhet e masakrave më të mëdha të kryera brenda periudhës 1998–1999, pushtuan ekranet e mediave ndërkombëtare, të cilat raportnin si lajm kryesor krizën në Kosovë, duke e cilësuar si luftë civile. Ishin pikërisht masakrat dhe refugjatët ato që ndikuan emocionalisht opinionin ndërkombëtar, përfshirë politikëbërësit (Masakra në Drenicë në fund të muajit shkurt dhe fillim të muajit mars 1998, Masakra në Obri të Madhe në shtator të vitit 1998, Masakra e Reçakut në janar të vitit 1999)⁷, dhe që nxitën politikën ndërkombëtare për të marrë vendim për ndërhyrje ushtarake humanitare të NATO-s, duke parë se bisedimet në Rambuje nuk po sillnin rezultat (Bahador, 2007).

Pavarësisht se kishte edhe raportime që pasqyronin ngjarjet si konflikt mes një grupi të ashtuquajtur terrorist⁸ me forcat e armatosura serbe, sërish kjo qasje nuk arriti të ndryshojë perceptimin për atë çka po ndodhte. Pra, çfarë ndodhi që i shtyu fuqitë më të mëdha politike, si aleatë të veprojnë në krizën e Kosovës? Ishte pikërisht efekti i medias që nxiti këtë.

Përmes rastit të Kosovës, mëtohet argumentimi se ky rol dhe ky ndikim mediatik po transformohet në varësi të komponentëve të rinj, duke e çuar rrugëtimin e medias drejt një institucioni vendimmarrës. Natyrisht, kjo është një teori që do fakte dhe raste të tjera të provuara, por gjithsesi përmes këtij rasti si shembull, sado pak kjo del në pah.

⁶ Cituar nga libri *Vështrim i parë mbi Teorinë e Komunikimit* (botimi i nëntë) të autorëve E. Griffin, A. Ledbetter, G. Sparks, B. Budini dhe B. Gjergji; fq. 348.

⁷ Bahador, B. (2007). *The CNN Effect in Action. How the News Media Pushed the West toward War in Kosovo*. The Palgrave Macmillan series in International Political Communication, New York.

⁸ Në disa raportime të mediave ndërkombëtare, UÇK cilësohej si organizatë guerile, terroriste. Por këto raportime i referohen kryesisht periudhës kur burime informacioni ishin ato zyrtare serbe, apo media serbe, për të cilat është bërë një analizë në kapituj në vazhdim. Disa nga artikujt ku UÇK cilësohet si e tillë, janë bashkëngjitur tek pjesa e Shtojcave në fund të punimit. Gjithashtu, një analizë e këtyre cilësimeve si ka ndryshuar ndër vite, është bashkëngjitur në pjesën e tabelave tek shtojcat.

2.3 Gjenezja dhe evoluimi në shoqëritë masmediatike

Masmedia dhe media kryesisht janë sot burimet që kontrollojnë informacionin në të gjitha fushat e jetës sociale. Ato fillojnë që nga aktivitetet e thjeshta siç është argëtimi dhe deri tek çështjet më madhore siç është shtetformimi. Megjithatë, roli i tyre në shoqëritë post-komuniste është shumë më i veçantë krahasuar me shoqëritë demokratike të konsoliduara. Është interesante të studiohet se si veprojnë këto media, veçanërisht të shkruarat, pasi shumica e përvojës së tyre vjen nga e kaluara komuniste dhe me gjithë gjakun e ri që i furnizon, ato përsëri mbeten një mentalitet që ndikon në mënyrën se si ato mendojnë dhe shkruajnë (Schorn, 2006).

Modeli i propagandës i autorëve Herman dhe Chomsky, pretendon se gazetarët dhe mediat janë mjete propagandistike, të cilat elita i përdor për të nxitur pëlqimin e masave, me qëllim që të përcjellin interesat e tyre nën maskën e interesave kolektive. Si shembull, në politikën e jashtme ato çfarë paraqiten si interesat e një kombi, në fakt mund të jenë interesat e vërteta vetëm të elitës brenda atij shteti dhe mund të jenë të dëmshme për shtresat e varfra punëtore (Herman, Chomsky, 1994). Modelet hegjemoniste argumentojnë se sistemet e mediave pasqyrojnë shpërndarjen e fuqisë ekonomike, politike dhe simbolike në shoqëri. Teoricienët hegjemonistë pretendojnë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës e bombarduan Serbinë për të treguar dominimin e saj mbi Evropën dhe për të ruajtur hegjemoninë e saj globale (Bahador, 2007).

Në fakt, ndërhyrja ushtarake humanitare e vitit 1999 në Kosovë, nuk ishte një ndërhyrje në parandalimin e një lufte midis ushtrive. Për demokracitë perëndimore, vendimet për luftën dhe vendimmarrja gjatë luftës, janë çështjet shoqërore që përfshijnë njerëzit, qeverinë dhe ushtrinë, dhe se në kontekstin e luftës, thuhet se mediat mund të ndikojnë në të tre fushat (Bahador, 2007).

Rëndësia e opinionit publik, me theks të veçantë në politikën e jashtme, është subjekt i një debati të madh. Në shumicën e interpretimeve të efektit mediatik, opinionit publik besohet të jetë

ndërmjetësi kryesor në mes të mediave dhe politikës. Jeremy Bentham dhe James Mill besojnë se opinionimi publik nëse lejohet të lulëzojë, gjithmonë mund të llogaritet si një forcë racionale për të mirë (Bahador, 2007). Në të vërtetë, në një skenar të idealizuar, imazhet e mediave besohet të çojnë në kërkesa publike për veprim, efekt ky që i vë në presion politikanët. Në të kaluarën, në mungesë të transmetuesve globalë dhe qasjes publike në media, shumë mizori të kryera në konfliktet e largëta mes palëve të tjera nuk njiheshin (Bahador, 2007).

Siç dihet tashmë botërisht, sipas Habermasit, mediat sot janë pikat kyçe të modernizimit dhe komunikimit midis aktorëve kryesorë të shoqërisë, që janë qytetari, strukturat shoqërore dhe mediat (Habermas, 1991). Në momentin që ky lloj komunikimi është në varësi të një strukture, që në vendet demokratike është kryesisht e varur nga biznesi, ndërsa në vendet post-komuniste ende është në varësi kryesisht të subjekteve të ndryshme politike, çfarë lloj propagande pro sociale mund të ndërmarrin ato? (Chomsky, Herman, 1994). Për të vërtetuar rëndësinë që merr kjo pyetje, le t'i drejtohem një faktori të thjeshtë, që është gjithëpërfshirës për vendet postkomuniste dhe perëndimore.

2.4 Media si institucion social

Masmedia po vepron si një institucion social, duke qenë se ajo kryen shumë prej funksioneve që më parë kryheshin nga institucionet tradicionale sociale, të tilla si kisha, shkolla, qeveria dhe familja (Silverblatt, 2004).

Megjithatë, në vendet perëndimore, sidomos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sistemet e mediave private asnjëherë nuk kanë synuar të shërbejnë si një institucion social. Ndaj, objektivi kryesor i një organizate në pronësi private është të nxjerrë fitime. Kësisoj, shumë filma, programe televizive, faqe elektronike të internetit, gazeta dhe revista, janë projektuar për të tërhequr audiencën më të madhe të imagjinueshme. Mesazhet që përmbajnë këto programe mund të jenë të paqarta, ose përçarëse për publikun, në shumicën e rasteve për qëllime të caktuara, apo thënë ndryshe ka disa strategji për orientimin e opinionit publik në

një mënyrë të caktuar. Por, nëse në pjesën perëndimore ka strategji për të mbrojtur interesat e grupeve të ndryshme, në botën lindore bëhet fjalë për strategji që imponohen nga një grup i vetëm interesi, e që janë partitë e krijuara pas rrëzimit të regjimeve komuniste. Në shumicën e rasteve, këto parti nuk janë gjë tjetër veçse një vazhdim i partive që kanë qenë në pushtet (Silverblatt, 2004).

Por le t'i marrim me radhë. Së pari, le të shohim karakteristikat e institucioneve sociale që sot mbulohen nga mediat, sipas Art Silverbratt-it, i cili krahason se si është përdorur media dhe si interpretohet ajo në vende të tjera përkundrejt shoqërive perëndimore. Disa nga funksionet e medias si institucion social, sipas Silverbratt-it, përshkruhen në vijim:

Anëtarësimi në një grup. Mediat u ofrojnë individëve ndjenjën e përkatësisë përmes anëtarësimit në një grup. Nuk janë të pakta rastet kur njerëzit hyjnë në bisedë me njëri-tjetrin vetëm se blejnë të njëjtën gazetë.

Hapja e grupit ndaj njerëzve të tjerë. Shoqëria mund të jetë shumë e shtresëzuar dhe e mbyllur, siç mund të dëshmojnë njerëzit që shpërngulen nga një vend në tjetrin. Por sot, ekzistojnë media të posaçme, roli i të cilave është orientimi dhe integrimi sa më i shpejtë i këtyre njerëzve në vendbanimin e ri; si shembull mund të marrim revista të ndryshme që ofrojnë kontakte që nga gjetja e një apartamenti, deri te takimet me të panjohur.

Bashkon grupet e ndryshme të njerëzve. Mediat sigurojnë një eksperiencë të përbashkët për njerëzit të cilët përndryshe nuk do të ndërvepronin me njëri-tjetrin, ose do të ndërvepronin në mënyrë minimale.

Krijimi i ndjenjës së rendit. Në mes të kaosit të jetës, qeniet njerëzore dëshirojnë të jetojnë në stabilitet. Në këtë drejtim, mediat bëjnë të mundur kapjen e thelbit të mënyrës së jetesës së njerëzve. Lajmet dhe historitë e ndryshme tregojnë se nuk janë të paktë ata që kanë përjetuar një ndjenjë të caktuar.

Ndihmojnë njerëzit që të përballen apo të përshtaten me ndryshimin. Çdo institucion social ka ritualet e veta për të ndihmuar individët të përshtaten me ndryshime të pashmangshme në jetë. Sot, mediat janë aktorët që jo vetëm i kryejnë këto rituale, por edhe i hartojnë ato. Në këtë kontekst, efikasiteti i tyre bazohet në eksperiencën dhe botëkuptimin e tyre dhe të shoqërisë prej nga vijnë.

Përcaktimi i suksesit apo/dhe dështimit. Çdo institucion shoqëror ka përkufizimet e veta të suksesit dhe dështimit bazuar në sistemin e vlerave të institucionit. Në përgjithësi, këto vlera në rastin e medias janë të bazuara në sistemin e etikës, në zbatimin apo mungesën e saj, po edhe në mënyrën se si perceptohet shoqëria që ajo përfaqëson. Një shembull konkret i këtij rasti janë idhujt e muzikës që krijohen kryesisht vetëm nëpërmjet medias; dështimi apo sukcesi i tyre varet vetëm nga sa ata janë të pranishëm në media. Edhe mitizimi i tyre është gjithashtu në varësi të medias. E theksoj këtë, sepse ky aspekt është i rëndësishëm për mënyrën se si media percepton Kosovën dhe për pasojë edhe mënyra se si e interpreton atë.

Afirmimi i vlerave. Çdo institucion social përkufizohet nga grupi i vet i vlerave. Për shembull, bota e arsimit mban vlerën e të mësuarit. Për më tepër, anëtarësimi në një institucion shoqëror afirmon sistemin e individit si vlerë. Ne i përkasim një grupi të formuar nga njerëz që kanë të njëjtat vlera dhe kjo i ofron siguri individit. Si të këtillë, ne jemi të prirë të formojmë lidhje më të ngushta me njerëz që përjetojnë situata të ngjashme, se sa me njerëz me të cilët kemi pikëpamje të kundërta, siç ishte rasti i fikserëve vendorë me gazetarët ndërkombëtarë në Kosovë.

Vendosja e rregullave të sjelljes. Sot, media është ajo që cakton rregullat e sjelljes për anëtarët e saj.

Sigurimi i një kuptimi të drejtimit/qëllimit. Institucionet sociale i drejtojnë individët në një rrugë që ata mund ta ndjekin për të arritur suksesin dhe realizimin, siç përkufizohet nga institucioni në veçanti.

Kontrollimi i sjelljes devijuese. Institucionet në përgjithësi lejojnë një larmi të sjelljeve nga anëtarët e tyre. Megjithatë, që të mbeten anëtarë të institucionit, individët duhet t'i përmbahen parimeve themelore dhe udhëzimeve të tij (Silverblatt, 2004).

Duke pasur parasysh këto karakteristika, do të shqyrtojmë situatën vështuar nga aspekti i efikasitetit të këtyre mediave në vendet post komuniste. Siç duket nga shtjellimi i mësipërm, aftësia e shoqërive për t'u integruar në institucionet dhe strukturat e BE-së është përgjithësisht në varësi të mediave, pasi ato përmbushin të gjitha rolet bazë që më parë përmbusheshin nga institucione të ndryshme sociale.

Ajo çfarë ka ndryshuar në mijëvjeçarin e fundit, qysh nga momenti kur media doli për herë të parë në treg, janë tre faktorë që ndryshojnë mënyrën se si sillet media në shekullin e 21. Faktorët bazë të cilëve u referohemi janë: teknologjia, lëkundja e besimit te tre pushtetet e tjera dhe globalizimi i jetës njerëzore (Robinson, 2005). Secili prej tyre nëse shihet në këndin e gjerë dhe të përgjithshëm, krijon përshtypjen sikur nuk sjell një impakt të fortë në përgjithësi, por ato janë arsyt bazë të një transformimi të përgjithshëm që po kalon media aktualisht.

Ndonëse është e vështirë që të merren të ndarë këta tre elementë që ndikojnë në mënyrën se si po transformohet media, përsëri ka hapësirë të mjaftueshme për një studim tjetër. Sidoqoftë, në këtë studim këta faktorë janë cekur vetëm në mënyrë sipërfaqësore, pasi synimi i kësaj teze është të faktojë se si media duke vepruar si vendimmarrëse, solli sovranitetin e Kosovës, dhe jo shkaqet që kanë sjellë evoluimin e medias nga një institucion informues drejt rolit të saj vendimmarrës.

2.5 Efikasiteti i mediave dhe roli i tyre

Duke pasur parasysh se media është institucioni bazë social i tanishëm, që bën anëtarësimin në një grup, sigurimin e qasjes në grupe dhe njerëz të tjerë, bashkon grupe të ndryshme njerëzore, vendos ndjenjën e rendit, ndihmon njerëzit të luftojnë apo të përshtaten me ndryshimin, përcakton suksesin dhe dështimin, përcakton afirmimin e vlerave, vendos rregulla të sjelljes,

siguron një kuptim të drejtimit dhe qëllimit, edukimit, kontrollimit të sjelljes devijuese (Grindle, 2010), mund të themi se krijimi i një identiteti të ri përfaqësues për Kosovën në Bashkimin Evropian (ndryshimi i perceptimit që ka Evropa për Kosovën), nuk është gjë tjetër vetëm një përshtatshmëri siç u theksua më sipër. Pra, media bën përshtatjen e vlerave normative, morale, sociale dhe kulturore të vendeve të BE-së me traditën e trashëguar nga këto vende, por në momentin që media rezulton e varur, e cinguar dhe e auto-censuruar, sa efektive mund të jetë? Pjesa më e madhe e këtij mosefikasiteti vjen nga vetë mungesa e legjislacionit në fuqi dhe nga një mentalitet i trashëguar që fatkeqësisht po shkon në stafetë nga një brez tek tjetri, duke bërë që këto vende të mbeten në një 'statusquo' të vazhdueshme. Ndaj, hapi i parë për të ndryshuar një situatë të tillë, është rikonfigurimi i ligjeve të mediave dhe një monitorim më i afërt i tyre nga organizata që nuk kanë shumë lidhje me politikën. Mediat duhet të kryejnë funksionin e tyre informues, sidomos në vende me demokraci të brishtë. Duke qenë të pavarura në raportim dhe jo të manipuluar nga politika, ato mund të bëhen aleatë në procesin e shtetformimit, sikurse në rastin e Kosovës.

Krijimi i sovranitetit të një kombi është një koncept i njohur për zhvillimin demokratik në shumë vende të botës, përfshirë edhe Kosovën. Ky nocion është një derivat i drejtpërdrejtë i organizimit në shtete, për të pasur të drejtën e vetëqeverisjes.

Për miliona njerëz në mbarë botën të cilët jetojnë në kushte të pasigurisë dhe mungesës së stabilitetit publik, korrupsionit, abuzimit të ligjit, dështimit të administratës publike, varfërisë dhe pabarazisë, mbrojtja e shtetit është një fanar i asaj çka duhet të jetë shoqëria (Grindle, 2010), por ka raste kur këto tipare janë edhe më të theksuara, siç ishte rasti i Kosovës dhe i qeverisjes së saj nga një palë e tretë. Për shkak të kësaj gjendjeje të paqëndrueshme, mbrojtja e shtetit është rritur me shpejtësi dhe po bëhet një model i mirë për analizimin e suksesit të kësaj dukurie në vendet që po luftojnë për zhvillimin ekonomik dhe politik, sikurse Kosova, si dhe

analizimin e zhdukjes së kësaj dukurie në vendet që janë të qëndrueshme në zhvillimin ekonomik dhe politik, siç janë vendet e Evropës Perëndimore.

Është me interes të veçantë të theksojmë se ndonëse këto si iniciativa i përkasin një periudhe pak a shumë të teknologjisë së lartë, periudhë kjo kur mikroçipi hyn në industri në vitet '70 në vendet perëndimore dhe bëhet njësi bazë e prodhimit, ngritjen e vërtetë teknologjia e arrin pas viteve 1990 (Technological Evolution, 1999).

Me hedhjen e satelitëve në hapësirë dhe me mundësimin e qasjes në mënyrë masive, për një pjesë të madhe të popullatës u krijua një mundësi që më parë ishte gati krejtësisht e pamundur. Prodhimi me kosto të ulët i pajisjeve elektronike të komunikimit (telefon, kompjuter, celular, tabloid, etj.) bëri të mundur 'hyrjen' e drejtpërdrejtë në informacion të një numri të madh të popullatës mbarëbotërore, si dhe qasjen e drejtpërdrejtë të tyre në lajmet e përditshme.

Nëse deri në vitet '80, lajmet më së shumti kishin një karakter individualist dhe të kufizuar në marrjen e tyre, pas viteve '90 ato kthehen në një informacion ndërveprues gjithëpërfshirës dhe të pakufizuar. Natyrisht, ky është tipar më së shumti i botës perëndimore, por filizat e parë gjenden edhe në Ballkanin e prapambetur për periudhën në fjalë. Ishte pikërisht ky 'boom' masiv i teknologjisë dhe mënyra se si e ktheu informacionin nga elitë (konsideruar me atë që ndodh pas viteve '90) në gjithëpërfshirës, që i dha medias aftësinë e parë për të kthyer një pjesë të drejtimit të saj, nga thjesht përçues informacioni, drejt një 'institucioni vendimmarrës'. Duke pasur parasysh se një gazetar mund të arrijë një përqindje të madhe në audiencë, përfshirë shikues, lexues apo dëgjues në mbarë botën, aq më e lartë është përqindja e atyre që e perceptojnë këtë mesazh. Ndërsa, si gjithmonë, ka fuqi ai që komandon turmën (Herman, 2005).

Ndoshta 'boom-i teknologjik' nuk do kishte luajtur një rol të madh, po të mos ishte dhe një faktor tjetër që iu bashkëngjiti ngritjes së teknologjisë në këtë periudhë. Hulumtuesit e kanë miratuar këtë koncept si një mënyrë për të eksploruar dështimin institucional dhe kufizimet e saj në rritje. Ndërkaq, avokatët e kanë lidhur atë me avancimin e një sërë çështjeve të

përmirësimit të qeverisjes (Grindle, 2010). Ndërsa nga viti 2000, një pjesë e rëndësishme e agjendës zhvillimore ishte e lidhur me një program të qeverisjes së mirë, me ç'rast agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit krijuan departamentet e qeverisjes, punësuan këshilltarë dhe kërkues të këtij lëmi, duke përfshirë komponentët e qeverisjes në paketat e tyre të asistencës dhe rritjen e financimit për iniciativat e qeverisjes së mirë (Grindle, 2010). Theksohet ky fakt, sepse hapi i parë i ndërhyrjes në Kosovë është pasojë e kësaj mënyre të re të perceptimit të realitetit dhe mënyrës se si duhet të qeveriset një shtet. Ndryshimi i politikave të jashtme dhe legjitimitimi i ndërhyrjes ndërkombëtare në një vend sovran, jashtë territorit të tyre, është një ndryshim që vjen pas viteve '90.

Mbështetja e vendeve të Ballkanit për ndryshimin e pushteteve që u bën bota perëndimore, është një nga shembujt konkretë që mund të përmendet. Ndërhyrjet ushtarake në vende ku perceptimi i qeverisjes së mirë dhe demokratike ishin jashtë normativave perëndimore, janë ndër pasojat e kësaj ndërhyrjeje.

Megjithëse ka pasur shumë projekte, debate dhe investime, sot ne duhet të pranojmë se përpjekjet kanë dështuar, sidomos në Evropën Lindore. Përvoja në këto vende tërheq vëmendjen e nevojshme për të mbështetur menaxhimin ekonomik dhe politik, por megjithatë, kjo ide ka rënë ndesh me kapacitetet për të sjellë rritje, për të zbutur varfërinë dhe për të sjellë demokracinë efektive për popujt në vendet e varfra, sikurse Kosova. Në vend që ta hedhim poshtë atë, meqë ajo është hiperbolizuar nga studiues dhe praktikues, ne duhet të kërkojmë një kuptim të arsyeshëm të asaj çka mbrojtja e shtetit mund të ofrojë edhe atë që nuk mundet në realitet (Grindle, 2010). Shembull konkret është rasti i Ballkanit dhe fakti që ndonëse në një periudhë prej 20 vitesh e më shumë, Bashkimi Evropian është duke promovuar vlerat e krijimit të sovranitetit të një kombi, si parim kryesor për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit në BE, këto vende ende janë në hapat e parë të përmbushjes së këtyre normativave (Panbeanco, Rossi, 2010). Nga 8 shtete që përbëjnë

Ballkanin, vetëm një ka arritur të marrë statusin e anëtarit, ndërsa 3 të tjerë statusin e kandidatit, por edhe këto janë zhvillime të viteve të fundit. Por është pikërisht ky koncept i qeverisjes së mirë, kur përgjegjësia e mbrojtjes së saj nuk është më një faktor i brendshëm i shtetit, por në rast se nuk funksionon dhe arrin në caqe të dhunshme, siç ishte gjenocidi ndaj shqiptarëve të Kosovës, legjitimohet ndërhyrja e bashkësisë ndërkombëtare, që jep faktorin e dytë, që i dha medias shtysën për të ndryshuar pozicionin e saj. Këto nocione të zhvilluara më lartë, si dhe në vazhdim, janë cekur për faktin se të gjitha vijnë si pasojë e një dukurie shumë të përhapur aktualisht, që është korrupsioni i kontrolluar ose i pakontrolluar në të gjithë botën, që po sjell një humbje të besimit të qytetarit zgjedhës tek institucionet qeverisëse të shtetit. Si të tilla, kërkojnë ndërhyrjen e një pale të tretë, për të bërë interpretimin mes shtetit dhe qytetarit zgjedhës, që në rastin konkret është media. Kjo paraqet dhe ndikimin e medias që është gjithmonë e më shumë në rritje në shoqëri.

Natyrisht, në këtë vakum që krijohet kur humbet besimi te një njësi thelbësore, siç janë institucionet shtetërore, njerëzit janë të prirë të kërkojnë ikona të reja, e meqenëse media është një nga ikonat më të rëndësishme në jetën e individit, për më tepër është një ikonë që nuk mund të ekzistojë pa besimin e individit, atëherë mbivendosja e tyre është shumë e lehtë. Por kjo mbivendosje, ndonëse ndodh në nënndërgjegjen e individit, sjell dhe pasoja të tjera, si votën e individit ose pjesëmarrjen aktive të tij në atë çka ai quan një çështje të drejtë. Duke i gërshetuar të dy faktorët që u përmendën më lart, fillon dhe krijohet një tablo e re dhe e veçantë. Është si një mozaik që duhet ta rindërtosh nga ‘hiçi’, ku pjesët e veçanta të ndara nga njëra-tjetra nuk kanë kurrfarë kuptimi, por kur fillojnë dhe bëhen bashkë, atëherë gjithçka merr një kuptim tjetër dhe tabloja e fshehur në mozaik, fillon dhe shpaloset para nesh, sikurse do vërehet në vijim të këtij studimi.

Ideja e krijimit të sovranitetit të një kombi i detyrohet shumë ringjalljes intelektuale të shtetit si një "lojtar" pozitiv në zhvillimin ekonomik dhe politik. Shteti ka qenë prej kohësh në qendër të praktikës së zhvillimit (Krueger, 2001).

Qysh nga merkantilizmi i Evropës së shekullit XVI, shteti ishte një qendër e vendimeve të investimeve dhe politikave për të nxitur rritjen ekonomike. Në mënyrë të ngjashme, letërsitë akademike të viteve 1950-1970, kanë njohur rolin e rëndësishëm të shteteve në procesin e zhvillimit, ekonomistët kanë argumentuar se në vendet e varfra, shteti duhet të sigurojë investimet që do të nxisin zhvillimin ekonomik, ndërsa studiuesit politikë u pajtuan me idenë se centralizmi i shtetit ishte i rëndësishëm për ndërtimin e kombit dhe modernizimin politik (Krueger, 2001).

Pavarësisht kësaj historie të gjatë, dhe gjithashtu për shkak të saj, nga mesi i viteve 1970, akademikët ngritën një sërë pyetjesh rreth rolit të shtetit për të udhëhequr rritjen ekonomike, pasi edhe shtetet janë të sunduara nga shoqatat politike. Shqetësimet e tyre pasqyrojnë vetëdijen në rritje të potencialit që shtetet të dështojnë në përgjegjësitë e tyre zhvillimore (O'Donnell, Schmitter, Whitehead, 1986).

Në frontin akademik, Douglass North botoi veprën e tij, *Institucionet, ndryshimi institucional dhe i performancës ekonomike në vitin 1990*. Ky punim, së bashku me një interes në rritje mbi 'ekominë e re institucionale', e drejtuan vëmendjen për një kohë të gjatë në termin e "rregullave të lojës" dhe se si ato u japin formë zhvillimi trajektoreve të ndryshme ekonomike (Goldman, 2003). Disa studiues kanë pohuar se nuk është madhësia e shtetit që ka rëndësi, por më e rëndësishme është cilësia e tij që paraqet një funksion të institucioneve shtetërore dhe besueshmërisë së tyre (Kaufmann, 2003).

Tranzicioni i demokracisë në vitet 1980 dhe në fillim të viteve 1990, veçanërisht në Amerikën Latine dhe Evropën Lindore, nxiti shkencëtarët politikë t'i kushtojnë më shumë vëmendje infrastrukturës institucionale që karakterizon llojet e ndryshme të regjimeve

(Kaufmann, 2003). Gjithashtu, përpjekjet për të shpjeguar mungesën e zhvillimit në disa vende afrikane, së bashku me shqetësimin në rritje rreth qeverive autokratike dhe të dhunshme, e drejtuan vëmendjen te studimi i rolit të institucioneve në zhvillimin politik. Si rrjedhojë, nisur nga kjo analizë, natyrshëm rrjedh pyetja në vazhdim, nëse mbrojtja e shtetit, është dukuri vetëm e vendeve me sisteme demokratike, apo mund të realizohet edhe në kushtet e një forme diktatoriale?

Në vendet post diktatoriale të Evropës Lindore vihet re një mungesë e theksuar e lirisë së mendimit dhe shprehjes. Provë për këtë është aktivizimi i pakët i shoqërisë civile, por a mund të jetë kjo një pasojë e sistemeve të mëparshme, apo është një derivat i ri? Për të studiuar këtë fenomen le të marrim shembull një element që shpërfilllet gjithmonë e më shumë në analizat politike, e që është media. Theksohet kjo pjesë, pasi pikërisht kjo lloj situatë dhe këto ndasi, janë matësi më i mirë se si fillon dhe bëhet zëvendësimi nga një institucion shoqëror, në institucion të mediatikës.

2.6 Media, ndikimi në qeverisje

Dy fushat e qeverisjes që më së shumti janë të ndërlidhura me efektin e mediave, janë diplomacia dhe politika e jashtme. Natyrisht që politika e jashtme ka të bëjë me diplomacinë dhe siguron pjesën më të madhe të përmbajtjes, drejtimin dhe parametrat brenda të cilit funksionon diplomacia (Bahador, 2007).

Në gjithë këtë rrjedhë debatesh të vazhdueshme gjithmonë e më shumë është shpërfillur roli i mediave. Për mediat është kërkuar vetëm autonomi dhe liri veprimi, por ato nuk janë parë si institucione sociale të mirëfillta, të cilat kanë fuqinë të veprojnë edhe si vendimmarrëse (Fukuyama, 2010).

Duke u kthyer në media të pushtetshme, të cilat kanë aftësi të ndryshojnë institucionet dhe të krijojnë hapësirë edhe për shoqërinë civile, nënkuptohet që ato bëhen gjithnjë e më aktivisht të angazhuara në punët e brendshme të qeverisë. Nëse shikohen në spektrin e

përgjithshëm, vihet re se ato kanë bërë shumë më tepër se projektimi, monitorimi dhe këshillimi në çështje të caktuara politike (O'Donnell, Schmitter, Whitehead, 1986). Kjo do të thotë se kanë inkurajuar luftën kundër korrupsionit, duke inkurajuar zhvillimin e organizatave për të monitoruar veprimtarinë e qeverisë dhe aktiviteteve politike, duke shtuar peshën e zërit qytetar në vendimmarrjen politike, duke folur kundër dështimeve të lidershipit dhe aktivitete të tjera.

Media të tilla ndërkombëtare, të angazhuara në mënyrë efektive me shtetin dhe shoqërinë civile, në këto mënyra a mund të përjashtohen nga paranteza 'apolitike'? Dokumentet e tyre, publikimet, tregojnë se të gjithë janë angazhuar në një mënyrë të konsiderueshme në çështjet politike.

Vihet në vëmendje ky perceptim, pasi në shumicën e rasteve është e vështirë të provohet në mënyrë direkte se si media ndikon drejtpërdrejt tek qeverisja dhe funksionet e tjera të ushtrimit të kontrollit të përgjithshëm të legalizuar, për arsye të vetë natyrës së saj.

Natyra përçuese e informacionit që ka media, duhet të shërbejë vetëm si informim në kushte ideale, ndërsa pjesën tjetër, duhet ta ketë pjesa legjislative e shoqërisë (parlamenti i zgjedhur në mënyrë demokratike nga pjesëtarët e shoqërisë) dhe ndërgjegjja qytetare. Por, në kushtet aktuale të teknologjisë që ne jetojmë, ndodh një fenomen i kundërt. Teknologjia është ajo që i jep medias fuqinë vendimmarrëse, meqenëse mënyra e përçimit dhe besimi i krijuar tek media në shekuj, në një epokë ku problemi më i madh për shumë qeveri është korrupsioni, i jep një shtysë në këtë drejtim rritjes së influencës vendimmarrëse të medias. Mirëpo, meqë nuk ka një matës të drejtpërdrejtë në këtë aspekt, atëherë jemi të detyruar t'i referohemi atyre matësve që kemi.

Siç sugjerohet nga Hewitt de Alcántara, qeverisja ka të bëjë me institucionet politike dhe llogaridhënien, për ndërveprimet si korrupsioni dhe udhëheqësia, që u panë si pengesë për zhvillimin dhe përdorimin efektiv të ndihmës për zhvillim.

Denoncimi në rritjen e korrupsionit, ndikimi i bankave qendrore të pavarura në stabilitetin makroekonomik, të drejtat pronësore për të stimuluar rritjen, sa institucionet parlamentare janë më të favorshme për stabilitetin politik, krahasuar me ato presidenciale, janë të gjitha informacione që në vendet në zhvillim monitorohen nga mediat. Këto monitorime dhe denoncime ushtrojnë një marrëdhënie të rëndësishme mes krijimit të sovranitetit të një kombi dhe medias, e cila bën në mënyrë të vazhdueshme monitorime të tilla si ulja e varfërisë, efektiviteti i ndihmës sociale, burokracia efikase, si dhe investimet e huaja dhe private (Krueger, 1984). Natyrisht, që ky është një fenomen i vendeve ende në zhvillim, por kjo nuk do të thotë se edhe vendet e zhvilluara nuk e përjetojnë në përmasa më të vogla. Nëse shikohet në këtë aspekt, kur kanalet e tjera të komunikimit nuk janë më kaq të besueshme, media fillon dhe ushtron një influencë të re dhe sjell një rol të ri në shoqëri. Ajo kthehet nga përçuese, në manipuluese të drejtpërdrejtë të informacionit. Arsyeja kryesore është pikërisht se normat dhe besueshmëria e vjetër të pushtetit ka filluar të venitet dhe përgjithësisht shihet si mosbesuese, ndërkohë që në anën tjetër, media me rolin e saj ka filluar ta zëvendësojë këtë besueshmëri dhe të marrë kompetencat e këtyre pushteteve, qoftë edhe në mënyrë jo zyrtare.

Duke qenë se aktori kryesor i këtij monitorimi është media dhe duke pasur parasysh se me sa shpejtësi teknologjia kontrollon jetën tonë dhe mënyrën se si ritmi i shpejtë e lë median si aktor parësor të informimit (Fukuyama, 2010), a mund ta përjashtojmë atë nga aspekti ekzekutiv i këtij monitorimi?

Ndikimi i mediave në qeverisjen e mirë nuk është thjesht një rol pasiv monitorimi, por përgjithësisht mbrojtja e shtetit është një derivat i drejtpërdrejtë i mediave. Duke ushtruar ndikim nëpërmjet propagandave të ndryshme që ato zbatojnë në mediumet e veta, njëkohësisht ato ushtrojnë një ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e sovranitetit të një kombi dhe në mirëmenaxhimin e shtetit (Killick, 1989).

Zhvillimi i madh teknologjik u ka mundësuar atyre tashmë monitorimin edhe të vendeve që më parë kanë qenë jashtë hapësirës së tyre të vëzhgimit. Por, ashtu sikurse mund të ndikojnë në aspektin pozitiv, ato mund të ushtrojnë ndikim edhe në aspektin negativ. Shembull konkret është Kosova, që në pjesën e parë të viteve '90 ka pasur një perceptim të largët dhe negativ nga të njëjtat kanale, që pas kësaj periudhe, u bënë avokatët e saj. Prandaj, duke qenë se aktualisht mbrojtja e shtetit është një koncept që në përgjithësi ka dështuar në Evropën Lindore (Killick, 1989), lind pyetja se sa ka qenë ndikimi i mediave në këtë aspekt?

Analiza të ndryshme kanë treguar vazhdimisht se mbrojtja e shtetit, e monitoruar nga media, është një element thelbësor për zhvillimin, madje disa hulumtime e tregojnë atë si shkaktar të zhvillimit. Praktikisht, marrëdhënia mes demokracisë dhe krijimit të sovranitetit të një kombi është komplekse. Shumë vende të Evropës Lindore kanë institucionet demokratike, por ende shfaqin nivele të larta të korrupsionit, nivel të ulët të transparencës dhe dimensione tjera të keqqeverisjes (De Franco, 2012). Disa vende të Azisë Lindore, siç është rasti i Kinës dhe Tajvanit, kanë treguar se është e mundur që të ketë qeverisje relativisht të mirë me demokraci të kufizuar.

Në realitet, koncepti i krijimit të sovranitetit të një kombi sugjeron se skepticizmi është një mjet i mirë intelektual për të hedhur dritë mbi zhvillimin (De Franco, 2012). Është me interes të hulumtohen trendet e reja që po merr media në ndërveprimin me qeveritë, pasi ky institucion po merr gjithmonë e më shumë konturet e institucionit vendimmarrës, më shumë se sa të atij social apo vëzhgues.

Si rrjedhojë e parashtrimeve më lartë, është media ajo që në përgjithësi bën denoncimin ndaj korrupsionit në qeveri dhe vendos parametrat e qeverisjes së mirë, kështu që në një realitet të tillë, nuk është e vështirë të besohet se media është duke zëvendësuar institucionin shtetëror tek individi.

Nëse këtij ekuacioni i shtohet edhe faktori i tretë dhe i fundit që është globalizimi, i cili mundëson krijimin e një bashkësie me një interes të përgjithshëm të njerëzve kudo që ndodhen (shembull, stili i jetës së amerikanëve është shumë i ndryshëm nga stili i jetës shqiptare), atëherë bëhet e qartë se deri në çfarë përmasash është duke u zgjeruar media dhe ndikimi i saj. Si rrjedhojë, sa më e madhe të jetë audienca, aq më i madh është dhe fuqizimi i medias në ndikimin që ushtron. Mund të reflektojmë paksa i pazakontë ky lloj perceptimi, por faktikisht është globalizimi dhe jeta dinamike e njerëzve në çdo lloj kontinenti, apo marrëdhëniet dhe interesat e ngushta ekonomike që kanë me një vend ose një tjetër, që i jep aktorin e tretë të nevojshëm medias në transformimin e saj. A është ky transformim i medias pasojë e evoluimit të saj dhe shoqërisë njerëzore, apo diçka e induktuar nga vetë media? Kjo është një pyetje për një studim tjetër, por ajo çfarë shfaq interes për këtë kërkim, është se në bazë të kësaj që u theksua, media ka aftësinë dhe mjetet për të qenë vendimmarrëse, dhe është treguar si e tillë në rastin e Kosovës.

Është përfshirë kjo parashtesë e përgjithshme për të treguar se roli i medias është gjithmonë në zhvillim dhe në të shumtën e rasteve ky zhvillim është i ndërthurur ngushtë me teknologjinë. Si e tillë, media është në transformim të vazhdueshëm dhe kjo sjell pasoja në mënyrën se si funksionon media dhe trajtat që merr ajo në kuadër të shoqërisë si një e tërë. Të gjitha këto zhvillime dhe evoluime janë përmbledhur në pjesën teorike. Aktualisht, ka qenë studimi i komunikimit dhe mediave që ka çuar në formulimin e shumë teorive, siç janë Teoritë strukturore dhe funksionale, të cilat reflektohen në strukturat sociale e që janë reale dhe funksionojnë në forma që mund të vërehen në mënyrë objektive; Teoritë njohëse dhe të mënyrës së sjelljes, që priren të përqendrohen në psikologjinë e individëve; Teoritë e ndërveprimit, që e shohin jetën shoqërore si një proces të ndërveprimit; Teoritë interpretuese, që zbulojnë mënyra se si njerëzit të kuptojnë përvojën e tyre; dhe Teoritë kritike, që studiojnë konfliktin e interesave në shoqëri dhe mënyrën e komunikimit që përjetëson dominimin e një grupi mbi tjetrin.

Këto ishin teoritë më të hershme të parashtruara nga teoricienët perëndimorë Siebert, Paterson dhe Schramm, në librin e tyre 'Katër Teoritë e Shtypit' të vitit 1956 (Hartwell, 1972). Këto janë quajtur "teoritë normative" nga McQuail, në kuptimin që ato kryesisht kanë shprehur ide se si mediat duhet të jenë, ose si mund të pritët që të veprojnë në një rreth të përcaktuar të kushteve dhe vlerave. Secila nga katër teoritë klasike, bazohet në një teori të caktuar politike apo skenar ekonomik (Suresh, 2003).

2.7 Teoritë klasike dhe moderne

2.7.1 Teoria autoritare

Sipas kësaj teorie, media edhe pse jo nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Shtetit, duhej të ndiqte ofertat e tij. Sipas një shqyrtimi të teorisë autoritare mbi Evropën Perëndimore, liria e mendimit ishte kufizuar me xhelozë nga disa njerëz (klasat sunduese), të cilët ishin të shqetësuar për daljen e një klase të re të mesme, si dhe ishin të shqetësuar për efektet e shtypit të shkruar në procesin e mendimit të popullatës (Suresh, 2003). Janë ndërmarrë veprime për të kontrolluar lirinë e shprehjes, ndërsa rezultati ishte mbrojtja e diktaturës së plotë. Censura e shtypit përligjej me idenë se shteti ka përparësi mbi të drejtën e individit për sa i përket lirisë së shprehjes.

Kjo teori erdhi nga filozofia autoritare e Platonit (407-327), i cili mendonte se shteti ishte i sigurt vetëm në duart e disa njerëzve të mençur. Akademiku britanik, Thomas Hobbes (1588 - 1679), argumentoi se për të ruajtur rendin duhej që kundërshtimet ndaj sovranëve dhe individëve të shpërfilleshin. Mendimtari gjerman, Engels, më tej e përforcoi këtë teori, duke deklaruar se liria erdhi në sajë të autoriteteve të larta dhe është e drejtë vetëm nën autoritarizmin (Suresh, 2003).

Bota ka qenë dëshmitare e mjeteve autoritare të kontrollit mbi mediat nga të dy qeveritë diktatoriale dhe demokratike. Të gjitha vendet e Evropës perëndimore ndajnë të njëjtin sfond historik në këtë aspekt dhe si të tilla kanë ndjekur të njëjtat linja në evoluimin e tyre.

Censura e trashëguar nga sistemi diktatorial është ende e pranishme në praktikat e tyre të përditshme, por me ndryshimin se tani ka evoluar në autocensurë.

Theksohet ky vështtrim, sepse mënyra se si kjo autocensurë shfaqet, ndikon drejtpërdrejtë në mënyrën se si mediat në këto vende raportojnë informacionin që mbledhin. Në rast se gazetarët e quajnë të arsyeshme të mos raportojnë informacione, gjë që bien ndesh me etikën profesionale në përgjithësi, atëherë ata marrin vendimin që të mos transmetojnë, ndonëse këto informacione mund të jenë në interesin e publikut që të raportohen.

Ajo çfarë përpiqemi të theksohet është se në shumicën e këtyre vendeve, nuk është etika profesionale që bën vlerësimin e informacionit, apo interesi i shumicës, por perceptimi vetjak i gazetarëve.

2.7.2 Libertarianizmi ose teoria e shtypit të lirë

Kjo lëvizje është e bazuar në të drejtën e një individi dhe mbron idenë e heqjes së kufizimeve. Baza e kësaj teorie daton në shekullin XVII në Angli, kur shtypi krijoi mundësinë për të botuar disa kopje të një libri, apo pamfleti. Shteti mendohej si një burim kryesor i ndërhyrjes në të drejtat e individit dhe të pronës së tij. Libertarët e konsiderojnë kufizimin si vjedhje institucionale. Ndërsa, vullnetit të popullit (Vox populi) i japin përparësi mbi fuqinë e shtetit (Suresh, 2003).

Mbrojtësit e kësaj teorie ishin Lao Tzu, një filozof në fillim të shekullit XVI, John Locke, filozof nga Britania e Madhe në shekullin XVII, John Milton, poet epik (Aeropagitica) dhe eseisti John Stuart Mill (Suresh, 2003).

Më 1789, francezët në deklaratën e të Drejtave të Njeriut, shkruan ‘Çdo qytetar mund të flasë, shkruajë dhe botojë lirisht’. George Orwell e përcakton libertarianizmin si ‘lejimi i njerëzve të thonë gjëra që nuk doni të dëgjoni’. Libertarët argumentojnë se duhet parë shtypi si pushtet i katërt duke reflektuar opinionin publik. Çfarë ofron teoria në fjalë është pushtet pa përgjegjësi shoqërore (Suresh, 2003).

Kjo është një nga teoritë që përputhet me shpjegimin e rastit të Kosovës, kur gazetarët bënë raportimin në favor të asaj që ata e quajtën përgjegjësi sociale, që ishte mbrojtja e kombit të tyre dhe të gjitha trajtat e tjera të përgjegjësisë sociale i anashkaluan në favor të saj.

Informacioni për opinionin publik ndërkombëtar nuk filtrohej më nga mekanizmat antishqiptarë (burimet serbe), por ishin gazetarët shqiptarë vendorë që bënë filtrimin lidhur me raportimin e lajmit, që më pas shpërndahej në mediat ndërkombëtare.

2.7.3 Teoria - Përgjegjësia Sociale

Kritikët e Teorisë së Lirë ishin Wilbur Schramm, Siebert dhe Theodore Paterson të cilët mbështetën nevojën për zëvendësimin e saj nga teoria mbi përgjegjësinë shoqërore. Në librin e tyre *Katër teoritë e shtypit* (1956), ata deklaruan se ‘libertarianizmi i kulluar është i vjetërsuar’ (Suresh, 2003). Kjo teori mund të thuhet se ka lindur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga Komisioni i Lirisë së Shtypit më 1949. Komisioni konstatoi se qasja ndaj tregut të lirë dhe liria e shtypit ishin rritur vetëm në zotërimin e një klase të vetme dhe nuk u kanë shërbyer interesave të klasave më pak të ngritura. Më vonë, me shfaqjen e radios, televizionit dhe filmit, lindi nevoja për disa anë të llogaridhënies. Në këtë mënyrë, Teoria e Përgjegjësisë Sociale njohu disa detyrime të medias ndaj shoqërisë, ku detyra e një medie të lirë ishte që ndërgjegjja të ishte baza e të drejtës së shprehjes së lirë (Suresh, 2003).

Kjo teori është sjellë për të treguar se si përgjegjësia sociale ndaj kombit u bë përgjegjësi parësore për gazetarët, të cilët e fokusuan këtë perceptim në filtrimin e informacionit të nevojshëm, ashtu siç edhe mund të vërehet gjatë këtij studimi.

2.7.4 Teoria e plumbit magjik (stimulimi i përgjigjes)

Para Luftës së Parë Botërore, nuk kishte asnjë fushë të veçantë për studimin e komunikimit, por njohuritë rreth komunikimit masiv u grumbulluan në këtë periudhë (Suresh, 2003). Një rezultat i Luftës së Parë Botërore ishin përpjekjet propagandistike, apo siç njihet sot, Teoria e plumbit magjik apo e njohur si gjilpëra nën lëkurë. Kjo teori parashtroi mendimin se media

kishte një ndikim të fuqishëm në audiencën masive dhe mund të ndryshohet me qëllim sjellja e audiencës (Suresh, 2003).

Klapper (1960) formuloi disa konkluzione mbi efektet e mediave masive. Zbulimet e tij kërkimore janë se masmedia zakonisht nuk shërben si shkak i nevojshëm dhe i mjaftueshëm ndaj efektit të audiencës, por më tepër funksionon nëpërmjet lidhjes së faktorëve dhe ndikimeve që ndërmjetëson ajo (Suresh, 2003). Këta faktorë ndërmjetësues sjellin komunikimin masiv, si një agjent kontributiv në një proces të përforcuar nga kushtet ekzistuese. Faktorët kryesorë ndërmjetësues, të cilët ai i konsideron përgjegjës për funksionet dhe efektet e komunikimit masiv, janë ekspozimi selektiv, pra prirja e njerëzve që ta vënë veten në ato situata që janë në përputhje me qëndrimet dhe interesat vetjake; ndërsa si faktor tjetër paraqet perceptimin selektiv dhe mbajtjen, që nënkupton prirjen e njerëzve për ta organizuar kuptimin e mesazheve masive të komunikimit në përputhje me pikëpamjet e tyre ekzistuese.

Kjo është një nga teoritë që ndikon në analizimin e situatës në Kosovë. Ajo çfarë konsiderohet për t'u theksuar në këtë rast, është se vetë nxitja erdhi nga brenda medias, dhe fillimisht nuk mund të konsiderohet si e planifikuar. Ajo çfarë ndodhi, është se me rritjen e ndërgjegjësimit tek gazetarët e rinj të Kosovës, që shoqëronin dhe udhëzonin gazetarët ndërkombëtarë, fillon dhe mënyra e ndërgjegjshme e raportimit për të pasqyruar realitetin që jetohej në Kosovë.

2.7.5 Teoria e përdorimit nga kënaqësia

Kjo teori u parashtrua në vitin 1970 nga Katz, i cili ishte i shqetësuar lidhur me atë se si e përdorin njerëzit median për plotësimin e nevojave të tyre. Sipas tij, individët zgjedhin atë çka ata duan të shohin ose të lexojnë dhe media të ndryshme konkurrojnë për përmbushjen e nevojave individuale, pavarësisht natyrës së këtyre nevojave (Suresh, 2003). Në hierarkinë e nevojave, ai përcakton pesë nivele në formën e një piramide me nevojat

themelore, të tilla si ushqim dhe veshmbathje që janë nevojat bazike, e duke vazhduar deri te rendi më i lartë në majë të piramidës. Përmbushja e çdo nevoje të nivelit më të ulët e çon individin në kërkim për të kënaqur nivelin e ardhshëm të nevojës e kështu me radhë, derisa ai arrin nevojën superiore: aktualizimin e dëshirave të tij (Suresh, 2003).

Përdorimi nga kënaqësia na kujton se njerëzit e përdorin median për shumë qëllime. Si përdorues, media bëhet gjithnjë me zgjedhje dhe kjo qasje duhet të drejtojë vëmendjen tonë lidhur me audiencën.

Në përgjithësi, disa studiues kanë pikasur katër lloje të kënaqësive (Smith, 1990). E para është informacioni, ku shfaqet interes për shoqërinë dhe botën. Kjo bëhet përmes lajmeve dhe dokumentarëve të cilët japin një pikëpamje rreth botës. E dyta është identiteti personal që nënkupton se mund të shikojmë televizion në mënyrë që të identifikojmë modele për sjelljen. Çështja e tretë është integrimi dhe bashkëveprimi social, që nënkupton se ne përdorim median për të mësuar më shumë rreth rrethanave të njerëzve të tjerë (Suresh, 2003). Ndërsa, çështja e fundit është argëtimi, që nënkupton se nganjëherë media përdoret thjeshtë për kënaqësi, qetësim ose vetëm për të kaluar kohën. Kështu, studimi vërtetoi se njerëz të ndryshëm i përdorin të njëjtat mesazhe nga mediat për qëllime të ndryshme. Katz zëvendësoi pyetjen ‘çfarë bëjnë mediat për njerëzit?’ me pyetjen ‘çfarë bëjnë njerëzit me mediat?’ (Suresh, 2003).

2.7.6 Zhurma

Në të gjitha komunikimet, ka një dërgues, një mesazh apo një komunikim dhe një marrës (Suresh, 2003). Kuptimi i një mesazhi përgjithësisht varet nga kultura mbizotëruese. Dërguesi kodon një mesazh, marrësi e dekodon atë. Ndërmjet dërguesit të mesazhit dhe marrësit, zhurma zë një vend dhe e ndërlikon procesin. Një komunikim i qetë nuk ekziston dhe la shumë lloje zhurmash që hyjnë në komunikim. Keqkuptimi i një mesazhi të veçantë, apo shtrembërimi i kuptimit, është një formë e zhurmës (Suresh, 2003).

Një nga rastet më të pastra të mënyrës se si ndikon ky lloj procesi është Sovraniteti i Kosovës. Nuk mund të thuhet se në arenën ndërkombëtare Kosova nuk njihet, apo gjenocidi që po ndodhte në këtë vend nuk dihet, pasi ka pasur rrjedhje të ndryshme informacioni edhe gjatë periudhave të mëparshme, para viteve '90. Atëherë shtrohet pyetja, kush ishte faktori që çoi në zgjimin e interesit mbarëbotëror, që solli edhe krijimin e shtetit të ri, siç ishte Kosova? Gjithashtu, identiteti dhe sovraniteti i Kosovës, a ishin një produkt i vetë popullsisë, vendasve, apo u ngjiz nga media dhe erdhi deri në krijimin e këtij shtetit të ri? Si u njësuan teoritë e ndryshme mediatike në propagandën dhe luftën e popullit të Kosovës dhe a ishte kjo një produkt i vetë popullatës, apo një fabrikim i mediave?

Pas shtjellimit të teorive të komunikimit, në vijim parashtrohet përdoruesi kryesor i këtyre komunikimeve, që është vetë media. Ashtu si çdo aspekt tjetër i jetës sonë, që është prekur nga teknologjia, edhe media ka evoluar dhe evoluimi i saj ka arritur deri në atë pikë sa që tani nuk mund të flasim më për një mjet të thjeshtë komunikimi, por për një 'institucion social', që përmbush role të cilat më përpara kanë qenë pjesë e shoqërisë dhe institucioneve fetare. Për të analizuar rolin se si media ndikoi në sovranitetin e Kosovës, është e nevojshme të shqyrtojmë konturet dhe normativat e reja, se çfarë roli përmbush ajo dhe si sillet në shoqërinë masmediatike. Cilat janë funksionet ku ndikon dhe e ka më shumë pushtet se ç'mendohet?

KAPITULLI III: KONTEKSTI HISTORIK

3.1 Një histori e shkurtër

Mediat kanë shërbyer gjatë si një instrument i rëndësishëm në përpjekjet e qeverisë për të kontrolluar shoqërinë në përputhje me politikën komuniste (Besley, Burgess, 2002).

Një nga aktet e para të komunistëve, kur erdhën në pushtet në vitin 1944, ishte marrja nën kontroll e mediave, edhe pse përdorimi i medias në mënyrë formale për të induktuar ndjenjat komuniste dhe nacionaliste në popullsi, nuk ka ndodhur deri në vitin 1946. Pas kësaj, shtypi, radioja, televizioni, edhe më vonë u përdorën për të justifikuar sundimin komunist dhe për të rrënjësuar vlerat marksiste në popullsi. Shtypi, radioja dhe televizioni janë përdorur edhe për të mobilizuar popullatën për të mbështetur dhe për të marrë pjesë në zbatimin e programeve të regjimit, të tilla si planet ekonomike, politikat antifetare, apo fushata për promovimin e leximit (Cohen, 2000). Një mënyrë për të apeluar ndjenjat e masave, ishte mesazhi i medias që kishte një përmbajtje nacionaliste, duke ngjallur ndjenjat e besnikërisë dhe krenarisë lidhur me pavarësinë. Mediat gjithashtu shërbyen për të mbajtur partinë dhe zyrtarët qeveritarë në kontroll, nëpërmjet ekspozimit të korrupsionit dhe joefikasitetit. Mediat kanë qenë të kontrolluara nga afër nga pala në pushtet, nëpërmjet ushtrimit të censurës së fuqishme deri në vitin 1990, kur udhëheqja filloi të moderojë politikën dhe gradualisht të lejojë shprehjen e pikëpamjeve që binin ndesh me vijën zyrtare (Cohen, 2000).

Para vitit 1990, të gjithë individët të cilët punonin në masmedia, pavarësisht nëse ishin redaktorë, regjisorë, punonjës të televizionit dhe producentë të radios, ishin subjekt i disiplinës së rreptë të partisë dhe udhëzimeve të ngurta (Cohen, 2000).

Në këtë panoramë historike të medias post komuniste do duhej të theksohej se ish regjimi komunist e shfrytëzoi impaktin dhe rolin e komunikimit, qoftë për të përmbushur objektivat për zhvillim, qoftë për të mbajtur nën kontroll shoqërinë, duke treguar në këtë

mënyrë një shembull të qartë se sa ndikim ka komunikimi në zhvillimin e një shoqërie (Bergman, 2004). Në këtë periudhë flasim për një komunikim të limituar në aspektin e teknologjisë, pasi format e mëtejshme të evoluimit të komunikimit, të cilat janë aktive sot, kanë një ndikim edhe më të madh në atë se si ne shohim botën sot dhe se si zbatohen programet e reja zhvillimore nga partitë në pushtet, apo ato opozitare. Duke pasur një sfond të tillë nga ana historike, pronarët e mediave dhe organet e shtypit partiak, duhet të jenë të vetëdijshëm lidhur me atë çfarë ata kanë dorë, por në shumicën e rasteve komunikimi mediatik është i kufizuar në denoncim social dhe në shumicën e rasteve ky lloj denoncimi nuk vjen në formën e fakteve apo dokumenteve, por nga citime të burimeve të paidentifikuara në institucionet e shtetit.

3.2. Historia e ngjarjeve të Kosovës e paraqitur sipas BBC, CNN dhe REUTERS

Sipas BBC, Kosova u bë lajm ndërkombëtar në fund të viteve '90, kur forcat serbe nën udhëheqjen e presidentit të atëhershëm jugosllav Slobodan Millosheviq, bënë përpjekje për të shtypur fushatën pavarësisë së shumicës etnike shqiptare. Serbët e konsiderojnë Kosovën si djepi i kulturës së tyre, fesë dhe identitetit kombëtar.⁹

Kushtetuta Jugosllave e vitit 1974 e përcaktoi statusin e Kosovës si një krahinë autonome e Serbisë. Por presioni për pavarësi nga pala shqiptare filloi të rritej në vitin 1980, pas vdekjes së presidentit jugosllav Josip Broz Tito (BBC, 2006).

Në pjesën e dytë të dekadës, kur Millosheviqi ishte numri dy në Partinë Komuniste Serbe, i motivuar nga oportunizmi politik, u bë një kampion i nacionalizmit serb. Në vitin 1989, ai filloi të heqë të drejtat e autonomisë së Kosovës (BBC, 2006).

Lufta e Kosovës filloi më 28 shkurt të vitit 1998, pas sulmit jugosllav në fshatrat Likoshan dhe Qirez në Drenicë të Kosovës. Nga kjo datë deri më 23 mars 1999, lufta u zhvillua

⁹ Faqja elektronike zyrtare e BBC: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/5165042.stm>, parë në dhjetor 2014.

ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave jugosllave (BBC, 2010). Kjo është mënyra se si BBC i referohet fillimit dhe zhvillimit të luftës në Kosovë.

Nga data 24 mars 1999 e deri më 10 qershor 1999, Aleanca Veriatlantike NATO me bombardime të përditshme në bazat ushtarake jugosllave, me përkrahjen tokësore të UÇK-së, i detyroi forcat serbe dhe liderin Slobodan Millosheviq të nënshkruajë kapitullimin në Kumanovë. Gjatë kësaj lufte u dëbuan afro 800 mijë shqiptarë, u vranë rreth 15,000 persona, nga të cilët 2,400 luftëtarë të UÇK-së, ndërsa të tjerët civilë. Gjatë luftës janë zhdukur rreth 5,000 njerëz, fati i një pjese të tyre është zbardhur deri në vitin 2007, por i madh ka mbetur numri i rasteve të pasqaruara (BBC, 2010).

Në një analizë të bërë për CNN, korrespondenti David Ensor e fillon me frazën se "fitorja ka njëqind etër"¹⁰ duke paraqitur në vijim humbësit dhe fituesit e konfliktit të Kosovës. Duke iu referuar deklaratave të diplomatëve dhe personaliteteve ndërkombëtare, ndër fituesit e parë ai radhit presidentin amerikan të asaj kohe Bill Clinton dhe ish kryeministrin britanik Tony Blair, ndërsa humbësin e parë konsideron ish presidentin jugosllav, Slobodan Millosheviq dhe komunitetin serb me aspiratat e tyre. Ndërsa, palën shqiptare e konsideron si humbëse në aspektin human, meqë mijëra shqiptarë u vranë gjatë luftës (CNN, 1999).

Nga analiza ndërmjet fituesve dhe humbësve, CNN thekson se Ushtria Çlirimtare e Kosovës, një grup gueril etnik shqiptar, mund të jetë një fitues që nuk ka fituar qëllimin e saj të pavarësisë së Kosovës, por tregoi se mund të bëjë një ndryshim në luftën në terren.¹¹ Pra, ky medium, menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë, nuk i referohet UÇK-së me cilësimin si grup terrorist.

Shqiptarët kanë kërkuar zyrtarisht pavarësinë qysh nga zgjedhjet në vitin 1992, nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, president i Republikës së vetëshpallur. Kërkesa u shpërfill

¹⁰ Faqja elektronike zyrtare e CNN, <http://edition.cnn.com/WORLD/europe/9906/10/kosovo.outcome/>, parë më dhjetor 2014.

¹¹ Faqja elektronike zyrtare e CNN, <http://edition.cnn.com/WORLD/europe/9906/10/kosovo.outcome/>, parë më dhjetor 2014.

nga pushteti serb, meqë në fokus kishin luftën për disa pjesë në Kroaci dhe në Bosnjë (REUTERS, 2007).

Si rrjedhojë, mbështetja u zhvendos në luftë të armatosur nga ana e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, një forcë guerile e gatshme për të luftuar për pavarësi. Forcat serbe goditën përsëri aq shumë në vitin 1998, saqë 100 mijë shqiptarë u dëbuan nëpër male, ndërsa fuqitë e NATO-s paralajmëruan Millosheviqin se nuk do ta toleronin më shumë spastrimin etnik ballkanik. Bisedimet e paqes në Francë dështuan dhe në mars të vitit 1999, NATO filloi bombardimin ajror që e detyroi Serbinë të tërhiqet. Rreth 800 mijë shqiptarë u dëbuan për në Maqedoni dhe Shqipëri, para se Millosheviqi të tërhiqte forcat e armatosura. Ndërsa deri në 200 mijë serbë dhe pakica të tjera etnike u larguan nga Kosova.¹²

Krimi gjatë luftës, i paraqitur sipas raportimit të tri medimeve në studim

Gjatë viteve të luftës në Kosovë '98-'99, vlerësohet se forcat ushtarake dhe paraushtarake serbe kanë vrarë, ekzekutuar apo masakruar në forma më mizore rreth 15 mijë shqiptarë, ku 90% prej tyre ishin civilë të pa armatosur. Në po këtë periudhë kohore, janë përdhunuar rreth 20 mijë femra shqiptare, ndërsa mësohet për rrëmbimin e mbi 3 mijë shqiptarëve, ku pas luftës një pjesë e tyre u gjetën nëpër varrezat masive në Serbi, ndërsa akoma nuk dihet për fatin e 2087 të tjerëve.¹³

Gjatë periudhës kohore mars 1998 deri në qershor 1999, njësitë kriminale dhe artileria e rëndë serbe kanë shkatërruar dhe djegur pjesërisht ose tërësisht rreth 1.100 vendbanime shqiptare, kanë plaçkitur, djegur e shkatërruar mbi 200.000 shtëpi, banesa, lokale afariste, punëtori zejtare, fabrika, shkolla, biblioteka, monumente kulturore-historike, objekte kulturore, shkencore, fetare etj.¹⁴

¹² Faqja elektronike zyrtare e Reuters: <http://uk.Reuters.com/article/2007/09/28/uk-serbia-kosovo-province-idUKL2890315020070928>, parë më dhjetor 2014.

¹³ Faqja elektronike e Radio Evropa e Lirë: <http://www.radiokosovaelire.com/?nav=40,2&id=28771>, parë në dhjetor 2014.

¹⁴ Faqja elektronike e Radio Evropa e Lirë: <http://www.radiokosovaelire.com/?nav=40,2&id=28771>, parë në dhjetor 2014.

Kjo parashtrësë theksohet për të saktësuar situatën historike për të cilën flasim. Të dhënat janë marrë nga faqja zyrtare e NATO-s, nga faqet zyrtare të BBC, CNN, REUTERS dhe nga Radio Evropa e Lirë. Arsyeja e parashtrimin të këtyre të dhëna është se këta faktorë dhe gjenocidi që përshkruhen më lartë dhe në pjesën analitike, nuk kanë ndodhur vetëm si pasojë e luftës, por janë të evidentuara historikisht. Realiteti për gjenocid të kryer ndaj popullsisë civile, kryesisht ndaj komunitetit etnik shqiptar të Kosovës, është i hershëm dhe është publikuar në arenën ndërkombëtare qysh në vitet 1909-1920, kur Edit Durham filloi një linjë të publikimeve ku denonconte dhunën që serbët po ushtronin ndaj shqiptarëve dhe fqinjëve të tjerë ballkanikë, pavarësisht se si shikohej ajo nga autorët e tjerë. Duke referuar parametrave të komunikimit, mund të themi se ekzistonte një denoncim për situatën në Kosovë që në vitin 1920. Nëse kjo nuk ishte e mjaftueshme, 30 vite më vonë, kemi denoncimin që vjen nga vetë zona e Serbisë nga editorit dhe gazetari serb, Dimitrije Tucoviq, i cili besonte se urrejtja ndaj Serbisë nga ana e popullit shqiptar u shkaktua nga kolonializmi serb, i cili kishte viktimizuar Kosovën dhe pjesën dërmuese të popullatës shqiptare (Tucoviq, 1950). Tucoviq tha se përpjekja e Serbisë për të aneksuar territorin e populluar nga shqiptarët, në luftërat e Ballkanit, e bënë popullin shqiptar të ndjejnë urrejtjen për çdo gjë serbe. Ai arriti në përfundimin se Serbia duke kërkuar qasje në det, tentoi kolonizimin e Kosovës, por u largua pa e marrë qasjen në det dhe Kosovën e ka krijuar si një armik të gjakut (Tucoviq, 1950).

Parashtrëhet ky sfond historik për të thënë se situata në Kosovë njihet, qoftë edhe përciptazi, në arenën ndërkombëtare dhe se akuzat për gjenocid ndaj popullatës civile nuk ishin të parat që hidheshin në fillim të viteve '90. Duke pasur parasysh situatën, atëherë lind pyetja pse pikërisht në vitin 1999, bota pranoi publikisht se po bëhej gjenocid ndaj një popullate civile dhe bëri ndërhyrjen e saj në përkrahje popullit dhe të UÇK-së, që ishte krah i popullatës civile?

KAPITULLI IV: ANALIZA EMPIRIKE

Analizat e këtij seksioni mbështeten në të dhëna sasiore dhe cilësore, të ndara sa i përket numrit të artikujve për Kosovën, tematikës më të shpeshtë në të cilën kanë referuar raportimin dhe cilësimet e përdorura më së shumti për të përshkruar ngjarjet në vend, brenda periudhës në studim. Fillimisht është bërë dokumentimi numerik i mbulimit të ngjarjeve të Kosovës nga tri mediat në studim, i ndarë në tematika kryesore, në të cilat janë orientuar raportimet për Kosovën. Tematika është përzgjedhur sipas mundësisë që të jep hyrja (log in) në arkivin qendror të këtyre mediave. Ndërsa, përmbajtja dhe formulimet gjuhësore për të përshkruar Kosovën, popullin e saj dhe ngjarjet në vazhdimësi, janë përzgjedhur duke analizuar titujt, tekstin e plotë, cilësimet më shumë të përdorura, burimet e informacionit, fotografitë dhe fotolajmet. Këto të dhëna janë paraqitur në tabela të veçanta në vijim të këtij kapitulli, që njëherazi paraqet edhe ndryshimet në stilin e raportimit të tyre në periudha të ndryshme kohore.

Të dhënat e gjeneruara nga kërkimi në arkivat e tre mediave në studim, janë realizuar duke kërkuar me fjalë-kalimin (fillimisht të përgjithshëm) “Balkans”, dhe pastaj ‘Kosovo’, ku dalin të gjithë artikujt ku përmendet Kosova. Pastaj, kërkimi është ngushtuar duke mos marrë për bazë vetëm përmendjen e Kosovës në kontekst të përgjithshëm, por duke bërë ndarjen në bazë të viteve, duke klasifikuar fjalë-kalimin “Kosovo 1990-1998”. Kjo periudhë është kërkuar si e përbashkët qëllimisht, për të dhënë një sfond historik para periudhës së përfshirë në studim dhe me qëllim krahasimin e ndryshimeve të trajtimit mediatik që është evidentuar më vonë.

Fillimisht, janë lexuar me kujdes mbi 100 artikuj për secilin medium, duke u fokusuar në përmbajtjen e tyre, burimet e informacionit dhe tematikat dominante në të cilat është raportuar Kosova, për të përzgjedhur pastaj artikuj dhe tematika për analizë dhe

interpretim. Arsyeja pse është përzgjedhur tematika ka të bëjë me krahasimin e ndryshimeve ndër vite dhe arsyeve pse erdhi te ky ndryshim. Nga të dhënat sasiore vihet re se artikujt për Kosovën ishin kryesisht me përmbajtje politike.

Duhet theksuar se në këtë periudhë, nuk është marr në shqyrtim gjatësia e artikujve dhe as kriteri i rëndësisë së lajmit në secilën nga këto media, për faktin se ato figurojnë te rubrika e Evropës (Ballkani) dhe interesi shfaqej në analizimin e mbulimit frekuent të Kosovës, me numrin e përgjithshëm të artikujve, fjalët kyçe me të cilat është cilësuar, aspekti përmbajtësor i artikujve, burimet e informacionit në të cilat është bazuar (zyrtare dhe jo zyrtare) dhe tematikat më dominante.

Për periudhën 1990-1998, rezultatet e kërimit shfaqin një numër më të madh të raportimeve nga Reuters krahasuar me dy mediat tjera, nga të cilat 437 artikuj kanë përmbajtje mbi zhvillime politike në vend, ndërsa më pak artikuj kishte me përmbajtje mbi tema sociale, apo kur flitej për keqtrajtim të shqiptarëve. Kriteri i përcaktimit ‘politik’ në këtë rast është menduar kur artikujt i referoheshin zhvillimeve politike, tematikë kjo që do të dominojë deri në periudhën e krizës. Artikujt e kësaj periudhe raportonin mbi zhvillime të ndryshme, përleshjet midis trupave të armatosura serbe (të ish Jugosllavisë) dhe të demonstruesve të paarmatosur etnikë shqiptarë, me ç’rast u raportuan të vdekur 26 persona dhe 94 civilë të plagosur (janar 1990). Po në këtë periudhë u raportua për mbi 400 nxënës dhe fëmijë të trajtuar për simptomat e shfaqura që karakterizojnë helmim. Kjo u trajtua si një komplot serb për zhdukjen shqiptarëve etnikë, me qëllim që të përmbushin qëllimet dhe dëshirat nacionaliste. Ndërsa, zyrtarët serbë e quajtën këtë ngjarje një ‘histeri masive’ dhe propagandë e kryer nga ‘separatistët’ (referuar sipas deklaratave) shqiptarë.

Natyra politike e interesimit për Kosovën nga këto media vihet re edhe me lidhjen e zhvillimeve me ish Presidentin serb, Slobodan Milloseviq, duke iu referuar vendimeve të tij që nxisnin konflikte ndëretnike dhe ndërmjet civilëve shqiptarë etnikë dhe trupave

policore serbe. Ndër rastet e referuara është kur Millosheviq deklaroi se Sekretariati për Punë të Brendshme të Serbisë kishte marrë përsipër detyrat e sigurisë së trupave federale në Kosovë, duke përforcuar ndikimin serb në ish-provincën autonome (referuar Kosovës, të quajtur atë kohë nga Presidenti serb) me masa të veçanta dhe me pushtet të drejtpërdrejtë. U raportua edhe për numrin e serbëve të migruar në këtë periudhë. Kjo periudhë i referohej zhvillimeve politike që ndërlidheshin me tensionimin e situatës në Kosovë. Lidhur me këtë, u raportua se si rrjedhojë e sulmeve ndaj serbëve në Kosovë, Kuvendi i Serbisë u motivua për të deklaruar një situatë të rrethanave të veçanta dhe përkohësisht të shpërndajë Kuvendin e Kosovës në fund të qershorit të vitit 1990. U raportua edhe për heqjen e autonomisë ndaj dy krahinave (sikurse referohej).

Në përgjithësi raportimet e viteve '90 ndërlidheshin me luftërat në Ballkan, duke cilësuar se rrënjët e problemeve në Ballkan janë si rrjedhojë e përleshjeve ndëretnike.

Në vazhdim, paraqesim një sfond historik të përgjithshëm për të tri mediat, artikujt e të cilave janë analizuar për raportimet që kanë bërë për Kosovën. Këto të dhëna paraqiten për të ndërtuar një pasqyrë mbi lashtësinë e tyre, shtrirjen globale, audiencën dhe ndikimin që kanë në politikat ndërkombëtare, falë etikës së lartë dhe besueshmërisë së tyre të dëshmuar ndër vite. Të dhënat mbi historikun e tyre janë marrë nga faqet elektronike zyrtare të tyre, që paraqiten më hollësisht tek pjesa e referencave.

4.1 British Broadcasting Company (Kompania Britanike e Trasmetimeve) – BBC

British Broadcasting Company (Kompania Britanike e Trasmetimeve) - BBC, filloi punën në vitin 1922, kur qeveria licençoi gjashtë prodhuesit më të mëdhenj të radios në Mbretërinë e Bashkuar, për të formuar korporatën e re. Ajo fillimisht kishte një staf të përbërë nga katër persona. Paguhej nga të gjithë ata që mbajnë një marrës (radio rele apo radio të asaj kohe) dhe do të plotësohej nga honorarët në shitjet e radios. Transmetimi i parë u bë më 14 nëntor nga Londra dhe dëgjimi shpejt u popullarizua si mënyrë e kalimit të kohës.

John Reith ishte drejtor i parë i përgjithshëm i BBC-së. Në vitin 1936, Lord Reith drejtoi zhvillimin e shërbimit të parë të rregullt televiziv në botë. Koncepti i tij i transmetimit të shërbimit publik mbizotëroi në Britaninë e Madhe dhe ndikoi në zgjerimin e transmetimit në shumë vende të tjera.

Shërbimi televiziv britanik u ndërpre gjatë Luftës së Dytë Botërore, por rifilloi punën në vitin 1946. BBC krijoi kanalin e saj të dytë në vitin 1964, ndërsa në vitin 1967 ofroi shërbimin e parë të rregullt televiziv me ngjyra në Evropë.

Dëgjimi i radios u përhap gjerësisht gjatë vitit 1930, ku njerëzit mblidheshin së bashku për të dëgjuar ngjarjet kombëtare dhe sportive. BBC gjithashtu u bë një mbrojtëse e madhe i arteve, komisioneve të muzikës dhe dramës.

Në vitin 1932, ajo i kishte zyrat në Shtëpinë e Transmetimit në Londër, zona ku vendosen të gjitha mediat që transmetojnë në Londër.

Shërbimi i BBC si televizion, filloi më 2 nëntor 1936, por u pezullua me shpërthimin e luftës në vitin 1939. Kjo kohë e luftës solli sfida të mëdha për BBC-në, dhe ndërsa merrej me Ministrinë e Informacionit të qeverisë nga njëra anë, ishte një objektiv i preferuar për bombardimet gjermane nga ana tjetër.

Në tetor të vitit 1940, ndërsa lexuesi i lajmeve, Bruce Belfrage, gjatë buletinit të tij të orës 9 ishte në transmetim, një bombë goditi këtë shtëpi transmetimi. Ai ndaloi një sekondë pasi dëgjoi bombat që pëlcisnin jashtë, por vazhdoi sikur çdo gjë të ishte normale, pasi për arsye sigurie, atij nuk i lejohej të reagoje gjatë transmetimit. Atë ditë u vranë shtatë persona.

Programet e argëtimit dhe dramat, ishin ato që mbajtën lart moralin gjatë luftës, veçanërisht seriali sikurse “It’s that man again”, me komedianin Tommy Handley.

Nga viti 1946, filloi transmetimi i programit të tretë me muzikë, dramë dhe arte. Shërbimi Perandorak vazhdoi si Shërbim i Jashtëm, duke marrë grante në formë të ndihmës nga qeveria, një situatë kjo e cila vazhdon edhe sot me shërbimin ndërkombëtar.

Televizioni bëri përparim të vazhdueshëm nga baza e tij në Alexandra Palace në veri të Londrës, duke arritur që transmetimin për 30 orë çdo javë nga viti 1950, ta çojë në 50 orë në vitin 1955.

Në vitin 1955, BBC e rriti konkurrencën në formën e ITV. Shumë nga stafi i BBC u largua për t'u bashkuar me kompanitë e reja ITV, por besimi u rrit me fillimin e shumë programeve që janë ende të njohura edhe sot, sikurse 'Tribunë', 'Qielli natën' dhe 'Kjo është jeta juaj'.

Në vitin 1964 nisi transmetimet BBC 2. Nga fundi i viteve 1990, BBC investoi në shërbime të reja interneti, sikurse në lajme të drejtpërdrejta, ndërsa po përgatitej njëkohësisht për lançimin e televizionit digjital duke futur kanale të reja. BBC u zgjerua me kanale të reja të radios dhe televizionit duke ofruar shërbim transmetimi në vende të ndryshme të botës.

Duke pasur parasysh se të dy këto media janë televizione që dhe sot e kësaj dite ushtrojnë ndikimin e tyre në Britani, por BBC është e vetmja që e ushtron edhe jashtë Britanisë, një parantezë krahasuese mes tyre mendoj se jep një tablo më të qartë se si u zhvillua dhe u fuqizua BBC.

Siç mund të vihet re, BBC është duke fituar gjithmonë e më shumë popullaritet duke siguruar një audiencë gjithmonë e më të madhe, pavarësisht konkurrencës. Në të njëjtën kohë, ajo shërben dhe si një shkollë, siç mund të nënkuptohet nga fakti se një pjesë e mirë e stafit transferohet tek ITV-të e tjera.

Ndërkohë, në vitin 1973 u rrit konkurrenca në formën e radiove komerciale, e ndjekur nga televizioni Channel 4, në vitin 1982. Sidoqoftë, përfshirja e një audience më të gjerë, siç ishin personat me aftësi të kufizuara, vazhdoi të konsolidojë gjithmonë e më shumë rolin e BBC-së dhe impaktin e saj tek audienca.

Gjatë Luftës së ishujve Falklands, gazetari Brian Hanrahan iu drejtua audiencës: "Unë kam numëruar të gjithë ata që janë jashtë dhe të gjithë ata që janë në prapavijë", ndërsa shikonte avionët Havierre të cilët po ktheheshin në bazën e tyre pas një bastisjeje. Por qeveria e

Margaret Thatcher u ankua me mënyrën e raportimit të BBC, duke i cilësuar ato se ishin të njëanshëm në drejtim të pikës së parë të Argjentinës.

Përplasjet e mëtejshme me politikanë u zhvilluan gjatë viteve 1980. Është pikërisht kjo periudhë që fillon dhe konsolidon ndikimin e BBC në politikat e jashtme dhe të brendshme të vendit, duke u bërë një nga oponentët më me ndikim të qeverisë. Ky ndikim u fuqizua akoma më shumë me raportet e korrespondentit Michael nga Etiopia, fushatë e cila frymëzoi përpjekjet Band Aid dhe ndihmën e mbledhjes së fondeve drejtpërdrejtë.

Viti 1990 solli ndryshime të mëtejshme, kur drejtori i ri i përgjithshëm John Birt, riorganizoi shumë nga punët e brendshme të BBC-së mes polemikave të jashtëzakonshme.

BBC u zgjerua me kanale të reja, me shërbim të radios botërore, duke u plotësuar me një shërbim televiziv ‘BBC World’, ndërsa kanali satelitor ‘UK Gold’ e ndihmoi atë duke shfrytëzuar arkivat e saj të vlefshme. Anita Dobson dhe Leslie Grantham me programin e tyre ‘EastEnders’ pushtuan ekranet në vitin 1985, duke u bërë një nga programet më me ndikim dhe hodhi bazat e para për mbledhjen e fondeve në transmetim të drejtpërdrejtë. Në fund të viteve 1990, BBC investoi në shërbime të reja të internetit, sikurse ‘BBC News Online’, dhe u përgatit për nisjen e televizionit digjital duke ofruar kanale të reja. Tani nën drejtimin e Greg Dyke, BBC filloi të ofrojë shërbimet televizive për fëmijë ‘CBeebies’ dhe ‘CBBC’, një rrjet kulturor, BBC Katër, si dhe një koleksion të shërbimeve radio digjitale.

Në të vërtetë, emërimi i z. Dyke u konfirmua nga kryetari i BBC, Christopher Bland, në një forum të drejtpërdrejtë diskutimi të BBC, duke treguar tani se sa të gjerë e konsideron komunitetin e vet ky medium. Ky është dhe një nga tiparet që e karakterizon më së shumti këtë medium, transmetimi i informacionit si dhe marrja e reagimit kryesisht nga rrjeti, gjithashtu duke i dhënë asaj një fuqi të madhe në ndërlidhjen dhe komunikimin e informacionit qoftë nga burime të para, ashtu edhe nga ato dytësore. Marrja e komenteve drejtpërdrejtë nga lexuesit

dhe përfshirja e tyre në edicione informative apo dokumentare, i jep asaj një besueshmëri të madhe tek audienca dhe për pasojë sjell dhe forcimin e mëtejshëm të influencës së saj.

4.2 Cable News Network – CNN

Cable News Network (CNN) është një medium amerikan kryesisht kabllor dhe kanal satelitor që është në pronësi të sistemit të Time Warner, që u themelua në vitin 1980 nga Ted Turner, i cili investoi 20 milionë dollarë amerikanë në këtë rrjet. Që me fillimin e tij, CNN u bë kanali i parë që transmetonte 24 orë lajme. Rrjeti filloi punën më 1 qershor 1980, në ora 17:00, me një personel prej 25 punonjësve të vendosur në selinë e saj në Atlanta dhe zyrat në Chicago, Dallas, Los Angeles, New York City, San Francisco dhe Uashington, DC. Transmetimi inaugurues ishte një hyrje nga Ted Turner, i cili njoftoi:

"Ne nuk do të ndalim transmetimet derisa të mbarojë bota. Që sot e tutje, ne do të mbulojmë ata që jetojnë dhe ajo çka përjetojnë ata aktualisht do të jetë ngjarja jonë e fundit. Ne do të transmetojmë himnin kombëtar për një kohë gjatë qershorit dhe kjo është e gjitha. Kur të vijë fundi i botës, ne do të transmetojmë "Më afër Perëndisë time" para se të ndalim transmetimet."
(Ted Turner, 1980)

Pas prezantimit dhe transmetimit të një versioni të regjistruar të 'Star-Spangled Banner', e cila ishte një traditë sa herë që një rrjet i ri në pronësi të Turner fillonte transmetimet, ekipi i përbërë nga Dave Walker dhe Lois Hart filluan moderimin për transmetimin e lajmeve të para. Në mesin e informacioneve të mbledhura për transmetimet e para ishte një intervistë me presidentin e atëhershëm Jimmy Carter, e realizuar nga Daniel Schorr. Pra, që në fillimet e veta, CNN ishte një kanal i fokusuar në atë që do transmetonin dhe mënyrën se si do ta transmetonin.

Më 1 janar 1982, kanali krijoi rrjetin e quajtur CNN2 (tani HLN), i cili më pas u quajt 'Headline News'. Ky ndryshim u bë një vit më pas, në janar të vitit 1983. Ndërsa CNN paraqiti një përzierje të lajmeve dhe programeve të specializuara aktuale dhe karakteristike, 'Headline News' u formatua fillimisht të përqendrohet në mënyrë rigoroze në transmetimin e lajmeve, duke shfaqur lajmet çdo gjysmë ore gjatë 24 orëve, me segmente të planifikuara në periudha kohore fikse çdo gjysmë orë. Si i tillë, ishte një nga kanalet e para të lajmeve që shfrytëzuan

qarkullimin e programit në një rotacion të caktuar. Lajmet kryesore e ndryshuan këtë mënyrë transmetimi të lajmeve në shkurt të vitit 2005, me përfshirjen e programeve të diskutimeve dhe lajmeve mbi personalitete të ndryshme të cilat kryesisht transmetoheshin gjatë natës.

Pas nisjes së punës të CNN, kanalet e tjera televizive kabllore filluan përpjekjet për të përfutur nga suksesi në rritje i kanalit, duke kopjuar formatin e saj, por këto përpjekje ishin të kufizuara për kanalin në fjalë dhe nuk arritën t'i bënin konkurrencë këtij mediumi. Një nga të parët ishte 'News Satellite Channel', i cili filloi më 21 qershor 1982 me një përzierje të lajmeve kombëtare dhe rajonale. Kanali i parë pushoi transmetimet më 27 tetor 1983 dhe sloti i saj në valët satelitore më pas u ble nga 'Ted Turner', për të zgjeruar shpërndarjen e 'Headline News' me një audiencë më të gjerë në shtëpitë amerikane. Turner ishte i rëndësishëm në ringjalljen e qendrës së qytetit si rrjeti i parë televiziv që transmetonte vetëm lajme në Shtetet e Bashkuara.

Siç mund të shohim edhe nga paraqitja e fakteve të mësipërme, që në fillimet e tij CNN u bë një kanal dominues dhe i fokusuar në audiencën që ajo targetonte, duke bërë të mundur një përqendrim të informacionit dhe një stabilitet në audiencë.

Në vitin 1990, Tom Johnson, i cili për 13 vjet kishte shërbyer si botues i Los Angeles Times, u emërua president i CNN. Sipas Johnson, CNN e kishte zgjeruar ndikimin e tij me nisjen e një numri të rrjeteve kabllorë dhe satelitorë televizivë, si brenda dhe jashtë vendit, duke filluar me nisjen e CNN Ndërkombëtar në vitin 1991. Dy rrjete të specializuara me qark të mbyllur filluan transmetimet, Rrjeti CNN Airport, që ofron një përzierje të përmbajtjes origjinale dhe transmetime të drejtpërdrejta të të dhënave në aeroportet kombëtare dhe botërore, dhe CNN Checkout Channel, një kanal i përshtatur për të qenë në dispozicion të dyqaneve ushqimore, që u mbyll në vitin 1993.

CNN nisi faqen elektronike të saj 'CNN.com' më 30 gusht 1995, e cila u bë një nga faqet më të njohura të lajmeve në botë. Disa nga faqet e internetit të specializuara kanë filluar

aktivitetin në vitet e mëvonshme, si CNNMoney, e krijuar në partneritet me bashkëpronësi me Money Friend. Gjithashtu, CNN filloi një rrjet radiosh që kanë dhënë lajme me përmbajtje të radiostacioneve të tjera në mbarë vendin. Rrjeti u rrit me 36 zyra, nga të cilat 10 brenda territorit dhe 26 të tjera ndërkombëtare, si dhe zgjeroi partneritetin e transmetimit më shumë se 900 stacione të ndërlidhura lokale, të cilat gjithashtu marrin lajme nëpërmjet shërbimit videove në filialin CNN Newsource. Suksesi i CNN bëri që themeluesi Ted Turner të përgatisë terrenin për blerje të multimedias konglomerate Time Warner duke e riemërtuar atë si Broadcasting System Turner në vitin 1996.

CNN ka 26 zyra ndërkombëtare dhe qendra të prodhimit në vende të ndryshme të botës. Sipas drejtorit ekzekutiv të shërbimit ndërkombëtar, Chris Cramer, korrespondentët dhe ekipet e këtij mediumi, punojnë në disa nga vendet më të rrezikshme dhe të shkreta në tokë, dhe përkushtimi dhe guximi i tyre është mbështetur nga miliona njerëz çdo ditë.

CNN nuk është vetëm një kanal televiziv anglistfolës i lajmeve, por ofron shërbime edhe në gjuhë të tjera, sikurse në spanjisht në gjithë Amerikën Latine, shërbimet në Turqi (CNN Turk), Spanjë (CNN+) dhe Gjermani (n-tv), dhe sjell informacione dhe lajme për miliona njerëz në gjuhën e tyre. Në internet, me gjashtë milionë përdorues në ditë, 'CNN.com' është faqja elektronike më e vizituar për lajme dhe informacione. Këto shërbime të internetit janë edhe në gjuhën arabe dhe japoneze. Shërbimet digjitale gjithnjë në rritje të CNN kanë bërë që lajmet e publikuara nga ky medium të arrijnë më shumë se një miliard njerëz në ditë.

CNN përfundimisht u bë i njohur për mbulimin e ngjarjeve nëpër botë ashtu si ato ndodhin, shpesh duke mposhtur edhe rrjetet kryesore. Ky rrjet fitoi audiencë të konsiderueshme me mbulimin e drejtpërdrejtë të Luftës së Gjirit Persik në vitin 1991 dhe audienca e tij u rrit së bashku me rritjen e popullaritetit të televizionit kabllor gjatë viteve '90.

Në vitin 1996, CNN u bashkua me 'Time Warner', i cili katër vite më vonë u bashkua me 'America Online'. Në ditët e sotme, Ted Turner është një aktivist mjedisor dhe i paqes,

përpyjekjet filantropike të cilit përfshijnë një dhuratë prej 1 miliard dollarësh në Kombet e Bashkuara në vitin 1997.

Siç mund të shihet edhe nga historiku i mësipërm, zhvillimi dhe zgjerimi i CNN ecën krah për krah me zhvillimin teknologjik, duke arritur gjithëpërfshirjen gjithmonë e më të madhe të audiencës dhe duke u kthyer në një kanal që e ushtron ndikimin e vet jo vetëm brenda, por edhe jashtë vendit.

Mbulimi i Luftës së Gjirit

Lufta e parë e Gjirit Persik në vitin 1991, ishte një çast vendimtar për CNN duke i dhënë një popullaritet të tillë këtij rrjeti, saqë arriti të kalonte "tre rrjete amerikane të mëdha" për herë të parë në historinë e saj, kryesisht për shkak të një të kthese historike të paparë më parë. CNN ishte e vetmja media me aftësi për të komunikuar lajmet drejtpërdrejtë nga brenda Irakut gjatë orëve të para të fushatës së bombardimeve amerikane, me raportime drejtpërdrejt nga Hotel Al-Rashid në Bagdad, nga gazetarët Bernard Shaw, Xhon Holliman dhe Peter Arnett. Momenti kur bombardimet filluan, më 16 Janar 1991 u njoftua në CNN nga Bernard Shaw, si më poshtë:

"Unë jam Bernie Shaw. Diçka po ndodh jashtë Peter Arnett është bashkë me mua këtu. Le të përshkruajmë për shikuesit tanë atë që po shohim ... Qielli mbi Bagdad është ndriçuar Ne jemi duke parë përshkënditje të shndritshme të cilat po plasin në të gjithë qiellin."

Përvoja nga Lufta e Gjirit solli në CNN disa ndryshime të shumëkërkuara dhe bëri që të ndryshohej tërësisht mënyra se si paguheshin gazetarët dhe shumat që u paguheshin. Shumë prej këtyre gazetarëve tani përbëjnë "gardën e vjetër" të CNN. Bernard Shaw u bë moderatori kryesor i CNN, deri në daljen në pension në vitin 2001. Të tjerë korrespondentë të mëvonshëm janë Wolf Blitzer (tani moderator i lajmeve të krizave) dhe korrespondentë ndërkombëtarë si Christiane Amanpour. Prania e Amanpour në Irak u interpretua nga aktorja Nora Dunn, në rolin e gazetares Adriana Cruz, në filmin e vitit 1999 'Three Kings'. Rrjeti Fellow Time Warner me pronësi të HBO më vonë prodhoi një film televiziv, 'Live nga Bagdadi', për mbulimin e CNN gjatë Luftës së parë të Gjirit.

CNN u kritikua se transmetonte dhe tregonte një interesim më të madh për histori 'interesi njerëzor' dhe se ishte duke iu shmangur përshkrimit të imazheve të dhunshme; rezultat i gjithë kësaj ishte një prezantim i lajmeve i dyshuar si "propagandistik". Një raport nga organizata 'Drejtësi dhe Saktësi në Raportim' citon një gazetar anonim që e përshkruan mënyrën e raportimit të CNN si një 'shikim i ëmbël e i bukur i bombarduesve, parë nga jashtë realitetit të Arabisë Saudite.'

Efekti CNN

Në fund të viteve '90, Piers Robinson paraqiti modelin e ndërveprimit politikë-media. Sipas këtij modeli, '*Efekti CNN*' është i mundshëm kur dy faktorë janë të pranishëm, pasiguria e politikave dhe inkuadrimi i mediave. Sipas tij, pasiguria politike është përcaktuar si një funksion i shkallës së konsensusit dhe koordinimit ndërmjet nënsistemeve qeveritare ekzekutive (të tilla si Departamenti Amerikan i Shtetit, Departamenti i Mbrojtjes, dhe Shtëpia e Bardhë) në lidhje me një çështje (Bahador, 2007).

Elementi i dytë i rëndësishëm dhe i nevojshëm në modelin e ndërveprimit politik-mediatik për një 'efekt CNN', është inkuadrimi i medias në mënyrë që të krijojë afërsi emocionale, duke u fokusuar në viktimat e një krize që ka nevojë për ndihmë nga jashtë (Bahador, 2007). Për të identifikuar inkuadrimin e medias, Robinson përdor analiza interpretuese dhe të fjalëve kyçe.

Mbulimi i Luftës së Gjirit dhe krizave të tjera të viteve 1990, në veçanti beteja famëkeqe e Mogadishut, i shtyu zyrtarët në Pentagon që të përdornin termin "Efekti i CNN", për të përshkruar ndikimin e perceptuar të realitetit nga mbulimi 24-orësh i lajmeve në proceset vendimmarrëse të qeverisë amerikane.

John Kiesewetter shpjegoi se CNN ka ndryshuar lajmin. Përderisa më parë janë raportuar ngjarjet në dy cikle, në mëngjes dhe në mbrëmje, tanimë kjo ndryshoi dhe lajmi nuk njehej cikël. Kur një aeroplan rrëzohet, ose ka të shtëna në një shkollë, ne presim t'i shohim ato menjëherë në kanalet televizive që mbulojnë lajmin. Nuk ka më varësi nga rrjetet e

transmetimit 'Big Three'. Pika e kthesës erdhi menjëherë pas ditëlindjes së dhjetë të CNN, kur Bernard Shaw, Peter Arnett dhe Gjon Holliman raportuan për Luftën e Gjirit të vitit 1991 nga një hotel në Bagdad.

Lufta e Gjirit ka dëshmuar se si CNN ndryshoi botën. Udhëheqësit ushtarakë amerikanë ishin të detyruar t'i zgjidhnin fjalët e tyre me kujdes gjatë informimeve të shtypit në televizion, duke e ditur se gjithashtu Saddam Huseini mund të ishte duke shikuar CNN.

4.3 REUTERS

Reuters u themelua në vitin 1851 nga Paul Julius Reuters, një emigrant gjerman i lindur në Britaninë e Madhe. Ai hapi një zyrë në qytetin e Londrës, që transmetoi kuotimin e tregut të aksioneve në mes të Londrës dhe Parisit nëpërmjet kabllit të ri të quajtur 'Calais-Dover'. Dy vite më parë, ai kishte përdorur pëllumba që fluturojnë, për të marrë informacion sa më të shpejtë për çmimet e aksioneve në mes të Aachen dhe Brukselit.

Reuters si agjenci u bë shpejt e njohur duke e zgjeruar shërbimin e saj në tërë shtypin britanik dhe në vendet e tjera evropiane. Më vonë ky medium u zgjerua duke përfshirë lajme të përgjithshme dhe lajme ekonomike nga e gjithë bota. Reputacioni i tij fitoi terren me shpejtësi të madhe në sajë të një numri të madh lajmesh bombastike që prodhoi. Një nga lajmet më të suksesshme gazetareske të kompanisë ishte në vitin 1865, kur kjo kompani mediale ishte e para në Evropë me lajmet për vrasjen e presidentit të SHBA-ve, Abraham Linkoln.

Përparimet teknologjike në telegrafin tokësor dhe kabllot nënujore, i lejuan kësaj kompanie që më së tepërmi bazohej në lajmet e përçuara me tela, të zgjerohej në lindje në vitin 1872 dhe në Amerikën e Jugut në vitin 1874.

Në vitin 1883, Reuters filloi transmetimin e mesazheve elektrike për gazetatat e Londrës dhe në vitin 1923 përdori radion për të transmetuar lajme ndërkombëtarisht. Ky medium ka qenë gjithmonë tejet i pavarur dhe ka parime të qarta për të gjithë gazetarët e vet, pavarësisht nëse këta janë redaktorë apo gazetarë terreni. Megjithatë, gjatë dy luftërave

botërore, nën presionin e qeverisë britanike për t'i shërbyer interesave kombëtare, ky raportim objektiv u cenua. Në vitin 1941, Reuters, i shtrembëruar nga presioni i qeverisë, nisi ristrukturimin e tij si një kompani private.

Pronarët e rinj, gazetarë kombëtarë dhe rajonalë britanikë, formuan *Reuters Trust*, me synimin për ta bërë këtë medium më të pavarur, pasi duhej të ruanin pavarësinë e grupit dhe asnjëanësinë. Grupi u regjistrua në vitin 1984 dhe nuk e ka pasur gjithmonë të lehtë në tregjet publike.

4.4 Roli dhe ndikimi i mediave në luftën në Kosovë

Duke iu referuar kapitullit të dytë të këtij kërkimi, ku është bërë një përshkrim i evoluimit të medias dhe impaktit që ka ajo në shoqërinë e sotme, pjesa më specifike është mënyra se si ajo shqyrton dhe filtron informacionin.

Ndoshta mund të ketë shumë kundërshtime në mënyrën se si është zhvilluar ky hulumtim, por nuk mund të mohojmë se roli që luan masmedia në jetën tonë të përditshme është gjithëpërfshirës dhe ka qenë i tillë që prej viteve '90. Duke e parë në këtë kontekst, le të shqyrtojmë dy të dhënat bazë në të cilat është i bazuar ky punim. Denoncimi social që bëri media në arenën ndërkombëtare ndaj gjenocidit në Kosovë dhe këndi i trajtimit të saj si një vend-shtet i ri.

Interpretimet e lajmeve janë një shembull kryesor i mënyrave të ndryshme se si kultura të ndryshme interpretojnë të njëjtat ngjarje. Gjatë luftës së vitit 1998-1999 në Kosovë, të njëjtat imazhe shpeshherë u shfaqën në televizione të vendeve të ndryshme, si në Nju Jork, Londër, Pekin dhe në vende tjera të botës, por audiencia në çdo vend i percepton imazhet në mënyra të ndryshme (Bahador, 2007).

Mbulimi mediatik është një hapësirë e kohës e ndarë për një lajm të caktuar nga linja e lajmeve rreth ngjarjeve të ndryshme. Të gjitha organizatat mediatike kanë një rubrikë dhe hapësirë të lajmeve, ku sasia e materialit mund të shpërndahet, publikohet, apo

transmetohet, gjatë një cikli të caktuar të lajmeve. Kjo përcaktohet nga dy faktorë. E para është koha apo hapësira në dispozicion të saj dhe e dyta është vendimi i organizatës se sa e hapësirë do të kushtojnë për një lloj të caktuar të lajmeve (Miller, 2007).

Më poshtë, në mënyrë kronologjike janë paraqitur mediat ndërkombëtare dhe mënyra se si ato e kanë parashtruar evoluimin e situatës në Kosovë, ballafaquar me kronologjinë e ngjarjeve parashtruar nga ana e historianëve.

Një kronologji e ngjarjeve kryesore përshkruar nga tri mediat në studim (BBC, CNN dhe REUTERS)

Korrik 1990 – Liderët shqiptarë etnikë shpallin pavarësinë nga Serbia. Beogradi shpërndan Qeverinë e Kosovës.

Shtator 1990 – Greva e përgjithshme e punëtorëve shqiptarë rezulton me përjashtimin e më shumë se 100,000 punëtorëve shqiptarë etnikë, përfshirë punonjësit e qeverisë dhe të medias.

1991 – Sllovenia, Kroacia dhe Bosnja shpallin pavarësinë nga Jugosllavia dhe shpallin pavarësinë e tyre.

1992 – Lufta shpërthen në Ballkan.

Korrik 1992 – Intelektuali shqiptar Ibrahim Rugova zgjidhet President i Republikës së vetëshpallur të Kosovës.

1993-1997 – Tensionet ndëretnike sjellin përshkallëzimin e konfliktit të armatosur.

8 gusht 1997 – Ushtria Çlirimtare e Kosovës-UÇK merr përgjegjësinë e disa sulmeve kundër forcave serbe.

28 nëntor 1997 – Në Kosovë, në Skënderaj, bëhen luftime të përgjakshme ku regjistrohen edhe të vdekur.

1 mars 1998 – Ushtria serbe nis një ofensivë të madhe ndaj rajonit të Drenicës në Kosovë.

Mars-Shtator 1998 – Konflikti i hapur mes policisë serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Forcat serbe nisin një goditje brutale. Civilët përzihen nga shtëpitë e tyre.

Shtator 1998 – NATO-ja i jep ultimatum presidentit Millosheviq për të ndalur sulmin mbi shqiptarët e Kosovës.

15 janar 1999 – Në Kosovë ndodh Masakra e Reçakut. Të paktën 45 kosovarë të vrarë. Masakra kryhet nga Policia Serbe.

6 shkurt 1999 – Nis Konferenca në Rambuje me qëllim shmangien e luftës në Kosovë.

Mars 1999 – Dështojnë bisedimet e paqes në Rambuje, ndërmjetësuar nga ndërkombëtarët.

24 mars 1999 – NATO nis operacionet ushtarake në Jugosllavi, operacionet ndërhyrëse vijuan deri më 9 qershor 1999. Më shumë se 1,500.000 kosovarë iu drejtuan Shqipërisë. NATO filloi sulmet ajrore kundër Jugosllavisë që zgjatën 78 ditë, para se Beogradi të pranonte Marrëveshjen e Kumanovës për tërheqjen e forcave nga Kosova. Qindra mijëra refugjatë shqiptarë të Kosovës u kthyen nga vendet fqinje.

27 maj 1999 – Lideri serb Slobodan Milosheviq akuzohet nga Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve të Rënda për gjenocid dhe krime lufte.

12 qershor 1999 – Forcat e NATO-s hyjnë në Kosovë, çlirohet Kosova.

Qershor 1999 – Presidenti Millosheviq bie dakord të tërheqë trupat nga Kosova. NATO ndal sulmet ajrore. OKB-ja përbën një Forcë për Zbatimin e Paqes në Kosovë (KFOR) dhe forcat e NATO-s mbërrijnë në krahinë. UÇK-ja pajtohet që të çarmatoset. Civilë serbë largohen nga sulmet hakmarrëse.

17 shkurt 2008 – Kosova e Pavarur. Shtetet më të fuqishme evropiane, si dhe SHBA njohin menjëherë Pavarësinë e Kosovës.¹⁵

Ndonëse kjo është një paraqitje e përafërt kronologjike e të dhënave nga ana historike, është e rëndësishme për këtë studim, pasi mund të identifikohet me mënyrën se si ndryshoi perceptimi i mediave ndërkombëtare për rrjedhën e ngjarjeve.

¹⁵ Të dhënat janë marrë nga faqet elektronike zyrtare të tre medimeve në studim, paraqitur në vijim:
BBC: http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/country_profiles/3550401.stm;
CNN: <http://edition.cnn.com/2004/WORLD/europe/08/31/milosevic.timeline/>;
REUTERS: <http://www.Reuters.com/article/2008/02/17/us-serbia-kosovo-timeline-idUSL3143246620080217>

Në vijim janë pasqyruar në tabela të ndara në tri pjesë, të dhënat e mbledhura nga media, nga literatura dhe nga intervistat cilësore, që njëherazi paraqesin edhe një parashtrim të përgjithshëm të fakteve të mbledhura. Ky seksion është i organizuar në disa tabela, në të cilat janë listuar cilësimet kryesore me të cilat është identifikuar Kosova në arenën ndërkombëtare, para, gjatë dhe pas luftës. Është pjesa më e rëndësishme e këtij punimi, pasi parashtrimi i tyre thjeshtëzon pjesën e analizës së të dhënave sasiore, ligjërimit dhe gjuhës gazetareske në vazhdim.

4.5 Pjesa I – Tabelat e të dhënave për përmendjen e Kosovës në mediat ndërkombëtare gjatë periudhës kohore 1990-2012, të ndara sipas tematikës¹⁶

Në tabelat e përmbledhura më poshtë, përfshihen të dhëna empirike për përmendjen e Kosovës në tre mediat në studim, në periudha të ndryshme kohore. Tabela e parë përfshin periudhën 1990-1998, qëllimisht për të vënë në pah dijeninë mbi raportimet për Kosovën, që janë bërë nga BBC, CNN dhe REUTERS, pavarësisht numrit më të vogël të artikujve. Varësia e tematikës në të cilën janë përqendruar raportimet ishte e llojit social, ngjarje politike, por në numër të madh, anonte nga raportimet për keqtrajtimin e shqiptarëve nga regjimi serb i asaj kohe. Në vijim (Tabela 1- vitet 1990-1998), është paraqitur numri i përgjithshëm i raporteve për Kosovën në varësi të tematikës dominuese të lajmeve.

Tabela 1 - Vitet 1990-1998 (varësia e tematikës: sociale, politike, keqtrajtim i shqiptarëve)

Media	Artikuj për Kosovën	Varësia e tematikës		
		Sociale	Politike	Keqtrajtim i shqiptarëve
BBC	378	32	114	232
CNN	325	74	108	143

¹⁶Artikuj të hulumtuar nga tre mediat në studim, për periudhën e lartcëktur, janë përshkruar si në vijim: BBC-shkrime 138, video dhe foto 240; CNN - shkrime 105, video dhe foto 220; REUTERS - shkrime 389, video dhe foto 267; Linçet online: www.bbc.com/archives/1990-2012/balkans-Kosovo.html, parë në janar - shkurt 2015; www.cnn.com/archives/1990-2012/balkans-Kosovo.html, parë në janar - prill 2015, <http://www.Reuters.com/archives/1990-2012/balkans-Kosovo.html>, parë në janar - maj 2015.

Për sa u përket zhvillimeve për periudhën 1990-1998, në BBC ndër cilësimet gjuhësore më shpesh të përdorura në artikuj të BBC, dominojnë ‘*gjenocid ndaj shqiptarëve*’, ‘*të drejtat e shqiptarëve*’, ‘*sulme kriminale të shqiptarëve*’, ‘*sulme terroriste të shqiptarëve*’ dhe të tjera të parashtruara në tabelat tek shtojca. Nga të dhënat statistikore vërehet se tendencat për të identifikuar tensionet e asaj kohe me konflikt fetar nuk mungojnë, por nuk dominojnë. Ndërsa epiteti ‘*UÇK organizatë terroriste*’ shfaqet e përdorur në vitin 1997 dhe dominon paralelisht me cilësimin e ‘*të drejtat e shqiptarëve*’.

Nga referimi i tabelës së mësipërme, mund të vërehet qartë se ka ekzistuar një interes për Kosovën në mediat botërore, që para fillimit të luftës në vitin 1998. Ndonëse informacioni ka qenë i pakët dhe më shumë i censuruar, pasi organe zyrtare ishin vetëm organet kompetente të asaj kohe, pra informacioni kryesisht vinte nga Beogradi, prapëseprapë kishte një rrjedhje të informacionit.

Për shkak të vetë natyrës që kanë këto media, varësia e raportimit është në përputhje me politikat e tyre redaksionale dhe natyrisht që nuk mund të dalin jashtë tyre. Sidoqoftë, është interesante të veçojmë se pavarësisht se raportimi ka qenë më i mangët, sërish ka pasur denoncime të ndryshme në opinionin botëror. Mjafton të kujtojmë Edit Durhamin dhe botimin ‘*Brenga e Ballkanit*’ (Durham, 1920), që ndonëse ishte një libër rrëqethës me ngjarjet që pasqyron, pati shumë pak impakt në arenën ndërkombëtare.

Është interesante të vëmë në pah se në periudhën për të cilën flasim, edhe pse populli shqiptar kishte bërë emër në arenën ndërkombëtare në sajë të historisë që e ka përndjekur, sërish opinionin ndërkombëtar anonte nga pala tjetër (ajo serbe) dhe raportimet ishin zyrtare, kryesisht libra dhe raportime të thata.

Duke marrë për bazë edhe zhvillimin teknologjik të asaj periudhe, ky nuk ishte një zhvillim jo logjik. Sidoqoftë, në periudhën e mëhershme theksi ishte vendosur më së shumti në sferën politike, ndërsa në fillim të viteve '90, ai kalon në pjesën e raportimit të gjenocidit dhe krimeve ndaj minoriteteve. Duke pasur parasysh arenën ndërkombëtare të asaj periudhe, kjo nuk është një pjesë e pakuptimtë, por është një vazhdimësi e asaj çka po ndodhte kryesisht në atë periudhë kohore.

Nga mënyra e ndërtimit të artikujve vihet re se paraqitet një paqëndrueshmëri e bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve etnike të ndryshme, duke e trajtuar këtë si problem të përgjithshëm në Ballkan (pas shpërbërjes së disa shteteve nga ish Jugosllavia, sikurse Sllovenia, Kroacia), por me fokus në Kosovë. Në raportime theksohen dhe ripërsëriten formulime gjuhësore të njëjta të përdorura shumë shpesh, duke iu referuar problemeve që adresojnë, sikurse “*tensione ndëretnike*”, “*konflikt i armatosur*”, ndërsa në veçanti, popullatës shqiptare të Kosovës i referohen vazhdimisht si “*shqiptarët etnikë*”, kurse regjimit të asaj kohe, i referohen “*forcat serbe*”, “*lideri serb*” (duke aluduar për presidentin e atëhershëm, Slobodan Millosheviq), që i konsideronin si shkelës të të drejtave themelore të shqiptarëve dhe më vonë si shkaktarë të gjenocidit ndaj popullatës civile. Si rrjedhojë, qysh në vitet '90 Kosova përshkruhet në mënyra të ndryshme në kontekst të ndasisë dhe tensioneve ndëretnike. Mirëpo mediat janë në radhë të parë denoncuese të lajmeve bombastike për vetë natyrën që kanë, por shfaq interes se si ndryshon ky raport në vitet në vazhdim.

Këto të dhëna, përveçse janë nxjerrë nga arkivi qendror i tri mediave në studim, janë plotësuar duke marrë në konsideratë edhe të dhëna nga burimet e hapura (përmes aksesit të lirë në google) të këtyre tri mediave. Disa nga këta artikuj, dokumentarë dhe fotografi, janë botuar edhe më vonë, por raportojnë periudhën në studim.

Tabela 2 - Viti 1999 (varësia e tematikës: humane, raportim lufte)¹⁷

¹⁷Artikuj të hulumtuar për tri mediet janë paraqitur në vijim. Të dhënat përfshijnë edhe raportime dhe dokumentarë që janë të aksesueshëm online.

Media	Artikuj për Kosovën	Varësia e tematikës	
		Humane	Raportim Lufte
BBC	1478	491	987
CNN	1025	22	1003
REUTERS	1756	277	1479

Siç mund të vërehet qartë nga të dhënat e tabelës së mësipërme (Tabela nr. 2), ka një ngritje të menjëhershme e numrit të raportimeve për Kosovën. Duke vlerësuar se kjo filloi nga fundi i vitit '98 dhe u shtua shumë në një periudhë njëvjeçare, bëhet fjalë për një shumëfishim të raportimeve për Kosovën, çka paraqet dhe një tregues të qartë se si po evoluonte situata dhe se si po shfaqej informacioni. Në këtë aspekt, është e rëndësishme të veçojmë se pjesa më e spikatur është fakti se në atë periudhë informacioni buron nga vetë shqiptarët. Pavarësisht se kanë pasur reporterë dhe operatorë të huaj nga tri mediat e lartpërmendura, shumica e informacionit vjen nga vetë shqiptarët, të cilët fillimisht morën rolin e përkthyesit për reporterët e këtyre mediumeve, por më vonë disa edhe luajtën vetë rolin e gazetarit. Mirëpo kjo është një e dhënë që paraqitet e analizuar hollësisht në vijim tek pjesa e analizës së intervistave cilësore.

Përcaktimi që është bërë në raportimet sipas tematikës së ndarë në '*humane*' dhe '*raportim lufte*', është për të vënë në pah se sa interes po tregohej, më shumë ndaj zhvillimit të luftës dhe pasojave të saj ndaj popullsisë civile, sesa ndaj aspektit politik, i cili tashmë kalon në plan të dytë. Ndërsa kjo është një situatë që vazhdon edhe në periudhën deri pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Në vitin 1999, përshkrimi i Kosovës dhe popullatës së këtij vendi vazhdon të trajtohet nga aspekti human, por me një intensitet të lartë, duke 'ndërtuar' titujt kryesorë që paraqesin gjenocidin ndaj popullatës civile, të kryer nga ushtria dhe paramilitarët serbë, si dhe

BBC (shkrime 938, video dhe foto 540), CNN (shkrime 357, video dhe foto 668), REUTERS (shkrime 779, video dhe foto 977). Linçet online e të dhënave të shqyrtuara nga arkivat qendrore të tre mediave në studim: www.bbc.com/archives/1990-2012/balkans-Kosovo.html, parë më janar-shkurt 2015
www.cnn.com/archives/1990-2012/balkans-Kosovo.html, parë më janar-prill 2015
<http://www.Reuters.com/archives/1990-2012/balkans-Kosovo.html>, parë më shkurt-maj 2015

dëbimin me forcë të civilëve shqiptarë nga shtëpitë e tyre, duke e cilësuar këtë veprim si spastrim etnik. Kjo ishte periudha që krijoi impaktin më të madh tek diplomacia ndërkombëtare, si pasojë e krimit që po kryhej ndaj popullatës civile, duke mos e parë më si zgjidhje dialogun ndërmjet palës shqiptare dhe asaj serbe.

Në mars të vitit 1999, një nga titujt kryesorë të CNN, referuar në burime zyrtare, mban titullin “*NATO: Kosovo on brink of 'major humanitarian disaster'*”, dhe nëntitulli ‘*Yugoslav official denies ethnic cleansing*’¹⁸(artikulli i plotë është i bashkëngjitur tek pjesa e shtojcave).

Në një artikull tjetër të botuar nga BBC, më 28 prill 1999, të titulluar “*Biggest massacre yet' in Kosovo*”¹⁹, qysh në krye është vendosur një fotografi e refugjatëve shqiptarë prapa grilave, ku kryesisht janë paraqitur fëmijë të vegjël. Përshkrimi i bërë nën fotografi thekson se refugjatët kosovarë në Shqipëri janë në rrezik nga artileria serbe. Fjalinë hyrëse artikulli e fillon duke cituar UNHCR-në, lidhur me kushtet e rënda dhe rrezikun në të cilin ndodhen refugjatët shqiptarë. Ndërsa në paragrafin e dytë thekson se 100 deri në 200 civilë, kryesisht gra dhe fëmijë, janë masakruar në Gjakovë (artikulli i plotë është bashkëngjitur tek shtojcat në fund të studimit).

Gjatë vitit 1999 Kosova përbënte lajmin kryesor ndërkombëtar në këto tri media. Kishte edicione speciale lajmesh vetëm sa i përket ngjarjeve në Kosovë, duke i trajtuar me një rëndësi të veçantë nga aspekti human, kryesisht raportime përmes refugjatëve dhe kushteve të rënda në të cilat gjendeshin, përvojave të tyre si përjetues të ngjarjeve, disa edhe të masakrave dhe krimit ndaj popullatës civile. Pra, në vitin 1999 Kosova u bë lajmi kryesor ndërkombëtar, duke u pasqyruar si një katastrofë humanitare përmes vrasjeve masive, përndjekjeve, numrit të madh të refugjatëve dhe kushteve të vështira në të cilat gjendeshin.

¹⁸Linku i artikullit online: <http://edition.cnn.com/WORLD/europe/9903/28/kosovo.fighting.02/> , botuar më 28 mars 1999; parë në prill 2015. Përkthimi dhe përshtatja e titullit në shqip “*NATO: Kosova në prag të fatkeqësisë së madhe humanitare*”, nëntitulli ‘*Zyrtari jugosllav mohon spastrimin etnik*’;

¹⁹Artikulli mund të aksesohet online në: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/330476.stm>;

Një artikull tjetër i CNN, i datës 29 mars 1999, mban kryetitullin “*SHBA thotë se Gjenocidi është shpalosur në Kosovë*”²⁰, nëntitulli i parë është “*Sulmet ajrore të vazhdojnë*”. Formulimi në mënyrën urdhërore që në nëntitull ‘...*të vazhdojnë*’ paraqet një kontruksion gjuhësor ‘pro bombardimeve’ që ky artikull përdor referuar deklaratave të zyrtarëve amerikanë që në kryetituj. Pavarësisht se referenca ka kryesisht burimet zyrtare, gjithë nëntituj tjerë i ka me përmbajtje gjuhësore duke paraqitur popullatën etnike shqiptare si palë e vuajtur, referuar burimeve zyrtare. Nëntitulli i radhës i këtij artikulli është “*Raportet për mizori janë ‘të besueshme*””, të ciline ndërlidh me deklaratën zyrtare të zëdhënësit të Departamentit Amerikan të Shtetit, atë kohë James Rubin, i cili i referohet dëbimeve masive të shqiptarëve të Kosovës, duke akuzuar serbët për vrasje të mësuesve në shkolla, civilëve të paarmatosur dhe për veprime ‘*të neveritshme e kriminale në shkallë makimale*’ (cituar nga artikulli).

Në përgjithësi artikuj të ngjashëm në terma ‘ektrem’ referuar veprimeve serbe në Kosovë dominonin në të tre mediat në vitin 1999, pavarësisht nëse ato i referoheshin burimeve zyrtare ndërkombëtare apo vet përjetuesëve të ngjarjeve. Është për t’u theksuar edhe fakti se kishte edhe kryetituj referuar deklaratave të pjesëtarëve të UÇK-së dhe të cilët cilësoheshin vetëm si ‘*KLA*’ (UÇK) pa ndonjë epitet krahasues të mirë apo të keq, si organizatë. Një fjalë e përmbledhur nga CNN, shkëputur nga një artikull i datës 28 mars 1999, thekson këtë kategorizim përkrahës në krah të UÇK-së dhe popullatës civile “*The Kosovo Liberation Army is fighting for Kosovo's independence from Yugoslavia.*”²¹

Pa dyshim që është raportuar edhe për zyrtarë policorë serbë të vrarë, por raportimi ka qenë kryesisht pa ngjyrimë emocionale në formulimin e raportimeve dhe si të tillë kanë dominuar artikujt pro popullatës etnike shqiptare. Në albumin e fotografive të lufës në Kosovëtë publikuar nga REUTERS, fotografia e tretë me radhë, e datës 26 mars 1998,

²⁰ Artikulli plotë është i aksesueshëm (pa pagesë): <http://edition.cnn.com/US/9903/29/us.kosovo.03/>

²¹ Artikulli i plotë i CNN (i aksesueshëm pa pagesë): <http://edition.cnn.com/WORLD/europe/9903/28/kla.leader/index.html>

mban këtë përshkrim (citar) "*The wife of Serbian policeman cries over her husband's coffin during an Orthodox funeral ceremony in the village of Brestovik, 100 km wes of Prishtina... The policeman died durinf clashes earlier this week between members of the Kosovo Liberation Army and Serbian police forces.*"²² Pra nëse krahasohet edhe ky përshkrim, pavarësisht se raportonte një polic serb të vrarë nga UÇK-ja, formulimi gjuhësor nuk përmban epitete të caktuara (pro apo kundër këtij akti) për UÇK-në, apo për policin e vrarë.

Edhe pse në të kaluarën ('90-'98) në aspektin gjeografik Kosova është cilësuar si krahinë në ish Jugosllavi, gjatë viteve 1998-1999 ajo vazhdimisht cilësohet vetëm si 'Kosovo'.

Nga të dhënat e raportimeve vërehet se interesi më i lartë për Kosovën është në vitin 1999. Ekzistojnë mbi njëmijë artikuj nga secili medium që raporton zhvillimet e kësaj periudhe. Tematika tashmë pothuajse fare nuk është fokusuar në zhvillime politike, krahas aspektit human të ndërtimit të lajmit. Pikërisht kjo ngritje e numrit të përgjithshëm të artikujve dhe ky ndryshim i këndit të trajtimit të zhvillimeve gjatë këtij viti, u bënë kriter i analizës sasiore të numrit të përgjithshëm me fokus në artikuj tematikë humane dhe raportim lufte, ku edhe përqendrohej numri më i madh i artikujve nga secili medium.

Konfliktet e Ballkanit, përfshirë Kosovën janë përshkruar si konflikte kryesisht ndëretnike dhe situata në vazhdimësi është përshkruar e trazuar, nëse analizojmë dhe krahasojmë formulimet gjuhësore në artikuj mediatikë të periudhës 1990 me vitet '98-'99. Vlen të theksohet se formulime specifike janë identifikar në periudha të caktuara kohore, kur shfaqen për herë të parë epitetet për UÇK-në si ushtri (në vitin 1999), Kosova si protektorat dhe formulime tjera gjuhësore që karakterizojnë zhvillimet në vend sipas viteve në vijim.

²² Fotografitë e aksesuara (pa pagesë): <http://www.reuters.com/news/picture/the-kosovo-war?articleId=USRTXBQBD#a=1>, të datës 17 shkurt 2009. Reuters.

Tabela 3 - Viti 2000 (varësia e tematikës: humane, raportim lufte)²³

Nga të dhënat e raportimeve vërehet se interesi më i lartë për Kosovën është në vitin 1999. Ekzistojnë mbi njëmijë artikuj nga secili medium që raporton zhvillimet e kësaj periudhe. Tematika tashmë pothuajse fare nuk është fokusuar në zhvillime politike, krahas aspektit human të ndërtimit të lajmit. Pikërisht kjo ngritje e numrit të përgjithshëm të artikujve dhe ky ndryshim i këndit të trajtimit të zhvillimeve gjatë këtij viti, u bënë kriter i analizës sasiore të numrit të përgjithshëm me fokus në artikuj tematikë humane dhe raportim lufte, ku edhe përqendrohej numri më i madh i artikujve për secilin medium.

Media	Artikuj për Kosovën	Varësia e tematikës	
		Humane	Raportim Lufte
BBC	987	578	419
CNN	1003	756	247
REUTERS	1156	799	357

Mund të themi se viti 2000 është vit i kthesës, ndonëse vazhdojnë raportimet nga lufta, tashmë ato janë gati në të njëjtin plan me pjesën e raportimeve nga politika, apo raportimeve juridike (krime lufte, marrëveshje dhe të ngjashme).

Kjo është më se normale, që pas kthimit gradual në normalitet të jetesës dhe ndryshimit të situatës, të fillojë një humbje e interesit publik, ndaj dhe mediat fokusohen në atë që i intereson opinionit publik. Sidoqoftë, ky është një aspekt që çon në vërtetimin e faktit se ndonëse bëhet fjalë për një vend relativisht të largët për t'u pasur si target nga grupi i mediave të sipërpërmendura, sërish vazhdohet të mbahet gjallë interesi publik me lajme

²³Artikuj të hulumtuar për BBC (shkrime 458, video dhe foto 529), për CNN (shkrime 398, video dhe foto 605)²³, për REUTERS (shkrime 658, video dhe foto 498). Linçet online në arkivat qendrore të tre mediave: www.bbc.com/archives/1990-2012, parë në janar 2014-shkurt 2015
www.cnn.com/archives/1990-2012, parë në janar 2014 - prill 2015
<http://www.Reuters.com/archives/1990-2012/>, parë në shkurt 2014 - maj 2015.

nga Kosova. Është një dukuri e veçantë, pasi në përgjithësi mediat kanë target-grupin e vet dhe i qëndrojnë besnike audiencës së vet, por çuditërisht, ndonëse situata fillon të qetësohet dhe lufta mund të quhet e përfunduar, ato ende vazhdojnë raportimet për një vend që nuk ka ndonjë interes të veçantë lidhur me target grupin e tyre.

Tabela 4 -Vitet 2001-2007 (varësia e tematikës: humane, raportim lufte, zhvillime politike)²⁴

Media	Artikuj për Kosovën	Varësia e temës		
		Humane	Raportim lufte	Zhvillime politike
BBC	679	247	164	268
CNN	987	298	292	397
REUTERS	789	173	157	459

Tabela më lart paraqet të dhëna për periudhën ndërmjet viteve 2001-2007 dhe numrin e artikujve në varësi të tematikës, të ndara në raportime humane, raportime lufte, apo zhvillime politike.

Në momentin që Kosova fillon të administrohet nga ana e Kombeve të Bashkuara, edhe raportimi mediatik ndryshon. Fokusi në këtë periudhë orientohet kryesisht drejt zhvillimeve politike. Sikurse do të vihet re tek tabela në vijim, raportimet nga Kosova fillojnë dhe humbin interes, krahasuar me periudhat e mëparshme. Është një dukuri që vihet re për të gjitha vendet e Ballkanit. Kjo tregon një veçori të këtyre mediave në raport me Ballkanin, që përmendet kryesisht në raste krizash ose veçori politike (skandale, korrupsion, krime lufte, etj.). Parë në këtë aspekt, sërish vijon një interes për Kosovën, ndonëse në nivele më të ulëta sesa fillimi i viteve '90, ajo vazhdon të jetë në fokus siç mund të vërehet edhe nga tabela e mëposhtme (tabela 5).

²⁴Artikuj të hulumtuar për BBC (shkrime 258, video dhe foto 421), për CNN (shkrime 498, video dhe foto 489), për REUTERS (shkrime 379, video dhe foto 410). Linçet online të arkivave qendrore të tre mediave në studim: www.bbc.com/archives/1990-2012/balkans-Kosovo.html, parë në janar 2014-shkurt 2015
www.cnn.com/archives/1990-2012/balkans-Kosovo.html, parë në janar 2014 - prill 2015
<http://www.Reuters.com/archives/1990-2012/balkans-Kosovo.html>, parë në shkurt 2014-maj 2015

Tabela 5 -Vitet 2008-2012 (varësia e tematikës: sociale, politike, krime lufte)²⁵

Media	Artikuj për Kosovën	Varësia e temave		
		Sociale	Politike	Krime Lufte
BBC	256	32	198	26
CNN	195	11	87	97
REUTERS	289	47	89	153

Nga kjo tabelë (Tabela 5) vihet re se përqendrimi i tematikës së artikujve për Kosovën tashmë është i orientuar drejt zhvillimeve politike dhe krimeve të luftës.


4.6 Pjesa II – Analizë e gjuhës gazetareske

Në tabelat e veçanta, të vendosura tek pjesa e shtojcës në fund të punimit, është pasqyruar në mënyrë të posaçme se çfarë cilësimesh kanë përdorur më së shumti këto tre medime për të karakterizuar popullatën shumicë të Kosovës, konkretisht shqiptarët. Kam zgjedhur këto cilësime, jo vetëm sepse kanë qenë më të përmendurat, por tregojnë edhe se si evoluon situata e pasqyruar nga mediat, në përputhje me evoluimin e situatës në arenën ndërkombëtare. Kryesisht, ka rëndësi fakti që gjatë raportimit mediat janë të vetëdijshme për sa i përket historisë së Kosovës dhe gjithmonë i referohen përkatësisë etnike, por në të shumtën e rasteve vazhdojnë t’u drejtohen në aspektin e veçantë si popullatë e një krahine të veçantë. Ajo çka përpiqem të nxjerr në pah është fakti se edhe pse ekziston vetëdija se janë pjesë e një popullsie që ka një shtet tashmë (duke iu referuar aspektit të kombit), ata i referohen përkatësisë së tyre etnike si një ndasi e një shteti tjetër dhe jo si një pjesë e tërësisë së trojeve shqiptare. Nga vetë mënyra se si i paraqesin lajmet, duket që ndonëse denoncimi dhe hovi që iu dha Kosovës në arenën ndërkombëtare ishte prej mediave, ekziston një mospërputhje me mënyrën se si vetë

²⁵Artikuj të hulumtuar për BBC (shkrime 198, video dhe foto 58),për CNN (shkrime 58, video dhe foto 137), për REUTERS (shkrime 102, video dhe foto 187). Linçet online të aksesueshëm me parapagim: www.bbc.com/archives/1990-2012/balkans-Kosovo.html, parë më janar 2014-shkurt 2015
www.cnn.com/archives/1990-2012/balkans-Kosovo.html, parë më janar 2014 - prill 2015
<http://www.Reuters.com/archives/1990-2012/balkans-Kosovo.html>, parë më shkurt 2014-maj 2015

media e shikon Kosovën. Raportimin nuk e bëjnë si një vend me shumicë të popullsisë shqiptare, por si një krahinë me shumicë popullate shqiptare, e cila është e ndarë nga pjesët e tjera. Rol në këtë aspekt kanë luajtur edhe raportimet e mëhershme të para viteve '90, ku Kosova shihej si një krahinë me vetëqeverisje. Por siç do shihet edhe në pjesën e intervistave në kapitullin në vijim, më së shumti ky fenomen u nxit nga vetë gazetarët e Kosovës (apo siç njiheshin me termin 'fikserët vendor'), të cilët përveçse në rolin e përkthyesit, orientonin edhe reporterët ndërkombëtarë për tek vendi i ngjarjes, e në këtë mënyrë ata ndihmonin në paraqitjen e realitetit nga vendngjarja dhe jo më vetëm nga burime dytësore.

Diagrama 1 - Videot e analizuar të BBC për periudhën 1990 – 1998




Sikurse mund të shihet nga diagrami i mësipërm (tek pjesa e shtojcave është bashkëngjitur Tabela 6), cilësimet e përdorura për të përshkruar situatën në Kosovë dhe komunitetin shumicë të popullatës së saj, ndryshojnë nga viti në vit në atë që anojnë gjithmonë e më shumë nga ana e popullit shqiptar të paraqitur si viktimë të represionit serb. I gjithë evoluimi i të dhënave, si informacion i detajuar, çon në të njëjtin përfundim: qarkullimi i informacionit që bën media të jetë çdo vit e më shumë në favor të Kosovës. Kjo nuk ndodh

vetëm me të dhënat e BBC, siç mund të vihet re më poshtë, por me të dhënat e të tri medimeve të marra në konsideratë.


Nëse i referohemi cilësimeve të CNN për periudhën e njëjtë, vërehet se dominojnë pothuajse të njëjtat epitete, sikurse ‘*gjenocid ndaj shqiptarëve*’, ‘*protesta paqësore*’, ‘*të drejtat e shqiptarëve*’, ‘*sulme kriminale të shqiptarëve*’, ‘*konflikt fetar*’ dhe të tjera të parashtruara në diagramën në vijim. Vlen të theksohet se CNN në vitin 1997 ka një shumfishim të numrit të artikujve ku flet për të drejtat e shqiptarëve, krahasuar me vitet paraprake. Kjo është një veçori që ka dominuar tek CNN krahas BBC dhe Reuters.

Diagrama 2 - Videot e analizuar të CNN për periudhën 1990 – 1998



Në tërësi, ngjarjet e Kosovës rrëfeshin në mënyrë të njëtrajtshme (me pak ndryshime) deri në periudhën e luftës në Kosovë.

Diagrama 3 - Videot e analizuaru të Reuters për periudhën 1990 – 1998



Për të dhëna më të hollësishme, shih tabelat që janë bashkangjitur tek shtojcat në fund të këtij punimi.

4.7 Pjesa III – Tabelat me të dhënat e burimeve të informacionit nga tri mediat BBC,

CNN dhe REUTERS

Media, si në nivel ndërkombëtar ashtu edhe në atë lokal, mund të luajë një rol të rëndësishëm në raportimin e konflikteve duke ndihmuar për të sjellë paqe dhe stabilitet në vendin në konflikt. Ajo raporton lajmin, shërben si një ndërmjetës midis qeverisë dhe popullit, si dhe i mban njerëzit të përfshirë në mënyrë aktive në shoqëri dhe në politikë.

Në rastin e Kosovës, një rol parësor në tejçimin e informacionit fillimisht luajti edhe fakti që mungonin organet kompetente për transmetimin e informacionit. Stili i raportimit të konfliktit është përshtatur ndërmjet paraqitjes së një ngjarje në favor të një pale apo palës tjetër (referuar përkatësisë etnike të palëve), sipas burimeve të informacionit. Në periudhën '90-'98 burime informacioni ishin më shumë ato zyrtare serbe. Në fillim të vitit 1999, kjo

qasje ndryshoi. Shumica e informacioneve merrej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga reporterët e huaj të shoqëruar nga gazetarët vendas.

Burime zyrtare nga Kosova dhe Serbia konsiderohen institucionet shtetërore, zyra diplomatike dhe mediat në përgjithësi. Burime jo zyrtare konsiderohen raportimet me përjetues të ngjarjeve apo zhvillimeve të kohës, me persona që nuk janë pjesë e institucioneve shtetërore, apo burime të paidentifikuara apo anonime, kur i janë referuar ‘*sipas burimeve nga vendi...*’. Ky krahasim është bërë për të reflektuar mënyrën e trajtimit të zhvillimeve në kohë, bazuar në burime informacioni.

Në raportime do të vërehet se gjatë periudhës së konfliktit, dominojnë burimet e diplomatike ndërkombëtare dhe vet përjetuesit e ngjarjeve. Në raste të mungesës së burimeve të informacionit, shpeshherë lajmet janë thurur edhe duke pasqyruar imadhe me ‘tym’ nga një distancë, ku gazetari përshkruan me fjalë të tij situatën.

Tabela 21 – Burimet e informacionit të ndara në zyrtare dhe jozyrtare

Media	Periudha	Burimi i informacionit			
		Zyrtare		Jozyrtare	
		Serbe	Shqiptare	Serbe	Shqiptare
BBC	1990-1998	37	9	86	49
	1999	29	7	54	167
	2000	18	12	37	279
	2001-2007	21	67	39	167
	2008-2012	29	57	79	109
CNN	1990-1998	38	8	86	48
	1999	28	8	54	168
	2000	18	17	38	288
	2001-2007	21	68	38	168
	2008-2012	28	58	88	108
REUTERS	1990-1998	34	6	86	46
	1999	26	4	54	164
	2000	18	32	34	246
	2001-2007	21	64	36	164
	2008-2012	26	54	46	106

Megjithatë, burimet e informacionit nuk kanë munguar as ato diplomatike serbe, as ato nga figura politike, ushtarake e policore, kryesisht kur situatën e paraqisnin si një luftë kundër

një grupi apo organizate terroriste (aluduar në UÇK-në). Nga tabela më lartë, vërehet se raportimi në periudhën 1999-2000, dominon i mbështetur në burime jozyrtare shqiptare (nga Kosova).

Vlen të theksohet se në periudhën e krizës, burimet e informacionit që dominojnë janë edhe ato zyrtare ndërkombëtare, ku citohen figura politike, diplomatë, apo organizata diplomatike që ishin vendosur me mision në Kosovë për të monitoruar zhvillimet (apo ishin në vende të rajonit). Pavarësisht se shumica e deklarimeve të tyre përdornin terma të ashpër kundër veprimeve të Serbisë në Kosovë, këto deklarata në shumë raste përbënin kryetituj, apo përmbajtje kryesore të artikullit, praktikë kjo që nuk vihet re në raportimet e mëparshme.

KAPITULLI V: ANALIZA E LIGJËRIMIT

Lajmet e mediave, konkretisht lajmet ndërkombëtare të mediave me ndikim botëror, shërbejnë si burime të vlefshme të informacionit dhe mënyrave të fuqishme të komunikimit. Ky pushtet i tyre kontrollon atë çka njerëzit shohin, dëgjojnë dhe kuptojnë mbi ngjarjet që ndodhin përditë në mbarë botën. Informacioni i përcillet marrësit të tij nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit, të cilat janë përshtatur për të përmbushur qëllimet. Duke përdorur forma të veçanta për të ndihmuar dhe udhëzuar audiencën e tyre drejt të kuptuarit, mbulimi mediatik i lajmeve mund të formësojë mendimin e masës.

Nisur nga ato çka u thanë edhe më sipër, mund të kalojmë në një analizë të përgjithshme. Sikurse është pasqyruar në të dhënat e paraqitura më lart, imazhi se si kanë evoluar ngjarjet deri në arritjen e pavarësisë së Kosovës, parashtrohet më së miri. Duke bërë një krahasim midis kronologjisë historike dhe të dhënave të mbledhura nga mediat, shfaqet qartë se si këto të dyja janë në përpjesëtim të drejtë me njëra-tjetrën. Duke parë cilësimet dhe mënyrën se si u paraqit Kosova para, gjatë dhe pas luftës, në të dhënat e mbledhura nga këto tri medime, të pasqyruara në tabelat më sipër dhe ato të bashkëngjitura tek shtojcat, mund të kalojmë lehtësisht në një pasqyrë të përgjithshme referimi.

Ndonëse ndaj problemit që kishte Kosova dhe gjenocidit që ndodhi ndaj shqiptarëve, denoncimet e mëhershme kanë datuar qysh në shekullin XIX, ishte roli që luajti teknologjia dhe mënyra se si u interpretua nga media ajo që bëri perceptimin final të tyre dhe solli ndryshimin. Duke qenë se rrjedha e informacionit në tërësinë e vet erdhi nga vetë gazetarët vendorë, kjo bëri që të kishte një rrymë kundërvepruese ndaj politikës antishqiptare të trumbetuar deri në atë periudhë.

Nga ana kronologjike mund të shihet më së miri se si evoluojnë epitetet e paraqitura në media. Në të vërtetë, është një përgjithësim i paraqitur në tabelat e mësipërme lidhur me mënyrën se si është reflektuar evoluimi i opinionit ndaj shqiptarëve dhe Kosovës në tërësi.

Deri në momentin kur filloi raportimi i ngjarjeve nga ana e shqiptarëve, apo thënë më mirë, momenti kur ata i dhanë orientimin ngjarjeve, ajo çka ekziston në kanalet e komunikimit është kryesisht propaganda kundër këtij komuniteti, që përbënte shumicën e popullsisë së Kosovës. Natyrisht, që kjo ishte nxitje nga mediumet serbe të asaj kohe, si burime kryesore informacioni, mirëpo kur raportimet ndihmohen nga ana e gazetarëve vendorë, atëherë fillon dhe ndryshimi i përgjithshëm i tyre.

Gjithashtu, nëse analizohen me kujdes tabelat e përmendjes së Kosovës në tri mediat kryesore, vërehet se interesi më i madh për Kosovën është gjatë konfliktit, ndërsa në momentin që fillojnë dhe qetësohen ujërat, interesi fillon dhe bie në mënyrë të ndjeshme.

Më shumë se gjysma e të dhënave në tabelat ku përmendet Kosova, janë të orientuara drejt epiteteve pozitive. Nëse i referohemi teorive të komunikimit të cekura në kapitujt më sipër, shikojmë se si ato i referohen rasteve të paraqitura në tabelë.

Për ta pasur akoma më të qartë situatën, kam përzgjedhur tre artikuj nga secili prej këtyre tre mediumeve, për të treguar se si u rrit impakti në secilin prej tyre.

5.1 Analizë e artikullit nga CNN

Titulli i artikullit: *Refugjatët thonë se mijëra kosovarë të tjerë janë vrarë*

(data e publikimit: 17 prill 1999)

Ky artikull, ndonëse citon NATO-n në atë çka raporton, fillon me një ton shumë të ashpër dhe vë në pah menjëherë se çfarë po ndodh në Kosovë. Është interesante të vihet në dukje se ndonëse faktet janë të mirëfillta, duke përfshirë edhe raportim nga terreni, edhe pse në fillim iu referohet shqiptarëve të Kosovës me epitetin ‘kosovarë’, në pjesën tjetër të artikullit referimi që u bëhet atyre është ‘shqiptarë’. Po e vë në dukje këtë cilësim, pasi ka të bëjë me teoritë e diskutuara në kapitullin e dytë. Siç dihet, ekziston një shtet i shqiptarëve, por gati në të gjitha raportimet, ndonëse më së shumti iu drejtohen atyre si shqiptarë, në pjesët kyçe të artikullit gjithmonë ata cilësohen si ‘kosovarë’.

Sipas Robinsonit, bombardimi me informacion të vazhdueshëm lidhur me një politikë specifike bënte që audienca ‘të përputhej’ me median (Robinson, 2005).

Artikuj të tillë, si ai i cekur më sipër, janë të shumtë në arkivën e CNN-it dhe shpeshtësia e rifreskimit të tyre është jo më pak se gjysmë ore. Po ashtu, epitetet e përdorura në favor të popullatës me shumicë shqiptare janë të shumta dhe përdoret një mënyrë e veçantë krahasimi midis asaj që po ndodh me shqiptarët dhe mënyrës se si trajtohen serbët. Nëse nga njëra anë pasqyrojnë gjenocidin dhe vrasjet që po ndodhin ndaj shqiptarëve, si dhe pafuqinë e NATO-s për të mbrojtur popullatën vendase, vihet përballë fakti se si trajtohen ushtarët serb të kapur rob.

Me anë të një përballjeje të dy situatave, ku nga njëra anë tregon se gra dhe fëmijë të pafajshëm po theren, vriten dhe masakrohen vetëm për shkak të etnisë, ata që janë duke bërë këto krime i gëzojnë të gjitha të drejtat e robit të luftës dhe madje edhe ato fetare, thekson më tepër atë se çfarë realisht po ndodh në vend.

Gjithashtu, është për t’u veçuar edhe fakti se si CNN bën rehabilitimin e UÇK-së. Nëse në artikuj të mëhershëm ushtarët e kësaj ushtrie njihen si rebelë shqiptarë, që po bëjnë sulme ndaj policisë serbe, siç është paraqitur edhe në artikullin e plotë tek shtojcat, media nuk i referohet më UÇK-së si rebelë që sulmojnë shtetin, por si një forcë e armatosur që mbron popullatën vendase.

Është gjithashtu me interes që të veçojmë një specifikë që vihet re kryesisht tek CNN. Si një kanal transmetimi 24 orësh, nuk përsëriten lajmet që janë transmetuar më përpara. Pavarësisht se është një kanal që ka bërë bujë me teknikën e vet të ashtuquajtur si ‘CNN effect’ (Efekti CNN), dhe ka ndryshuar disa herë rrjedhën historike të politikave amerikane, suksesi më i madh i saj qëndron në faktin se ndonëse lajmet në përgjithësi mund të përsëriten, ka gjithmonë një element të ri, apo një ndryshim. Mënyra se si kjo media raporton është mjaft profesionale dhe e drejtpërdrejtë. Shpeshherë, ndryshimi mund të jetë edhe thjesht ndryshimi i moderatorit që raporton.

Gjithashtu, ia vlen të theksohet edhe mënyra se si është raportuar pjesa e krizës në Kosovë, ku haset gjithmonë një dualitet. Në pamje të parë duket se kemi të bëjmë me një raportim të drejtpërdrejtë nga terreni, por kur fillojmë dhe analizojmë vetë shkrimin, atëherë dalin në pah shumë elementë që ndikojnë në pritshmërinë e audiencës, shpeshherë edhe në mënyrë të tërthortë.

Përdorimi i cilësimeve specifike, siç janë ato që përdoren në përshkrimin e viktimave të luftës, është akoma më i drejtpërdrejtë kur është fjala për refugjatët shqiptarë, krahasuar me palën tjetër. Interesante është mënyra se si pasqyrohet situata që po vuan pjesa e popullatës civile e pafajshme, krahasuar me palën serbe. Duke marrë dhe duke raportuar dy situata krejt të ndryshme, ndikohet në perceptimin se si audienca shikon njërin palë dhe se si shikon palën tjetër. Por le të jemi më specifike në analizimin e tekstit. Duke qenë se është një raportim i drejtpërdrejtë ku burimi kryesor është NATO, atëherë nuk ka nevojë për komente, të gjitha të dhënat citohen nga burime zyrtare të asaj kohe. Pjesa interesante është mënyra se si është renditur lajmi. Fillon me një titull që fokusohet në faktin se vazhdojnë vrasjet në radhët e refugjatëve dhe popullsisë civile. Jepet një sfond historik i zgjeruar i kësaj pjese, duke cituar burime zyrtare, pas kësaj kalohet në pjesën tjetër dhe duke cituar pjesëtarë të UÇK-së, tregohet se NATO është e paafte ta mbrojë popullatën për vetë mënyrën se si është konceptuar fushata. Është një fushatë ushtarake e bazuar në bombardime, dhe NATO-s i duhet të bombardojë fshatin ku është strehuar ushtria serbe, ndërsa serbët janë duke përdorur popullatën e pafajshme si mbulesë. Theksohet që nëse NATO bombardon, atëherë do vriten edhe të pafajshëm bashkë me serbët, ndërsa në pjesën finale tregohet se si trajtohen robërit serbë, komandantët në këtë rast, me të gjitha të drejtat e robërve.

Realisht ajo çfarë transmetohet në këtë artikull është fakti që edhe pse ndërhyrja e NATO-s ka filluar, gjenocidi ndaj popullatës shqiptare po vazhdon. Pasqyrohet fakti se po vazhdojnë të vriten dhe përndiqen të pafajshmit, të cilët vetëm po bëjnë përpjekje t'i

shmangen luftës dhe t'i çojnë familjet e tyre në një vend të sigurt. Pala tjetër paraqitet duke përdorur fshatrat shqiptare që të bëjnë joefektive ndërhyrjen e NATO-s, pasi nuk mund të bombardohen, duke lënë si mbrojtës të vetëm të tyre UÇK-në. Dhe së fundmi, hiqet mundësia e kontestimit të arsyeve dytësore të palës tjetër, serbe, duke treguar se edhe kur kapen robër ushtarakë vazhdojnë që të trajtohen me të gjitha të drejtat e robërve të luftës, duke e theksuar edhe më shumë egërsinë e njërës palë kundrejt palës tjetër.

Pra, me pak fjalë, artikulli është duke bërë një perifrazim të aktorëve kryesorë edhe duke i vendosur ata në pozicionet e tyre, edhe duke i treguar për atë çka janë. Gjithashtu, në mënyrë të tërthortë është duke shtruar rrugën për ndryshimin e perceptimit të UÇK-së, duke e kaluar nga një forcë rebele, siç mund të perceptohej nga mënyrat e ndryshme të raportimit nga e kaluara, në një forcë mbrojtëse të popullatës së pafajshme; pra, është duke e kaluar nga një status në një tjetër. Ndonëse janë duke përdorur burime zyrtare për të bërë një raportim të drejtpërdrejtë të lajmeve, sërish mënyra e strukturimit, siç mund ta shohim edhe nga analiza e mësipërme, i jep një kuptim krejtësisht të ri raportimit. Si gjithmonë audienca ndikohet më së shumti nga nënkuptime dhe mesazhe subliminale, sesa ato të drejtpërdrejta (Pettijohn, 2002), dhe në këtë rast mesazhet subliminale janë të orientuara në mënyrë specifike karshi shqiptarëve.

Gjithashtu, edhe nocioni i transmetimit të agjendës, e cila do të tregonte se çfarë politike është duke ndjekur media dhe a është duke vepruar nën ndikimin e agjendave të caktuara qeveritare ose grupeve të interesit, apo është duke transmetuar agjendën e vet (Robinson, 2005), del shumë mirë në pah gjatë shkrimit. Duke theksuar pafuqinë e NATO-s për të mbrojtur popullatën vendase, ajo e bën të qartë se në çfarë mënyre është duke e interpretuar atë çka po ndodh dhe thekson në mënyrë specifike rolin e gjithsecilit aktor. Natyrisht, prova të mirëfillta 100% në këtë rast nuk mund të ofrojmë, por tonet e përgjithshme të këtij artikulli, më së shumti anojnë në faktin se është vetë media që po e përçon këtë mesazh, sesa organet qeveritare dhe autoritetet e atëhershme.

Pjesa që e vërteton më së miri këtë dualitet midis një raportimi profesional dhe një mesazhi subliminal, konsiderohet se është pjesa e përshkrimit se si po trajtohet oficeri i kapur rob. Duke e vënë mesazhin në deklarin e oficerit serb dhe duke cituar “*po më trajtojnë më së miri si rob luftime*”, menjëherë pasi vë në dukje deklaratën e gjeneralit të NATO-s se është e vështirë të mbrojnë popullatën për shkak se serbët po i përdorin si mburojë ndaj bombardimeve të NATO-s, është një mënyrë efektive për të nxjerrë në pah situatën duke qëndruar profesionalë, si dhe duke e influencuar audiencën në të njëjtën kohë, duke e fokusuar interesin e saj në atë drejtim që kërkon media, nëpërmjet eufemizmave të kundërt (Robinson, 2005).

Ndonëse mënyra e raportimit dhe ajo që tejçohet tek publiku në fjalë është profesionale, e cituar nga burime zyrtare, mënyra e ndërtimit të informacionit dhe e transmetimit të tij është e tillë që çon në ndikimin e audiencës. Mënyra e përdorimit të anës humanitare të problemit dhe theksimi i mbivendosjes së të kundërtave për të dhënë një impakt më të madh tek audienca, e ndikon atë dhe njëkohësisht nëpërmjet saj dhe diplomacinë ndërkombëtare, duke i dhënë kahun e kërkuar, dhe duke bërë zhvillimin e luftës në atë kah që media e quan si “anën e drejtë” të përkrahjes dhe mbështetjes nga ana e tyre (Bahador, 2007). Duke qenë se media është ajo që përçon informacionin dhe duke qenë se besueshmëria ndaj saj është shumë më e madhe sesa besueshmëria ndaj qeverive, ai kah që ajo mbështet bëhet kahu që mbështet edhe opinionin publik të cilit i drejtohet. Parë në këtë këndvështrim, duket qartë se si perceptimi i krijuar nga CNN nëpërmjet informacioneve reale dhe të marra nga burime zyrtare është në kahun që preferon vetë kanali në fjalë.

Nëse ky është një efekt anësor i lajmit, apo një efekt i induktuar në mënyrë të llogaritur, kjo është më e vështirë për t’u analizuar. Në këtë rast le të përqendrohemi tek mënyra se si raportohet UÇK-ja te ky artikull.

Cilësimi i parë me të cilin paraqitet UÇK-ja në këtë artikull është “rebelët shqiptarë të armatosur” dhe ky cilësim nuk ndryshon gjatë raportimit, por duke nxjerrë në pah anën

humanitare të problemit dhe duke e bërë gjithmonë e më tronditëse situatën në shkrim, vjen momenti ku i nxjerr këto forca rebele të armatosura si të vetmen forcë që po vepron për të mbrojtur popullatën dhe refugjatët që janë në mëshirë të forcave serbe.

Siç edhe dihet nga artikujt të ndryshëm të botuar nëpër gazeta, fillimisht UÇK-ja nuk njihej si një trupë e armatosur për mbrojtjen e popullatës civile, por si një organizatë terroriste. Pothuajse në të gjitha raportimet e para mediatike, termi që e ka shoqëruar për identifikim ka qenë “forcat rebele shqiptare të armatosura”. Por, pavarësisht kësaj, mënyra se si e paraqet rolin e kësaj force të ashtuquajtur rebele në marrëdhënie me popullatën dhe NATO-n, i jep asaj një kuptim të ri dhe një qasje tjetër audiencës për të. Pra, mund të themi se media është duke bërë rehabilitimin e kësaj force rebele dhe gradualisht është duke i dhënë asaj rolin e një ushtrie dhe jo më të një force të ashtuquajtur rebele.

Duke qenë se televizioni vazhdon të mbetet dhe sot e kësaj dite një nga format më të fuqishme të komunikimit dhe manipulimit të opinionit, kjo paraqitje ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në perceptimin e realitetit nga ana e audiencës dhe bën që ajo të konfirmohet me mesazhet subliminale që paraqiten në këtë rast, më shumë se me raportimin e drejtpërdrejtë. Ky manipulim që derivon më shumë në aspektin subliminal se sa në një deformim të drejtpërdrejtë të realitetit, bën që të mos ketë më një ndasi në perceptim nga ana e audiencës dhe e çon atë drejt asaj çka kërkon media, jo drejt asaj çka percepton vetë audienca nga raportimi i mirëfilltë.

Gjithashtu, duhet pasur parasysh edhe një faktor tjetër në këtë analizë. CNN është njëri prej kanaleve që ndiqet gati në të gjithë botën në kohë reale. Pozicionimi i tij në një drejtim të caktuar, qoftë ky i ndërgjegjshëm apo i manipuluar nga rrethana të tjera, bën që impakti i tij të mos jetë vetëm në një zonë të caktuar, për shembull Shtetet e Bashkuara, por të ketë efekt më të gjerë në audiencën mbarëbotërore. Si i tillë, mesazhi që përcillet dhe perceptimi i realitetit që krijon kanë efekte më gjithëpërfshirëse krahasuar me faktin nëse i njëjti mesazh do të

transmetohej në një televizion vendor. Si e këtillë, influenca e tij është shumë më e madhe sesa duket në pamje të parë. Gjithashtu, ndasia e epiteteve që bën kur i referohet shqiptarëve si popullatë dhe kosovarëve, si entitete të ndara, hedh bazat e para për krijimin e një sovraniteti të ri. Duke qenë se CNN është i njohur edhe për shumë raste të tjera që ka ndikuar në politikën e jashtme dhe diplomacinë e SHBA-ve (De Franco, 2012), kjo mënyrë adresimi hedh themelet për atë që më vonë do legalizohet nga Pakoja e Ahtisarit, që është Kosova si protektorat, e deri në marrjen e pavarësisë nga ana e Kosovës. Edhe pse në pamje të parë kjo nuk reflekton si një e dhënë që luan rol të veçantë, është aktualisht perceptimi që krijon kjo lloj mënyre e të raportuarit që sjell e para këtë lloj efekti. Raportimet e para për Kosovën i referoheshin asaj si një krahinë e banuar më së shumti nga popullata shqiptare, por gjithmonë nën sovranitetin serb. Perceptimi i Kosovës si një shtet i veçantë nga Serbia vjen më vonë dhe është kryesisht i referuar nga mediat. Gjithashtu është e rëndësishme të përmendet edhe fakti që informacionet edhe për gazetarët e huaj të këtyre rrjeteve vinin nga gazetarët vendorë, që më së shumti ishin të fokusuar në raportimet vendore në rolin e përkthyesit dhe që me vazhdimin e bashkëpunimit me këta reporterë ndërkombëtarë, një pjesë ndryshuan dhe u kthyen në gazetarë raportues dhe kjo paraqitet në formë më të zgjeruar në pjesën e intervistave kualitative.

Gjithashtu, kjo mënyrë e raportimit është diçka që në tërësi karakterizon rrjedhën e ngjarjeve të transmetuara prej këtij kanali. Edhe në artikujt e tjerë kjo është fryma që mbizotëron raportimin për sa i përket Kosovës. Ndonëse shpeshtësia e lajmeve për Kosovën ra gradualisht pas mbarimit të konfliktit, e sidomos pas shpalljes së pavarësisë, shihet një vazhdim i njëtrajtshëm i mënyrës se si raportojnë për të. Pra, formati mbetet i njëjtë deri në marrjen e pavarësisë. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës kjo mënyrë raportimi ndryshoi dhe kaloi në një raportim më të drejtpërdrejtë, mesazhet subliminale ranë në mënyrë të ndjeshme, duke kaluar në asnjë mënyrë e gati edhe në kah të kundërt. I vetmi fakt që mund të ndikojë në këtë mënyrë perceptimi, është ai që ndërtimi i lajmit tashmë nuk është me një bashkëpunim midis

gazetarëve lokalë dhe atyre ndërkombëtarë, por vjen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga burimet zyrtare. Si i tillë, çdo lloj influence nga bashkëpunimi midis vendorëve dhe ndërkombëtarëve është gati mosekzistente dhe si i tillë bën që të mos ketë më atë perceptim që kishte më herët (De Franco, 2012).

Ndikimi i vendorëve duket gjithmonë e më shumë kur bëjmë krahasimin midis asaj çka ndodhi para, gjatë dhe pas luftës, si dhe periudhës kur u shpall Pavarësia e Kosovës. I vetmi faktor që ndryshoi në këtë periudhë është fakti se nuk pati më bashkëpunim në strukturimin e lajmeve midis gazetarëve ndërkombëtarë dhe atyre vendorë, sikurse gjatë periudhës së luftës, kur reporterët ndërkombëtarë në një farë mënyre kishin varësi nga ndihmësit vendorë. Ose më mirë le të themi se bashkëpunimi kalon në aspekt më profesional.

Është e vërtetuar se marrëdhëniet mes njerëzve janë më të afërta në kushte ekstreme sesa në kushte normale dhe ndikimi nga njëri-tjetri është më i madh në kushte ekstreme (Jarramillo, 2009). Kjo është një nga pikat që ka më së shumti debate në arenën ndërkombëtare.

Influencimi i medias në arenën ndërkombëtare është një pasojë e pavetëdijshme dhe e pakontrollueshme e evoluimit të saj dhe teknologjisë. Apo është një aspekt i evoluimit të manipulimit të opinionit në sajë të evoluimit teknologjik të këtyre viteve të fundit? Kjo është e vështirë që të ndahet. Është e vërtetë se evoluimi teknologjik ka sjellë një ndryshim të konsiderueshëm të mënyrës se si e perceptojmë realitetin, dhe pjesa më e madhe e kësaj është si pasojë e medias. Gjithashtu, sikurse është theksuar edhe tek pjesa teorike, kjo mënyrë e ndërveprimit midis medias dhe audiencës sjell një ndikim të ri në atë që transmetohet dhe perceptohet. Në shumicën e rasteve kjo bëhet në mënyrë të ndërgjegjshme nga ana e medias, pavarësisht se njësia bazë e këtij evoluimi vjen prej gazetarëve, më shumë se sa nga vetë institucioni, por kjo nuk e dobëson aspak impaktin që ka në audiencë (Robinson, 2005). Ndërveprimi në një rreth më të gjerë falë teknologjisë sjell një mundësi të re në atë çka është perceptimi që ndërton media kundrejt audiencës. Ky fakt bën që mënyrat e hershme të

perceptimit të medias të bien poshtë dhe të kalojmë në një perceptim tjetër. Në këtë rast CNN nuk është më thjesht një media që raporton luftën në një vend të largët, por ajo kthehet në një media që krijon dhe e nxit këtë luftë duke i dhënë kahun dhe mbështetjen që ajo e konsideron si të drejtë. Në këtë mënyrë, ajo nuk është më thjesht një raportuese e lajmit, por kthehet një faktor ndikues. Edhe pse grupet e interesit në këtë rast janë të huaja dhe ushtrojnë ndikimin e tyre në një mënyrë të tërthortë (De Franco, 2012), prapëseprapë ato e ushtrojnë këtë ndikim dhe bëjnë të mundur jo vetëm një ndërhyrje ushtarake në favor të palës influencuese, por edhe lindjen e një sovraniteti të ri, duke krijuar efektivisht një shtet të ri. Ajo që në shumicën e rasteve e anashkalojmë ose e shohim në mënyrë sipërfaqësore, është se sa të prirë janë njerëzit të bashkëpunojnë në rastet humanitare. Deduktimi i fakteve të nxjerra nga ky kërkim, më shtyn të arsyetoj se përdorimi i faktorit humanitar në raportimin e lajmeve e bën audiencën më të prekshme ndaj problemit. Kjo për shkak se në thelb të ndërgjegjes njerëzore është jeta në komunitet dhe empatia për njëri-tjetrin, kështu që si qenie njerëzore jemi më të prirë të reagojmë në rastet kur njerëz të tjerë të ngjashëm me ne persekutohen jashtë çdo lloj logjike, pa një bazë të arsyeshme, sesa kur ka një arsye logjike për atë që po ndodh. Dhe kjo bëhet më efektive në kushtet aktuale, kur zhvillimi teknologjik ka bërë të mundur një ndërveprim masiv midis medias dhe audiencës.

Rasti i Kosovës, si dhe shumë raste të tjera e vërtetojnë këtë. Denoncimet për gjenocid ndaj shqiptarëve në arenën ndërkombëtare fillojnë qysh në vitin 1920, me Edit Durham dhe librin “Brenga e Ballkanit”. Por në tërësinë e vet, përveç disa debateve të pakta në fushat elitare, ndikimi i saj në atë çka po ndodhte me shqiptarët e Kosovës ishte i papërfillshëm. Kjo situatë ndryshon krejtësisht në situatën aktuale, kur një televizion me mbulim botëror fillon dhe bën të njëjtin denoncim si në vitin 1920, por kësaj radhe ky denoncim përfundon në një luftë për ta mbrojtur këtë popullatë të pafajshme. Sipas këndvështrimit tim, kjo është një provë e qartë e mënyrës se si po ndikon teknologjia në fuqizimin e medias. Taktikat e manipulimit të opinionit kanë ekzistuar

gjithmonë dhe ato vetëm sa janë perfeksionuar gjithmonë e më shumë me kalimin e kohës, por ajo që bën dallimin në atë se si mediat kanë ndryshuar ndikimin e tyre, është zhvillimi teknologjik. Rritja e hapësirës së mbulimit dhe targetimi i një audience më të gjerë ka bërë që mediat të ndryshojnë në mënyrën se si influencojnë jo vetëm audiencën brenda për brenda shtetit të tyre, por edhe ato që shtrihen në një hapësirë më të madhe gjeografike, dhe në këtë mënyrë kanë bërë të mundur që impakti i tyre të jetë shumë më i madh. Është një dualitet që çon në bashkërendimin e politikave globale dhe influencimin e tyre. Duke qenë se diplomacia ndërkombëtare rregullohet nëpërmjet ligjeve të aprovuara nga organizata të përbashkëta ndërkombëtare, aftësia e ndikimit të CNN edhe në shtete të tjera të pavarura dhe jashtë influencës së kulturës amerikane, bën bashkërendimin e tyre dhe lind një politikë të re të jashtme që rezulton në ndërmarrjen e masave aktuale nga ana e organeve vendimmarrëse (De Franco, 2012). Kjo mënyrë ndërveprimi bën atë që quhet ‘CNN Effect’ në studimet më të fundit, dhe mund të thuhet se rasti i Kosovës është një efekt CNN në pjesën më të madhe të zhvillimeve të tij. Natyrisht, mbetet për t’u diskutuar nëse ky rast është një rast i programuar dhe zbatuar në këtë formë, apo është thjesht një efekt anësor i pjesës së raportimit dhe strukturës së gazetarisë? Kjo është një pyetje që është shumë e vështirë t’i jepet një përgjigje pa një analizim tjetër si ky këtu, por personalisht mendoj se është një pasojë e raportimit gazetaresk. Argumenti im në këtë aspekt është se mediat janë të prira të komunikojnë lajmet që tërheqin më së shumti audiencë dhe janë të prira të evidentojnë faktin humanitar në secilin prej tyre, ngjarjet që ndodhën në Kosovë ishin thjesht një pasojë e këtij raportimi.

5.2 Analizë e fotografive nga REUTERS²⁶

Titulli i albumit: *Lufta e Kosovës*

(data e publikimit, 17 shkurt 2009)

²⁶ Album me fotografi të pamjeve të ndryshme nga Lufta në Kosovë, me përshkrime të shkurtra nën to. Faqja elektronike e REUTERS: <http://www.Reuters.com/news/picture/the-kosovo-war?articleId=USRTXBQBD#OJ5dV4SVGK68Rg1T.97>, parë në prill 2015.

Edhe pse politikat editoriale të medias janë përgjithësisht të fokusuar në ruajtjen e asnjëanësisë dhe etikës profesionale, në rastin e Kosovës vihet re një devijim minimal nga këto parime. Reuters-i është një nga kanalet më interesante për t'u studiuar në rastin e situatës së Kosovës.

Artikulli i përzgjedhur për studim në këtë rast, kryesisht është i fokusuar tek refugjatët shqiptarë dhe mënyrat se si janë duke përjetuar dhe duke mbijetuar në rastin e një gjenocidi. E gjithë kjo bëhet nëpërmjet paraqitjes me foto dhe dedikimeve poshtë tyre. E theksoj këtë pikë, sepse sikurse u bë e ditur edhe më lart, politikat editoriale të Reuters-it janë të fokusuar kundrejt ruajtjes së paanësisë dhe etikës profesionale, ndërsa në përgjithësi është një kanal që shumicën e lajmeve ekskluzive, fillimisht i paraqet nëpërmjet fotografive ose pamjeve me një titull të shkurtër, ndërsa nuk referon më shumë. Në rastin e Kosovës, kemi artikuj të tërë që janë të fokusuar vetëm në pamje dhe tituj të shkurtër, pa kaluar në analiza të mëtejshme. Porë në një këndvështrim sipërfaqësor, duket sikur kjo nuk është një mënyrë që mund të lërë një mbresë të veçantë të audienca, por Reuters ka edhe një përparësi tjetër të cilën e përdor më së miri në këndin që dëshiron ky medium. Audienca qendrore e saj janë media dhe institucione të tjera mediatike. Kështu, duke pranuar se Reuters është në përgjithësi i pavarur dhe duke e cituar atë si një burim kryesor të paanshëm, mediat e tjera i japin atij më shumë fuqi nga sa mendojnë, ndaj është e mundur për Reuters-in të bëjë një manipulim të opinionit publik në mënyrë të tërthortë. Siç mund të shikohet nga pamjet e artikullit të përzgjedhur (bashkëngjitur te Shtojca), të gjitha fotografitë, ndonëse janë marrë në periudha të ndryshme kohore, paraqesin vetëm një pasqyrë dhe japin një mesazh, atë të viktimave që janë duke u masakruar pa shkak. Në njërin nga fotografitë²⁷ është vetëm ky përshkrim tekstual:

“Një burrë, zgjat dorën për të ndihmuar një fëmijë kosovar refugjat, të cilin e mban në krahë i ati, për të ngjitur një kodër në pikën kufitare të Bllacës”(REUTERS/Yannis Behrakis, datë 31 Mars 1999).

²⁷ Fotografia numër 20, e datës 31 Mars 1999, realizuar nga Yannis Behrakis. Faqja elektronike e REUTERS: <http://www.Reuters.com/news/picture/the-kosovo-war?articleId=USRTXBQBD#OJ5dV4SVGK68Rg1T.97>, parë në prill 2015.

Në linja të ngjashme vijojnë të gjitha fotografitë e tjera. Në tërësi tema e tyre dhe mënyra e përshkrimit japin vetëm një rezultat. Një mesazh të drejtpërdrejtë pa një informatë kthyesë. Sikurse është një fakt i pranuar tashmë, arsyeja pse televizioni cilësohet si media më e fuqishme është për faktin që nuk i jep audiencës mundësinë e informatës kthyesë. Reuters-i e çon këtë mundësi në një shkallë më të lartë. E përdor si mjet manipulimi kundrejt vetë mediave, duke ruajtur njëkohësisht paraqitjen e paanësisë dhe profesionalizmit. Aktualisht, nuk mund të thuhet se është duke e bërë këtë manipulim për arsye se i gjithë materiali i botuar është transparent, i pasqyruar nëpërmjet pamjeve fotografike nga terreni, por nga ana tjetër realisht kemi një manipulim të dyfishtë, pasi duke përçuar një mesazh bindës për mediat, ky institucion mediatik është duke i përdorur ato për të pasqyruar një realitet sipas politikave të tij.

Në përgjithësi, Reuters-i nuk e përdor këtë fuqi të tij në shumicën e mediave. Kryesisht, kjo lloj fuqie përdoret në raste ekstreme ku elementi thelbësor është elementi humanitar, por nuk mund të anashkalohet në formën e përgjithshme të mediave, pasi në të vërtetë luan një rol shumë të madh në mënyrën se si shpërndahen lajme të shumta. Duke qenë se shumica e lajmeve të këtij mediumi janë pamje me një përshkrim të shkurtër, analizimi i tyre bëhet nga vetë gazetarët e mediave të tjera, të cilët në shumicën e lajmeve nuk kanë burime të tjera përveçse fotografive dhe përshkrimit të Reuters-it, prandaj dhe si të tillë, shpeshherë bëhen thjesht përçues të lajmeve të botuara nga ky institucion.

Interesant është edhe fakti se në përgjithësi Reuters-i këtë lloj ndikimi nuk e përdor në vende të vogla apo me një interes të largët për audiencën botërore, por në rastin e Kosovës, ky është përjashtimi i dytë që bën ky institucion, duke e vënë në qendër të vëmendjes dhe duke ndikuar, gjë që në përgjithësi e bën për vende me një interes të veçantë në arenën ndërkombëtare.

5.3 Analizë e artikullit nga BBC

Titulli i artikullit: *Realiteti i ftohtë pas tre viteve të pavarësisë së Kosovës.*²⁸

Para se të kaloj te pjesa e analizës së këtij artikulli, do të doja të vija në dukje se BBC ka qenë ndër mediat e para që ka filluar raportimet rreth krizës në Kosovë, dhe gjithashtu ka qenë nga ato që kanë sjellë më shumë ndikim në arenën ndërkombëtare. Pamjet e para të publikuara botërisht janë bërë nga ana e BBC, pavarësisht se për Masakrën e Reçakut citonte Reuters-in.

Gjithashtu, interesant për këtë medium është fakti se ka aftësinë që të gjitha ngjarjet që mund ta nxjerrin Kosovën në një sfond negativ, arrin t'u japë një 'spin off' dhe të raportojë atë që është realiteti dhe gjithmonë në dobi të Kosovës. Për vetë natyrën që ka, kur raporton për një vend, BBC nuk përfshin vetëm të tashmen, por edhe të shkuarën. Artikulli i përzgjedhur përcjell situatën në Kosovë dhe sfidat që e presin. I gjithë artikulli dhe mënyra se si ai përmbledhet, mund të përmbledhet nga fjalët e përdorura për të mbyllur artikullin "*Tre vjet më pas, Kosova ndoshta shfaqet më rrallë në titujt ndërkombëtarë, por historia nuk ka përfunduar...*"²⁹ Dhe realisht i gjithë artikulli është një mënyrë e balancuar për të mbrojtur Kosovën nga akuzat për trafik njerëzor që janë bërë në atë kohë nga raporti i Dik Martit.

Duke e hapur artikullin me kremtimin e Kosovës për pavarësi dhe nga ana tjetër duke e vënë përballë djegies së Ambasadës së SHBA-ve në Serbi, jepet një divergjencë mes dy vendeve dhe lihet të nënkuptohet se konflikti vazhdon ende, ndonëse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë. Gjithashtu, duke e fokusuar vëmendjen e njerëzve te pjesa problematike e një vendi në zhvillim, nxit vëmendjen e audiencës te Kosova si viktimë, se sa te Kosova si vatër e krimit të organizuar. Nëse rikthehemi pas në histori, sidomos gjatë periudhës '98-'99, ngjarjet e Kosovës përbënin lajmet dhe artikujt kryesorë në këtë medium. Por edhe në vijim, Kosova është trajtuar vazhdimisht me ngjarjet që rridhnin ndër vite, duke e vënë atë tek seksioni i Evropës.

²⁸ Faqja zyrtare elektronike e BBC: <http://www.bbc.com/news/world-europe-12492187>, data e publikimit 17 shkurt 2011, parë në shkurt 2015.

²⁹ Faqja zyrtare elektronike e BBC: <http://www.bbc.com/news/world-europe-12492187>, parë në shkurt 2015.

Ndikimi i BBC dhe qasja e saj ndaj Kosovës mund të vihet re qartë edhe pas periudhës në studim. Edhe pas kaq vitesh nga periudha në studim, kur tashmë Kosova është shtet i pavarur, sfondin historik të shkurtër të Kosovës BBC e paraqet si një vend me popullsi kryesisht shqiptare, të cilës Serbia iu përgjigj me një sulm brutal.³⁰ Ndërsa, ndërhyrjen e NATO-s e cilëson si rrjedhojë e refuzimit të një marrëveshje të ndërmjetësuar ndërkombëtarisht për t'i dhënë fund krizës dhe përndjekjes së shqiptarëve të Kosovës, nga Slobodan Millosheviqi, gjë që çoi në sulmet ajrore të NATO-s kundër bazave në Kosovë dhe Serbi në mars 1999.³¹

Luftën e Kosovës, BBC e cilëson si një fushatë të spastrimit etnik kundër shqiptarëve të Kosovës nisur nga autoritetet serbe, nga e cila bëri që qindra mijëra refugjatë të ikën në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi dhe më tej, ndërkohë që mijëra të tjerë vdiqën në konflikt, derisa forcat serbe u dëbuan në verën e vitit 1999 dhe OKB mori përsipër administrimin e krahinës.³²

Duke marrë parasysh raportimin për Kosovën, me theks të veçantë periudhën e luftës dhe shkakun që e solli, mund të arrijmë në përfundimin se BBC e cilëson vitin 1998 si vit kur Slobodan Millosheviqi solli luftën civile në Kosovë, që rezultoi me mijëra civilë të vrarë nga serbët.

5.4 Precedentët ndërkombëtarë të krijuar nga CNN, BBC, REUTERS

Për të pasur një ndikim të llojit 'Efekti CNN', kërkesat nga të dy palët janë të domosdoshme (nga media dhe qeveria). Në rastin e mediave, janë tre faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në shfaqjen e *efektit CNN*. E para është qasja në territorin ku imazhet duhet të kapen, siç dëshmohet nga rastet studimore të Irakut jugor dhe Sudanit, ku në mungesë të imazheve ka munguar edhe *efekti CNN* dhe çështja e aksesit të drejtpërdrejtë në territorin ku zhvillohet kriza, paraqet një rol të rëndësishëm në ndikimin e politikës për të vlerësuar se çfarë është lajm i rëndësishëm (Bahador, 2007).

³⁰ Faqja elektronike zyrtare e BBC: <http://www.bbc.com/news/world-europe-18328859>, parë më 25 korrik 2015.

³¹ Faqja elektronike zyrtare e BBC: <http://www.bbc.com/news/world-europe-18328859>, parë më 25 korrik 2015.

³² Faqja elektronike zyrtare e BBC: <http://www.bbc.com/news/world-europe-18328859>, parë më 25 korrik 2015.

Kërkesa e dytë për të pasur një *efekt CNN* në media, janë imazhet e papritura dhe emocionale të ngjarjeve nga territori i krizës, të paraqitura nga mbulimi mediatik.

Variabli i tretë i medias, i konsideruar thelbësor për të pasur një *efekt CNN*, është pozicioni që sfidon politikën zyrtare, duke e bërë atë të duket e gabuar në qasje ose e paefektshme. Pozicionimi i tillë, në kontekstin e një ndërhyrjeje të mundshme, në favor të një pale të caktuar, arrihet duke paraqitur viktimat të pafajshme në nevojë për ndihmë nga jashtë. Sipas autorit Bahador, imazhet e viktimave janë ndër mjetet më të fuqishme për t'i dhënë një kornizë ngjarjeve, pasi ato ofrojnë interes njerëzor, dramë, si dhe mësimet morale për atë çfarë konsiderohet e mirë dhe atë çka është negative (Bahador, 2007).

Konflikti i Kosovës u bë i njohur dhe u raportua nga mediat ndërkombëtare qysh në mars të vitit 1998, kur në fshatin Prekaz të Drenicës, u vranë dhe u masakruan nga forcat serbe mbi 50 anëtarë të familjes Jashari. Pavarësisht se mediat ndërkombëtare citonin edhe burimet zyrtare serbe, të cilat këtë veprim e konsideronin si një “një aksion normal policor kundër një kriminelit të njohur”, sikurse citon BBC gjeneralin serb Nebojsa Pavković³³, sërisht kjo ngjarje do të komentohej nga korrespondentët ndërkombëtarë si një aksion i dhunshëm i forcave serbe ndaj popullatës etnike shqiptare.³⁴ Kjo masakër u bë e rëndësishme për dy arsye. Së pari, ajo bëri të njohur ndërkombëtarisht rezistencën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si një lëvizje që kërkonte pavarësinë e Kosovës, duke tërhequr mijëra mbështetës dhe rekrutë të tjerë dhe së dyti, kjo ngjarje përmes imazheve tërhoqi vëmendjen e qeverive perëndimore. Konflikti i Kosovës u konsiderua si një shembull ku ndikimi CNN ‘lëvizi’ qeveritë perëndimore drejt ndërhyrjes ushtarake (Bahador, 2007).

Lidhur me objektivat dhe rolin e NATO-s në konfliktin e Kosovës, në vijim paraqiten disa nga faktet që çuan në ndërhyrje ushtarake për t'i dhënë fund krizës së Kosovës.

³³ Linku online: <http://koha.net/?id=27&l=101768>

³⁴ Linku online: <http://www.bbc.com/news/magazine-30483010>, parë në dhjetor 2015.

Ndërmjet marsit të vitit 1998 dhe marsit 1999, para se vendet anëtare të NATO-s të merrnin vendim për ndërhyrje ushtarake, mbi 2 mijë shqiptarë u vranë si rrjedhojë e politikës serbe ndaj Kosovës³⁵. U raportua se gjatë verës së vitit 1998, një e katërta e një milion shqiptarëve të Kosovës u dëbuan nga shtëpitë e tyre, ndërsa pronat e tyre, fshatrat dhe të mbjellat e tyre u shkatërruan.

Në janar të vitit 1999, një ekip humanitar i Kombeve të Bashkuara siguroi prova për masakrimin e mbi 40 personave në fshatin Reçak. Në fillim të prillit të po këtij viti, Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë vlerësoi se fushata e spastrimit etnik rezultoi në 226,000 refugjatë drejt vendeve fqinje.³⁶

Është vlerësuar se deri në fund të muajit maj 1999, rreth 90% e popullsisë së Kosovës u dëbuan nga shtëpitë e tyre, nga të cilët disa mbeten të pastrehë, disa të zhdukur, ndërsa të paktën 5000 kosovarë u ekzekutuan.³⁷ Pra, edhe vendimi për ndërhyrje ushtarake erdhi pas gjithë raportimeve dhe fakteve të paraqitura me viktimat e luftës.

Masakrat në Drenicë

Elementët e parë të paraqitjes së masakrave në mediat ndërkombëtare datojnë qysh në vitin 1998, pavarësisht se në atë periudhë cilësoheshin si vrasje masive, apo si luftime ndërmjet grupit të ashtuquajtur gueril (i referohet UÇK-së) dhe forcave policore serbe. Konkretisht, në fund të muajit shkurt dhe në fillim të muajit mars 1998, forcat paramilitare serbe vranë 24 persona, në mesin e të cilëve 10 prej tyre ishin të familjes Ahmeti (Bahador, 2007). Pavarësisht se nga perspektiva serbe ky u konsiderua si një veprim i paqëllimshëm, por që ndodhi si pasojë e vetëmbrojtjes dhe zbatimit të ligjit antiterror, sërisht mediat ndërkombëtare e cilësuan si vrasje me motive etnike. Ndërsa në sulmin e dytë në fshatin Prekaz, i cili filloi më 5 mars dhe zgjati për dy ditë, mbi 50 anëtarë të familjes Jashari mbetën të vrarë, përfshirë gra dhe fëmijë të moshave të ndryshme. Kreu i kësaj familjeje, Adem Jashari, ishte një nga themeluesit e UÇK-

³⁵ Cituar nga faqja elektronike e NATO-s: <http://www.nato.int/kosovo/history.htm>

³⁶ Cituar nga faqja elektronike e NATO-s: <http://www.nato.int/kosovo/history.htm>

³⁷ Cituar nga faqja elektronike e NATO-s: <http://www.nato.int/kosovo/history.htm>

së dhe ka qenë objektiv i arrestimit të policisë serbe për vite me radhë (Bahador, 2007). Në mungesë të informacioneve konkrete nga vendi i ngjarjes, meqë serbët bënë përpjekje për të ndaluar qasjen e gazetarëve në zonën e Drenicës, duke vendosur postblloqe në rrugë, informacioni u ndërtua fillimisht nga dëshmitarë okularë që u larguan nga zona. Por më 8 mars të po këtij viti, gazetarëve perëndimorë iu lejua hyrja në këtë zonë nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë, me pretendimet për ta paraqitur ngjarjen si një fitore kundrejt ‘terroristëve të Drenicës’ (Bahador, 2007). Megjithatë, kjo shkaktoi efektin e kundërt, meqë gazetarët perëndimorë u fokusuan te shtëpitë e shkatërruara dhe te fshatarët e tmerruar. Në të vërtetë, imazhet më të tmerrshme në mediat ndërkombëtare erdhën nga gazetarët, të cilët u shoqëruan nga fshatarët që kërkonin dhe identifikonin trupat e të afërmeve të tyre të vrarë. Këto imazhe të kufomave u shfaqën në internet dhe tërhoqën vëmendjen e politikës ndërkombëtare duke u parë si një fillim drejt një lufte dhe katastrofe humanitare, e cila do të vërtetohej me shfaqjen e dy masakrave tjera, ajo në fshatin Obri e Epërme dhe Reçak.

Në tetor të vitit 1998, BBC raportoi se 18 trupat e pajetë të shqiptarëve etnikë janë gjetur në fshatin Obri e Epërme dhe 14 të tjerë u gjetën në Vushtrri.³⁸

Masakra në Reçak

"Kjo ishte një ngjarje e tmerrshme" (David Loyn, korrespondenti i BBC për çështje botërore).³⁹

Reçaku mbetet një ndër ato vende ku edhe sot ndjehet i freskët kujtimi i tmerrit të vitit 1999. Masakra e Reçakut ishte ndër faktorët kryesorë që shtyu NATO-n të marrë vendim mbi përdorimin e sulmeve kundër ish-Jugosllavisë, për të ndaluar gjenocidin ndaj popullatës shqiptare të Kosovës.

Më 15 janar të vitit 1999, mbi 45 shqiptarë mbeten të vrarë dhe të masakruar në mënyra nga më mizoret. Të masakruarit ishin civilë, në mesin e tyre kishte edhe gra e fëmijë.

³⁸ Artikulli i publikuar më 1 tetor 1998, me titull ‘*Serbs attack Kosovo massacre reports*’, linku online: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/184248.stm>, parë në dhjetor 2015

³⁹ Artikulli i publikuar më 19 janar 1999, me titull “*Massacre in Kosovo*”, linku online: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/256364.stm>, parë në dhjetor 2015

BBC e raportoi këtë ngjarje me titull kryesor duke e cilësuar si “Masakër në Kosovë”, ndërsa në fillim fare ka një fotografi të trupave të pajetë të masakruar dhe të hedhur në një gropë (artikulli i plotë tek shtojcat).

Përveç artikujve mbi vrasjet masive, kryetitujt e raportimeve speciale në fokus kishin edhe refugjatët. Një artikull i BBC, i publikuar më 22 mars 1999⁴⁰, me titull ‘*Where did all Kosovars go?*’, thekson numrin në rritje të refugjatëve kosovarë në drejtim të vendeve fqinje. Në hyrje të artikullit theksohet se ‘eksodi i shqiptarëve etnikë nga Kosova po vazhdon’, ndërsa më pas shpjegon kushtet e rënda në kampe të refugjatëve. Duke cituar si burim informacioni UNHCR-në, artikulli në hyrje përmban një hartë me shifra të refugjatëve që kanë kaluar në Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi dhe në vende tjera fqinje. Artikulli paralajmëron se vetëm brenda muajit mars të vitit 1999 është rritur numri i refugjatëve në 20 mijë, dhe se kjo po ndodh si pasojë e spastrimit etnik që po bën pala serbe. Dy fotografi të bashkëngjitura në këtë artikull tregojnë refugjatët; njëra paraqet një refugjate me parullën “Stop the ethnic cleansing!”, ndërsa fotografia tjetër paraqet një refugjate duke qarë, teksa përshkrimi nën foto është ‘Thousands of Kosovars have lost ones’. Ndërsa, duke cituar zëdhënësin e UNHCR-së (të asaj kohe), Lyndall Sachs, artikulli thekson se shqiptarët trajtohen si qytetarë të klasës së dytë.

Në fund fare, artikulli thekson se ushtria jugosllave po akuzohet për abuzim me të drejta të njeriut në Kosovë, duke përmbyllur artikullin me theksin e vënë tek numri i refugjatëve mbi 45 mijë, vetëm brenda 6 javëve të para të vitit 1999 (BBC, 1998).

E veçanta e raportimeve të periudhës 1998- 1999 është se edhe kur burimet e informacionit ishin zyrtare, gjithmonë fokusi vihet te viktimat si palë e prekur e krizës. Edhe kur u referohen burimeve zyrtare, raportohet me formulime gjuhësore të tilla duke i cilësuar ngjarjet si katastrofë humanitare, spastrim etnik, eksod, krime lufte, dhe duke akuzuar për këto presidentin e atëhershëm jugosllav Slobodan Millosheviq.

⁴⁰ Faqja elektronike zyrtare e BBC: http://news.bbc.co.uk/2/hi/special_report/1998/kosovo/183552.stm, parë në dhjetor 2015

Si përfundim, ishin pikërisht precedentët ndërkombëtarë të krijuar nga mediat që nxitën politikën ndërkombëtare për ndërhyrje ushtarake në Kosovë. Si rrjedhojë, gradualisht do të ndryshojë edhe statusi i Kosovës në arenën ndërkombëtare, duke filluar shtetndërtimin, e përmbyllur me shpalljen e Pavarësisë në shkurt të vitit 2008, kur Kosova u bë shtet i pavarur dhe sovran, i njohur ndërkombëtarisht. Pavarësisht problemeve të mosnjohjes nga disa vende anëtare të OKB-së dhe të BE-së, sërish përmbyllja e Pavarësisë së Mbikqyrur nga Përfaqësuesi Special, në vitin 2011, e la Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran.

KAPITULLI VI: ANALIZË E INTERVISTAVE KUALITATIVE

6.1 Intervistat cilësore

Në pasqyrimin e realitetit në Kosovë rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe mediat vendore, të cilat ishin edhe pikë referimi e korrespondentëve ndërkombëtarë. Kryesisht, mediat ndërkombëtare kanë ardhur në Kosovë pasi kishin mbuluar një luftë në një vend tjetër të Ballkanit, që ishte lufta në Bosnje.

Se çfarë po ndodhte në Kosovë dhe se kush ishte fajtori, një pjesë e tyre mund ta kishin të qartë, sepse kishin parë gjenocidin në Bosnje dhe kishin tashmë njohuri se si do të mund të manifestohej lufta në Kosovë. Ndërsa një pjesë e korrespondentëve ndërkombëtarë kishin ardhur nga përfaqësitë e mediave në Beograd apo kishin mbuluar ngjarjet e Kosovës duke cituar mediumet serbe, që kishin një këndvështrim tërësisht të ndryshëm nga pala e parë. Pra, ishte një përplasje këndvështrimesh, në mungesë informacioni nga vendngjarja.

Arsyeja pse janë intervistuar gazetarë të rinj vendorë që kanë qenë pjesë e ngjarjeve të Kosovës që janë dhe objekt studimi, është për shkak të veçantisë së tyre, sepse këta misionarë të rinj arritën të dëshmojnë të vërtetën për vendin dhe të mbizotërojnë këndvështrimin e palës së parë të përshkruar më lart.

Meqë në paraqitjen e ngjarjeve në Kosovë kishte prani edhe të mediave të tjera ndërkombëtare, nga këto tre të marra në studim, pikërisht për të paraqitur larminë, janë intervistuar gazetarë që kanë mbuluar ngjarjet e Kosovës nga media me emër dhe ndikim ndërkombëtar në sferën diplomatike.

Tabela në vijim të këtij kapitulli (tek shtojca) paraqet të dhënat mbi personat e intervistuar të cilët kanë luajtur rol në pasqyrimin e ngjarjeve në Kosovë, jo vetëm gjatë periudhës së luftës, por edhe pas, deri në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008.

Natyrisht që rol të rëndësishëm në pasqyrimin e realitetit që po ndodhte në Kosovë kanë luajtur edhe mediat vendore të asaj kohe, që ishin në rolin e ‘ambasadorit’ të Kosovës në sferën ndërkombëtare dhe pikë kontakti jo vetëm i gazetarëve ndërkombëtarë, por edhe i diplomatëve dhe personaliteteve ndërkombëtare që ishin të interesuar për atë çka po ndodhte në Kosovë.

Rrëfimet ishin të ndryshme për Kosovën, kryesisht nga pala serbe, e cila përmes propagandës mediatike që përdorte, krijonte hamendje në rrëfimin e ngjarjes për atë çka po ndodhte në Kosovë. Si rrjedhojë, varësisht akuzave që qarkullonin për vrasje selektive dhe vrasje të civilëve, reagimet nga kryeqytetet perëndimore nuk ishin aq të ashpra sa do të bëheshin më vonë, me pasqyrimin e masakrave, gjenocidit dhe dëbimit të popullatës civile nga shtëpitë e tyre. Ishin pikërisht precedentët ndërkombëtarë të krijuar nga mediat, që nxitën bashkësinë ndërkombëtare për ta diskutuar në format tjetër rastin e Kosovës.

Sulmi dhe masakra ndaj familjeve Ahmeti dhe Sejdiu në fshatrat Likoshan dhe Qirez të Drenicës, dhe pak ditë më vonë ngjarja tronditëse e datës 5 mars 1998 ndaj familjes Jashari, ishin precedentët kryesorë që ngjallën zemërim të thellë në kryeqytetet perëndimore, duke mos e quajtur më konfliktin e Kosovës si çështje të brendshme.

Arsyeja e përzgjedhjes së këtyre intervistave argumentohet në vijim. Së pari, intervistat janë ato që pasqyrojnë më së shumti rolin që kanë luajtur gazetarët vendorë në rrjedhën e ngjarjeve të asaj periudhe. Së dyti, është e rëndësishme të qartësoj se pavarësisht se lajmet janë raportuar nga gazetarë ndërkombëtarë, kanë qenë pikërisht këta gazetarë të intervistuar që kanë dhënë informacionin e pastër nga terreni, në një mënyrë apo një tjetër, dhe si të tillë mund të thuhet se situata që është raportuar në mediat ndërkombëtare ka ardhur prej tyre dhe jo prej burimeve të tjera të atëhershme. Këta gazetarë nuk kanë raportuar vetëm për një media, por për disa prej tyre dhe si të tillë, kanë pasur një rol të konsiderueshëm në atë se si është përçuar informacioni, çfarë kahe i kanë dhënë dhe se si e kanë interpretuar në përputhje me normat gazetareske. Kur flasim për raportim nuk mund

të marrim parasysh vetëm burimin e publikuar në media, por edhe dhënësin primar të informacionit, dhe në rastin e krizës së Kosovës ky informacion ka ardhur nga gazetarë dhe përkthyes vendorë, pasi gjuha dhe burimet e tjera zyrtare të cilat mungojnë në rastin e luftërave bënë të mundur që të kontrollohej deri diku informacioni dhe të transmetohej nga individë të cilët gjendeshin në të njëjtin rrafsh emocional në ngjarjet që po zhvilloheshin, qoftë për shkak të eksperiencës vetjake që kishin nga këto ngjarje, qoftë për shkak të faktit se ishin dëshmitarë të drejtpërdrejtë të këtyre ngjarjeve. Gjithashtu, këta gazetarë, por edhe të tjerë vendorë, të cilët për arsye të ndryshme nuk kam arritur t'i përfshij në intervista, raportonin për mediat kryesore që janë marrë në studim, BBC, REUTERS dhe të tjera.

Gazetarët e përzgjedhur kryesisht e kanë filluar karrierën e tyre si përkthyes, apo siç njiheshin edhe me termin “fikser” (në kuptimin e producentit vendor) dhe pas bashkëpunimit të ngushtë me gazetarët ndërkombëtarë një pjesë e tyre kanë vazhduar të punojnë si gazetarë në mediume të tjera ndërkombëtare, ku vazhdojnë të jenë pjesë e tyre edhe sot, apo kanë vazhduar punën në ndonjërin nga këto tri mediume të sipërpërmendura duke kaluar në statusin e gazetarit raportues, në periudhën e mëvonshme nga periudha në studim.

Gjithashtu, mos të harrojmë edhe faktin se po flasim për gazetarë me përvojë dhe etikë profesionale (gazetarët ndërkombëtarë), që profesionalisht ishin të detyruar të pasqyrojnë realitetin për të dy palët e konfliktit. Por duke qenë se pala serbe kishte organe zyrtare që raportonin lidhur me atë çka po ndodhte (televizioni publik serb ishte një prej tyre), ndërsa pala shqiptare kishte një medium modest (Koha Ditore) dhe disa media tjera të shkruara, por me pak mundësi ndikimi në sferën ndërkombëtare, atëherë fokusi i marrjes së informacionit u bë terreni dhe pasqyrimi i ngjarjeve nëpërmjet intervistave të drejtpërdrejta me refugjatët dhe të mbijetuarit. Në këtë mënyrë, këta përkthyes marrin një rol të veçantë në raportim, pasi është fakt që gjuha shqipe nuk është një nga gjuhët më të folura në botë, nëse përjashtojmë anëtarët me etnitet shqiptar, të cilët e kanë gjuhë primare. Pra, në këto kushte, informacioni merr trajta

propagandistike, pasi vjen nga persona kryesisht pa përvojë në profesionin e gazetarit, pavarësisht se kjo është një e dhënë që korrigjohet në periudhën e mëvonshme.

Në periudhën e parë, mund të themi se raportuesit e drejtpërdrejtë të lajmit janë përkthyes shqiptarë të cilët shoqëronin gazetarët ndërkombëtarë në terren, ndërsa në periudhën e mëvonshme janë po këta përkthyes që kalojnë në rolin e gazetarit me eksperiencë.

Por, ajo që dua të theksoj është fakti se këta gazetarë të përzgjedhur pasqyrojnë më së miri situatën, se si dhe kush ishte burimi i parë i informacionit për gazetarët ndërkombëtarë. Natyrisht, ka edhe gazetarë të tjerë që kanë mbuluar ngjarjet e Kosovës në periudhën në studim, të cilët mbase me intervista do ta pasuronin edhe më tej këtë punim, por këta janë ata që kanë qenë më të spikatur në atë periudhë dhe që vazhdojnë ta ushtrojnë rolin e gazetarit edhe sot e kësaj dite.

Në pjesën e shtojcave, në aneksin me numër rendor 2 (Tabela 22), janë listuar të intervistuarit, profesioni i tyre në të kaluarën dhe profesioni aktual në media, datat kur janë intervistuar, lloji i raportimit, si dhe periudha kur kanë mbuluar ngjarjet për Kosovën. Seksioni i fundit në tabelë për llojin e raportimit është i ndarë në tri pjesë, që pasqyron nëse raportimi ishte me tematikë për masakra, refugjatë apo të tjera (këtu përfshihen të gjitha ngjarjet tjera politike, ekonomike apo sociale për Kosovën).

Gjithashtu, duhet saktësuar se si janë strukturuar pyetjet në intervistë. Duke qenë se duhen evidentuar fakte që përfshijnë jo vetëm periudhën gjatë krizës, por edhe atë para dhe pas, edhe intervistat janë ndarë në tre periudha historike, të cilat janë parashtruar në vijim. Është bërë kjo ndarje për të dhënë një pasqyrë sa më të qartë të situatës dhe për të parashtruar në mënyrë më efektive të dhënat e mbledhura gjatë këtyre intervistave. Njëkohësisht, ka qenë e domosdoshme që të bëhej kjo ndarje për të pasqyruar edhe evoluimin e këtyre gazetarëve, të cilët e fillojnë raportimin si përkthyes dhe më vonë kalojnë në rolin e profesionistëve. Kjo ka një rëndësi të veçantë për studimin, sepse është pikërisht mënyra e evoluimit të këtyre

individëve dhe mënyra e evoluimit të raportimit të informacionit prej tyre që ka sjellë ndikimin në atë se si është perceptuar Kosova në arenën ndërkombëtare. Sigurisht që ndikim kanë patur mediat ndërkombëtare, të cilat ushtrojnë ndikim të madh edhe sot e kësaj dite në arenën diplomatike apo në politikat e jashtme ndërkombëtare (Robinson, 2005), por informacioni që përbën edhe bazën e ndërtimit të lajmit, ka ardhur nga individë që i përkisnin vendit që ishte në konflikt. Prandaj, kjo ndarje është e domosdoshme për të dhënë një pasqyrë të qartë jo vetëm se si evoluon situata, por edhe se si ndikojnë burimet e informacionit në ndërtimin dhe pasqyrimin e kësaj situatë. Fakti që në shumicën e shkrimeve kur raportohet lajmi, popullata e Kosovës identifikohet si shqiptare, por në pjesët kyçe të artikujve, siç është titulli, identifikohet si popullata kosovare, përbën një nocion që mund të ketë ardhur vetëm si pasojë e raportimit të burimit të parë, të cilët ishin përkthyesit dhe gazetarët vendorë.

Gjatë intervistave është bërë përpjekje të sigurohet informacion për tri periudha të ndara si në vijim:

- a. Viti 1998 – periudha e fillimit të luftës në Kosovë (deri në vendimin e NATO-s për ndërhyrje humanitare).
- b. Periudha gjatë luftës në Kosovë (përfshirë periudhën gjatë bombardimeve të NATO-s).
- c. Periudha pas përfundimit të luftës në Kosovë, deri në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008.

Pyetësi është i ndarë sipas tematikave të përshkruara në vijim, e që mbulojnë tri situatat e përshkruara më lartë:

1. Përvoja e luftës në Kosovë (1998-1999).
2. Situata gjatë luftës në Kosovë (deri tek vendimi i OKB për ndërhyrje ushtarake të NATO-s).
3. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë (periudha gjatë bombardimeve).
4. Fillimi i jetës së re në Kosovë, rikthimi i refugjatëve.
5. Periudha para, gjatë dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Viti 1998 – periudha e fillimit të luftës në Kosovë

Dëbimi me dhunë i shqiptarëve që rezultoi me numër të madh refugjatësh, ka bërë që disa djem e vajza të reja, të marrin misionin e gazetarit për t'i treguar botës atë çka po ndodhte në Kosovë. Ata ishin qytetarë të thjeshtë, që ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre apo ishin detyruar të lënë shtëpitë e tyre duke marrë rrugën drejt Maqedonisë dhe Shqipërisë. Disa prej tyre aty kanë pasur rastin të intervistohen në cilësinë e dëshmitarëve nga mediumet ndërkombëtare. Duke qenë të rinj, njohës të mirë të gjuhës angleze, fillimisht një pjese prej tyre iu është propozuar vendi i punës si përkthyes, për t'i angazhuar pastaj edhe në rolin e producentit vendor, apo siç quheshin me termin 'fiksler'.

Nga intervistat është vërejtur se raportimi dhe faktimi i të dhënave gjatë periudhës së luftës ka qenë shumë i vështirë për disa arsye. Fillimisht, mbulimi i ngjarjeve brenda territorit të Kosovës ka qenë i vështirë për shkak të disa faktorëve, si rrezikshmëria e lartë, mungesa e lëvizjes së lirë, barrikadat në rrugë, mungesa e informimit nga vendi i ngjarjes, mungesa e burimeve, dezinformatat e shumta, mungesa e lirisë për të ushtruar rolin e gazetarit, mungesa e përvojës së punës në këtë fushë dhe faktorë të tjerë. Sfidë për gazetarët ishin qëndrimet nga të dyja palët e përfshira në konflikt, sepse gazetarët shikoheshin si të dyshimtë. Precedentët që kthyen kokën e bashkësisë ndërkombëtare nga ngjarjet në Kosovë ishin pikërisht katër masakrat që u bënë në fshatrat Likoshan, Qirez, Prekaz dhe Reçak.

“Ngjarjet e Reçakut, Prekazit, Obrisë, Qirezit dhe Likoshanit – ishin përballja e parë me pasojat e luftës, pasojat civile që zgjuan interesim të madh tek bashkësia ndërkombëtare. Pastaj u publikua zona e Dukagjinit me fshatra përtej Gllogjanit, që ishin krejt të rrënuara.”
(Garentina Kraja, Koha Ditore)

Henry Vaughan Lockhart Smith ishte i pari fotoreporter dhe kameraman nga BBC, që në vitin 1998, arriti të depërtojë në një kodër në fshatin Prekaz, nga ku filmoi artilerinë e rëndë të forcave serbe, tanket dhe granatat në këtë fshat. Gjatë xhirimit ai u qëllua me snajper, por

plumbi depërtoi në çantën e tij ku kishte pasur një grumbull parash dhe një celular, ku dhe ngeci. Kjo ishte ndër ngjarjet e luftës që bëri bujë atë kohë në mediat ndërkombëtare.⁴¹

“Para bombardimeve s’ka pasur informata të mjaftueshme. Lajmet ishin të bazuara më shumë në të përfolurat në publik mes njerëzve. Gjatë bombardimeve jemi informuar nga të dhënat e dëshmitarëve që kanë përjetuar ngjarjet” (Avni Ahmetaj, Sky News).

Jeta Xharra tregon se si një vajzë e moshës 19 vjeçare, pa përvojë të mirëfilltë në gazetari, pavarësisht gjendjes së luftës në vend, kishte marrë guximin të ndihmojë në paraqitjen e realitetit që po ndodhte në Kosovë, duke u paraqitur vullnetarisht për të punuar në BBC, sapo kishte dëgjuar se ky medium ishte në kërkim të personelit vendor që njohin gjuhën angleze. Ajo në këtë mënyrë ka fituar punën si ‘fiksere’.

“Mënyra se si kemi marrë informacionet është se kemi shkuar aty ku kemi parë tym. Në këtë mënyrë jemi orientuar, nuk kemi pasur informacione të tjera. Ndërsa korrespondentët ndërkombëtarë që kanë raportuar për luftën në Kosovë kanë qenë kryesisht korrespondentët që kanë mbuluar luftën në Sarajevë dhe kanë ardhur me përshtypjen se në Kosovë po bëhej ‘luftë religjioze’. Në fillim kur i bënin lajmet për Kosovën, dëlnin me kamera para xhamive, duke menduar se ka të bëjë me konflikt religjioz.” (Jeta Xharra, BBC)

Jeta Xharra ka qenë e angazhuar me punë për një periudhë të shkurtër kohore edhe për agjencinë japoneze të lajmeve KYODO, për NBC dhe Chanel 4, deri kur është paraqitur vullnetare për të punuar për BBC-në. Ajo rrëfen për eksperiencën e saj dhe mënyrën e paraqitjes së lajmeve për Kosovën me t’u angazhuar në këtë medium gjatë kohës së luftës.

“Kam qenë si përgjegjëse për kontaktet me UÇK-në.” (Jeta Xharra, BBC)

Ajo përshkruan se sa sfidues ishte raportimi për të dy palët e përfshira në konflikt, sepse nga njëra anë kishte tendencë të dirigjimit të mënyrës së asaj çfarë publikohej në media, ndërsa në anën tjetër kishin nevojë për fakte të mirëfillta për të ndryshuar një imazh tashmë të imponuar ndryshe nga ç’ishte. Ajo rrëfen angazhimin e saj për të zbardhur imazhin e vërtetë të ushtarëve të UÇK-së, duke bërë përpjekje që t’i bindë ata për të hequr maskat gjatë deklaramit publik. Kjo me qëllim që t’i bëhej e ditur botës se nuk janë një grup terrorist sikurse cilësoheshin nga një pjesë e mediave, dhe si sukses vlerëson faktin që ka arritur t’i bindë ushtarët e UÇK-së të deklaroreshin pa maska.

⁴¹ Intervistë me Jeta Xharra dhe Avni Ahmetaj.

“Gazetarët janë parë si të dyshimtë, prandaj shpeshherë jemi ndaluar në barrikada edhe nga ushtarët e UÇK-së, të cilët kanë qenë me maska vazhdimisht. Një nga punët e para, por me efekt të madh në imazh, është t’i bindim që t’i heqin ato maska, sepse po asociojnë në terrorizëm.”⁴²

Sipas saj, maskat ishin arsyeja që korrespondentët e huaj kishin përshtypje të gabuar për rastin e Kosovës, që konfirmonte imazhin që Serbia donte të krijonte për Kosovën dhe shqiptarët si terroristë.

“Ne i kërkonim ku gjendeshin dhe filluam me fol dhe me ua shpjegu kush janë gazetarët ndërkombëtarë me të cilët ishim. Fillimisht kemi marrë një përsëritje komuniste, por kemi komunikuar me ta që t’i bindim se si ‘freedom fighter’ nuk ke arsye mos me heq maskën. Kjo ka pasur sukses dhe kanë filluar t’i heqin maskat në zonën e Drenicës.”⁴³

Jeta Xharra tregon se gjatë luftës ngjarjet kryesisht paraqiteshin me refugjatë. Ajo rrëfen se si ngjarja e datës 5 mars 1998 kur së bashku me kameramanin Vaughan Smith kanë shkuar në periferi të Prekazit, me orientimin për të parë fillimisht vetëm tym nga distanca, që është edhe xhirimi i vetëm i tankeve kur forcat serbe i kanë shkatërruar shtëpitë e familjes Jashari. Gjatë realizimit të këtij xhirimi, kameramani Smith u sulmua me një plumb snajperi, që fatmirësisht depërtoi në çantën e tij të belit. Kjo i është paraqitur si dëshmi ushtarëve të UÇK-së se ata janë sulmuar nga armiku.

“Plumbi me të cilin ishte qëlluar Vaughan Smith, që kishte përfunduar në baterinë e celularit të tij të modelit Sony, të cilën e ka pasur në çantën e belit, e kemi fotografuar, kemi shku te UÇK, i kemi treguar që kjo është që armiku na ka sulmuar edhe neve, por fatmirësisht plumbi nuk e kishte kapur atë në trup, por kishte përfunduar në bateri. Kjo foto ka ndikuar që filluan të na hapen postbloquent nga UÇK në terren dhe të fillojnë paraqitjet e tyre para kameras pa maska.” (Jeta Xharra, BBC)

Pra, gjatë raportimit në periudhën e luftës, korrespondentët vendorë kanë ndikuar në ndryshimin e imazhit të Kosovës karshi botës. Paraqitja publike pa maska e ushtarëve të UÇK-së, ka mjaftuar që të pasqyrojë imazhin e vërtetë të UÇK-së, që nuk janë terroristë, por mbrojtës të viktimave, si një ushtri jo profesionale, por që nuk mund t’i mbijetojnë dëbimit me dhunë dhe masakrave që po bënte pala serbe ndaj civilëve shqiptarë. Sipas Jeta Xharrës, u arrit t’i

⁴² Intervistë me Jeta Xharra, më 27 maj 2015. Intervista është realizuar në zyrën e saj në objektin ku gjenden zyrat e BIRN në Prishtinë, ku dhe aktualisht është drejtore e BIRN.

⁴³ Intervistë me Jeta Xharra, më 27 maj 2015. Intervista është realizuar në zyrën e saj në objektin ku gjenden zyrat e BIRN në Prishtinë, ku dhe aktualisht është drejtore e BIRN.

paraqitej botës se popullata civile ndaj së cilës po bëhej krimi nuk lidhej me terrorizëm, nuk kishte të bëjë me fenë, as me komunizmin, siç mendonin një pjesë e korrespondentëve ndërkombëtarë nga Sarajeva, ku masakrimi ishte bërë ndaj myslimanëve dhe nga Beogradi, të informuar nga propaganda e mediave serbe, siç ishte Tanjug atë kohë. Andaj, mund të konkludohet se gjatë periudhës së luftës, Kosova përbënte lajmet kryesore në BBC, CNN, REUTERS, por jo vetëm.

“Pavarësisht se kushtet e punës kanë qenë të vështira, për shkak të rrezikut dhe jo sigurisë, kemi dalur në terren me automjet të blinduar, me jelekë antiplumbë, por është fascionante ajo çfarë kam mësuar. Rrezikimi i jetës duke pasur familje, si korrespondentët ndërkombëtarë, që kishin ardhur këtu, i kam thënë vetes: Nëse një anglez vjen në vendin tënd me këso rreziku raporton për ty, për vendin tënd, pse nuk do të rrezikoj unë? Kjo është baza e guximit tim.”
(Jeta Xharra, BBC)

Ngjarjet gjatë luftës janë paraqitur kryesisht me kronika për refugjatë, duke përshkruar një popullatë të gjorë në kampe, meqë lëvizjet në terren brenda vendit ishin të kufizuara. Ka pasur edhe dezinformata të shumta, panik, marrëveshje që arriheshin me një komandant të UÇK-së, ndërsa tjetri komandant i UÇK-së të ndalonte në rrugë për të parë kush je dhe çfarë kërkon.⁴⁴

“Në zona të ndryshme e dinim kush është në pika kontrolli, kryesisht kontaktet i kishim me komandantët. Intervistën e parë e kam realizuar me Fehmi Lladrovcin, një njeri me mustaqe të gjata, që në pamje të parë të krijonte një përshtypje tjetër, pastaj kam realizuar intervista edhe me Adem Demaqin, Albin Kurtin, Sahit Jasharin dhe të tjerë.”⁴⁵

Sa i përket paraqitjes së rolit të UÇK-së në atë kohë, Jeta Xharra thekson se fillimisht raportohej me shumë rezerva se kush ishin ata njerëz, ndërsa më vonë, u raportua me shumë simpati për rolin dhe idealet e tyre, si pjesë e popullit që po konfrontojnë Serbinë për ato që po bënin ndaj nesh si popullatë e këtij vendi.⁴⁶

Ndër korrespondentët ndërkombëtarë të cilët kanë mbuluar luftën në Kosovë, me të cilët ka bashkëpunuar edhe Jeta Xharra, janë Voughan Smith, Paul Wood, Ben Brown, Jeremy Bowen, Kate Adie, Jacky Rowland, David Loyn.

⁴⁴ Intervistë e realizuar me Jeta Xharra, më 27 maj 2015.

⁴⁵ Intervistë e realizuar me Jeta Xharra, më datë 27 maj 2015.

⁴⁶ Intervistë e realizuar me Jeta Xharra, më 27 maj 2015

Në vitin 1997, korrespondentët e BBC kanë qëndruar në Hotel Grand në Prishtinë. Ka qenë i angazhuar një ‘fikser’ nga Beogradi që i shoqëronte korrespondentët ndërkombëtarë.⁴⁷ BBC ka pasur një dhomë montazhi, zyrë dhe pajisje tjera të nevojshme për punë.

Në vitin 1998, BBC ka hapur zyrat në një shtëpi private në lagjen Arbëria (atë kohë e njohur si Dragodan), prej ku janë ndjekur ngjarjet për Kosovën gjatë periudhës së luftës.⁴⁸

“Shumica e gazetarëve ndërkombëtarë që kanë ardhur në Kosovë, kanë qenë në Beograd, ku janë informuar për ngjarjet nga idetë e serbëve, jo që kanë pasur ide se çfarë po ndodh në të vërtetë. Është dashur ne t’ua rrëzojmë atë pasqyrë që kanë pasur për Kosovën, për t’ua dhënë realitetin...qëllimi ynë nuk ka qenë propagandues, por më shumë kombëtar, kemi qenë të ri nuk kemi ditur më shumë se ato që kemi përjetuar apo kemi parë...”⁴⁹

“Ata kanë dëgjuar për ngjarjet, por meqë ne vet nuk kemi pasë mundësi me shku në vendngjarje, kemi shfrytëzuar gazetarët ndërkombëtar për t’i dërguar në Likoshan, në Qirez, e në vende tjera.” (Visar Kryeziu, Koha Ditore)

Ai informon se si ky bashkëpunim ua ka mundësuar edhe më lehtë depërtimin në terren duke përdorur automjetet me targa të Beogradit, të cilat ishin marrë me qira nga korrespondentët ndërkombëtarë. Në këtë mënyrë, ata kanë arritur të kalojnë lirshëm barrikadat e ushtrisë serbe edhe pse cilësoheshin me epitetin ‘spiunë të ndërkombëtarëve’. Për ta i rëndësishëm ishte misioni që kishin synim dhe ai po arrihej.

“Kemi arritur të raportojmë për një rast të tmerrshëm në fshatin Qirez, ku kemi gjetur një grua shtatzënë pa kokë...kokën e kishte të eksploduar... ky lajm u publikua në ballinë të Kohës Ditore në shkurt të vitit 1998.” (Visar Kryeziu, Koha Ditore)

Ai rrëfen se tendencat e ushtrisë serbe ishin t’i orientojnë korrespondentët ndërkombëtarë tek ngjarjet që i cilësonin si krime të kryera nga shqiptarët.

“Në fshatin Likoshan, UÇK-ja i kishte vrarë dy polic serb. Ky ishte raportim nga serbët përmes Media Qendrës në Hotel Grand, ku serbët sipas sistemit të tyre u jepnin informata gazetarëve dhe personaliteteve ndërkombëtare” (Visar Kryeziu, Koha Ditore).

Ai në vijim thekson se pavarësisht propagandës nga pala serbe, fakti që ka arritur t’i shoqërojë korrespondentët ndërkombëtarë në vende të ngjarjes në terren, ku kanë pasur rastin të marrin në foto ato çfarë i kanë parë, ka qenë më e fuqishme sesa vetë ajo çka servirej nga serbët.

“Ajo çfarë kam arritur unë t’i ofroj, është një realitet tjetër nga ajo që ka mësuar opinioni nga Beogradi.” (Visar Kryeziu, Koha Ditore).

⁴⁷ Intervistë e realizuar me Jeta Xharra, më 27 maj 2015, në zyrat e BIRN në Prishtinë.

⁴⁸ Intervistë e realizuar me Jeta Xharra, datë 27 maj 2015, në zyrat e BIRN në Prishtinë.

⁴⁹ Intervistë me fotoreporterin Visar Kryeziu, realizuar më 8 maj 2015, në zyrat e AP në Prishtinë.

Visar Kryeziu gjatë muajve prill dhe maj të vitit 1998 ka punuar si përkthyes për BBC, ndërsa më pas iu bashkua Agjencisë ndërkombëtare të lajmeve Associated Press (AP). Kjo agjenci e lajmeve me parapagim, ka monitoruar konfliktin në Kosovë qysh nga fillimi. Një ndër ngjarjet ekskluzive gjatë kohës së luftës në Kosovë, për të cilën ka raportuar AP, është rasti i shkëmbimit në Shalë të Bajgorës, i datës 12 janar 1999. AP publikoi foto ekskluzive kur për tetë ushtarë serbë që ishin zënë robër nga UÇK-ja, me marrëveshje dhe ndërmjetësim të OSBE-së, u shkëmbyen nëntë ushtarë të UÇK-së.⁵⁰

Ai shpjegon se AP ka raportuar ngjarje që ishin më shumë në favor të palës shqiptare, dëbimet me dhunë, refugjatët, masakrat, apo raportimi që bëri për artilerinë e rëndë të përdorur nga forcat serbe, tanket kundërajrore të cilat megjithëse nuk lejohet të ulen nën 35 shkallë dhe janë të ndaluara për përdorim me Konventën e Gjenevës, janë përdorur nga policia serbe. Ai gjithashtu thekson se kjo agjenci lajmesh ka raportuar edhe vrasjet ndaj serbëve, siç ishte rasti i vrasjes së kryetarit të Fushë Kosovës, Zvonko Bojaniç, i cili u gjet i vrarë më 18 dhjetor të vitit 1998 (Visar Kryeziu, AP). Pra, AP kishte një pasqyrim të ngjarjeve nga këndvështrimet e dy palëve në konflikt, mirëpo ngjarjet e pasqyruara ishin kryesisht në favor të palës shqiptare.

Ai rrëfen se si një i ri, pa përvojë, ka arritur të ndihmojë në ndryshimin e opinionit për Kosovën. Ai ka shoqëruar korrespondentët ndërkombëtarë në terren, për të parë vetë ngjarjet nga afër, si për shembull vizita në fshatrat Likoshan dhe Vasilevë, ku kanë arritur në vendngjarje duke pyetur gjatë rrugës se si shkohet, me gjithë barrikadat nëpër rrugë. Ata kanë bërë foto dhe kjo i ka bërë që të raportojnë ngjarjet siç i kanë parë.

Si vizionarë të rinj që ishin, ata kishin një mision të përbashkët, t'i tregonin botës realitetin që po ndodhte me popullatën civile në Kosovë, pavarësisht kushteve të vështira për punë, sidomos

⁵⁰ Intervistë me fotoreporterin Visar Kryesiz, realizuar më 8 maj 2015, në zyrat e AP në Prishtinë.

në aspektin e sigurisë. Garentina Kraja rrëfen për kushtet e punës që ka pasur në gazetën Koha Ditore.

“Kemi pasur një zyrë ku ishim afro 10 gazetarë dhe në një zyrë tjetër ishin redaktorët. Me pasqyrimin e ngjarjeve, kemi pranuar edhe donacione nga ndërkombëtarët dhe kemi pasur mjaft entuziazëm, pavarësisht se 100 marka e kam pasur rrogën. Interesi ka qenë që kemi pasur obligim të raportojmë për këta njerëz të shtypur, kemi kërkuar të shkojmë t’i shohim njerëzit e vendosur në kampe, sikurse në Kishnarekë në kampin e refugjatëve, ku është dashur të arrihej duke udhëtuar nëpër male. Në këtë kamp kishte popullatë civile nga Drenica e Malisheva që ishin zhvendosur aty.” (Garentina Kraja, Koha Ditore)

Gazetarët lokalë shkëmbenin informacionet mes tyre sepse ishin të bashkuar në mision, për të pasqyruar krimin ndaj një popullate civile pa faj, pa agjendë dhe jo për të bërë propagandë. Me rritje të kredibilitetit të tyre mbi atë çka raportnin, këto informacione do t’i ndanin më vonë edhe me korrespondentët ndërkombëtarë që iu bashkuan këtij misioni.

“LDK, UÇK dhe të gjithë kanë pasur agjendë në Kosovë, por gratë, fëmijët, pleqtë, ata s’kanë pasur agjendë, prandaj duhej raportuar çfarë po ndodh me ata. Civilët kanë qenë shënjestër, pa i diskriminuar fare nëse është femër, fëmijë, i moshuar, apo luftëtar... dhe shpesh i kemi parë civilët që kanë pësuar nga regjimi serb.”⁵¹

Edhe Garentina Kraja ka qenë refugjate në Maqedoni, nga data 3 prill 1999 deri më 10 qershor 1999. Ajo është larguar pas sulmit të datës 24 mars 1999 ndaj gazetës Koha Ditore, ku u vra roja dhe forcat serbe morën të gjithë kompjuterët e redaksisë. Po atë mbrëmje është vlarë edhe avokati i Kohës Ditore, Bajram Kelmendi me dy djemtë e tij (Garentina Kraja, Koha Ditore).

“Sa herë që ishte marrë në biseda informative, ai gjithmonë i ka mbrojtur gazetarët. Ka qenë i zëshëm, avokat i fjalës së lirë.” (Garentina Kraja, Koha Ditore).

Ballina e fundit e gazetës Koha Ditore para bombardimeve me titullin “NATO Air: Just Do It”, zgjoi diskutim edhe tek mediat dhe analistët ndërkombëtarë, duke e parë atë si këndvështrim të palës shqiptare në favor të ndërhyrjes së NATO-s, sepse ishte një situatë kur ende kishte dyshime nëse do të bombardonte NATO apo jo.

Gazeta Koha Ditore ka qenë e mbyllur deri mesin e muajit prill të vitit 1999.

“...pastaj jemi mbledhur, kemi kuptuar që misioni jonë nuk ka përfunduar, për të raportuar për refugjatët, për shtëpitë e tyre... i kemi blerë kompjuterët përsëri dhe kemi vazhduar punën... kemi qenë institucion në shërbim të Kosovës, jo vetëm medium.” (Garentina Kraja, KohaDitore).

⁵¹ Intervistë me Garentina Kraja, realizuar më 8 maj 2015.

Atë periudhë, çlirimi i Kosovës ishte misioni i parë, pastaj zhvillimi i saj. Sipas Garentina Krajës, testi i të qenit objektiv i kësaj medie është fakti që janë raportuar edhe sulmet dhe përndjekjet që ka bërë pala shqiptare ndaj serbëve, sepse ideja ka qenë që Kosova të krijohet si një shtet ku do të jetonin qytetarët e saj pa presion, jo vetëm shtet i shqiptarëve.⁵²

Periudha gjatë luftës në Kosovë

Ashtu siç kanë deklaruar pothuajse të gjithë të intervistuarit, gazetarët korrespondentë ndërkombëtarë kishin ardhur në Kosovë për të mbuluar ngjarjet me një këndvështrim tjetër, të cilin e kishin krijuar qoftë nga përvoja e tyre e kaluar e raportimit për luftën e Bosnjës, apo të keqinformuar nga mediat serbe gjatë qëndrimit të tyre në Beograd.

Burimet kryesore të informimit në atë periudhë ishin refugjatët. Ata intervistoheshin lidhur me përvojën dhe përjetimet në Kosovë, arsyet e lëshimit të shtëpive të tyre, masakrat që kishin parë apo përjetuar familjarët e tyre.

“Lufta është paraqitur kryesisht me refugjatë drejtpërdrejt nga kampet,, me popullatë të gjorë të dëbuar, që kishin përjetuar ngjarjet, masakrat...” (Jeta Xharra, BBC)

Njëkohësisht raportohej për fluksin e madh të refugjatëve, vendstrehimin e tyre, kushtet në kampet e refugjatëve, mënyra e jetesës, ushqimi, kushtet higjienike, a kishte siguri të mjaftueshme brenda kampeve dhe çdo gjë tjetër që kishte të bëjë me aspektin human.

“Gjatë luftës janë paraqitur ngjarjet e masakrave, vrasjet masive. Unë kam mbuluar kryesisht pjesën e Mitrovicës, kam pasur një kamerë të vogël të fshehur me të cilën bëja përpjekje për të filmuar. Gjatë bombardimeve ngjarjet janë paraqitur me vrasjet, dëbimet, plagosjet, dëshmitë e njerëzve që kanë përjetuar ngjarjet, kushtet e jetesës së refugjatëve në kampe. Ndërsa, pas bombardimeve, me t'u kthyer në Kosovë, kemi raportuar se cilat janë dëmet e luftës, masakrat që kanë ndodhur, vrasjet masive, varrimet masive menjëherë pas lufte, ikjen dhe dëbimin e serbëve nga Kosova, se si forcat e KFOR-it po vendosen në Kosovë...” (Avni Ahmetaj, Sky News).

Gjatë periudhës së luftës, kryesisht para vendimit të NATO-s për ndërhyrje ushtarake, forcat serbe përdornin edhe më shumë agresion ndaj popullatës civile. Ishte një valë kur po bëhej një spastrim etnik i dhunshëm me një numër të madh të popullatës civile që u dëbuan nga shtëpitë e tyre për të lënë Kosovën. Një pjesë e madhe u dëbua, ndërsa një pjesë tjetër u larguan për shkak të pasigurisë dhe mungesës së kushteve elementare për jetesë. Këtë fat e kanë përjetuar

⁵² Intervistë e realizuar me Garentina Kraja, datë 8 maj 2015.

pothuajse të gjithë të intervistuarit. Mirëpo, ky largim u hapi rrugë atyre për t'u bashkuar me mediumeve ndërkombëtare. Bardh Krasniqi ishte ndër ata që me t'u dëbuar nga Kosova në drejtim të Maqedonisë, aplikoi për punë në cilësinë e përkthyesit për agjencinë e lajmeve Associated Press (AP), ndërsa më vonë kaloi në Reuters ku ende vazhdon punën si reporter.

“Pasi që forcat serbe na larguan nga Kosova drejt Maqedonisë, në nevojë për para, menjëherë kam kërkuar punë si përkthyes meqë njihja gjuhën angleze. Kam qenë i zhvendosur nga fundi i muajit mars i vitit 1999 deri në qershor të vitit 1999. Kam punuar me agjencinë e lajmeve AP, zyra në Shkup. Kam filluar punën diku mes datave 1 dhe 5 prill, fillimisht si përkthyes.” (Bardh Krasniqi, AP)

Eksperiencë të ngjashme ka përjetuar edhe gazetari Avni Ahmetaj.

“Kam qenë në Kosovë deri më 14 prill 1999, pastaj jemi dëbuar me dhunë në Shqipëri, ku dhe kam filluar punën me 15 prill në Sky News, pasi fillimisht më intervistuan si refugjatë dhe e njihja gjuhën angleze. Në Kukës kam qëndruar deri në hyrjen e NATO-s në Kosovë. Ditën e parë që ka hyrë NATO, jam kthyer edhe unë.” (Avni Ahmetaj, Sky News).

Paragrafët e mësipërm dhe të tjerë të mëposhtëm janë përzgjedhur për të treguar se sa i vështirë ka qenë raportimi në atë kohë. Si në të gjitha rastet kur gazetarët raportojnë nga vende në luftë ka mungesë të burimeve. Ato ose janë zyrtare, dhe në përgjithësi burimet zyrtare në këtë rast kanë pasur kufizime, pasi ato ose ishin media serbe ose ishin raporte nga zyrtar të NATO-s. Në të dy rastet ka kufizime në raportimin e informacionit. Në rastin e parë për arsye se pala serbe ishte pala e akuzuar, dhe në rastin e dytë, NATO ishte një forcë që po zhvillonte një fushatë luftarake dhe dihet që në situata të tilla informacionet janë të kontrolluara për arsye të sekretit ushtarak. Pra, kur analizojmë burimet e informacionit në atë periudhë, vërehet qartë se ato vinin pikërisht nga të ashtuquajturit ‘fikserë’, të cilët në një farë mënyre bënë edhe kontrollin e informacionit që u transmetohej mediumeve ndërkombëtare.

Në këto rrethana mund të arsyetojmë në mënyrë të paanshme, se pala që raportonte situatën e krizës dhe që ndikonte më së shumti në mënyrën se si mediat ndërkombëtare po raportonin situatën humanitare dhe po e përdornin atë për të ndikuar audiencën, vjen nga vetë pala shqiptare e Kosovës. Në rastin e tillë është e qartë se vetë burimet po ndikonin drejtpërdrejtë në mënyrën se si po raportoheshin dhe në realitetin që po krijonte media në arenën ndërkombëtare, duke e bërë perceptimin e krizës së Kosovës si një produkt të asaj çka po raportonin vetë shqiptarët.

Gjithashtu, lidhja që krijohet mes njerëzve që ndajnë të njëjtat eksperiencë, ndikon duke i bërë që të ndajnë edhe të njëjtin perceptim. Mënyra se si gazetarët ndërkombëtarë dhe ata vendorë po raportojnë situatën, është gati e njëjtë, dhe mund të thuhet se të vetmet ndasi që ekzistojnë janë ato kulturore dhe gjuhësore. Ky fakt bëhet edhe më i qartë kur studiojmë disa nga paragrafët më të spikatur gjatë intervistave, që tregojnë se si ndryshoi perceptimi i gazetarëve ndërkombëtarë për Kosovën, e si rrjedhim dhe ai i mediave që ata përfaqësonin. Pavarësisht etikës gazetareske, që ndonëse mungon tek fikserët, por është e ngulitur tek gazetarët ndërkombëtarë, siç është evidentuar edhe në analizat e mësipërme të artikujve, sërisht shihet se si ndryshon mënyra se si ata e shohin Kosovën dhe popullatën e saj. Gjithashtu, në këtë aspekt vlen të përmendim edhe faktin se pavarësisht se ka pasur shumë reporterë të huaj të njohur si për BBC, CNN, REUTERS dhe media të tjera ndërkombëtare, sikurse ishin kameramani dhe gazetari Vaughon Smith, korrespondenti i BBC, Paul Wood, Ben Brown, Jeremy Bowen, Kate Adie, Jacky Rowland, David Loyn, Gretchen Peters (reportere amerikane), Caro Kriel (angleze), Miguel Gli Moreno, reporter spanjoll (freelancer) dhe të tjerë, informacioni filtrohej prej fikserëve vendorë. Ndaj kemi një qasje gjithmonë e më të madhe drejt një përfundimi se në të gjitha këto raste, ata që mund të quheshin reporterë të drejtpërdrejtë të lajmit ishin pala shqiptare, dhe për më tepër ishin njerëz të patrajnuar në profesionin e gazetarit. Një fakt tjetër siç mund të konfirmohet edhe nga pjesa e mëposhtme, është e dhëna që pavarësisht se si vinte informacioni nga burime të tjera, të cilat për të qenë të sinqertë ishin më shumë profesionale se sa burimet aktuale, në përgjithësi ato shpërfillehin për të njëjtën arsye të theksuar më sipër. Me sa është vërtetuar edhe nga studime të tjera (De Franco, 2012), ajo që luan më shumë rol në raportimin dhe pasqyrimin që bëjnë media është pikëpamja e viktimës. Në kushtet kur mes gazetarit dhe viktimës vendoset dhe një lidhje tjetër e ngushtë, siç është ndarja e eksperiencave të ngjashme, sikurse edhe ndodhi në rastin e gazetarëve ndërkombëtarë me fikserët vendorë, atëherë raportimi dhe mënyra e pasqyrimin ndryshon duke kaluar në një këndvështrim të njëanshëm.

Është për t'u veçuar fakti që edhe pse ka një preferencë të mënyra se si media raportoi realitetin e krizës së Kosovës, prapëseprapë mënyra si u paraqitën lajmet ishte në përputhje me rregullat e etikës gazetareske. Ndikimi është në nënvetëdijen e audiencës dhe perceptohet më tepër si përshtypje, sesa si një shkrim i njëanshëm i gazetarëve. Ky ndryshim vjen në mënyrë graduale dhe nuk është në asnjë formë të drejtpërdrejtë. Bëhet nëpërmjet përzgjedhjes apo një strukture të posaçme të ndërtimit të lajmit, apo paraqitjes filmike, dhe asnjëherë nuk bie ndesh me rregullat gazetareske.

Sikundër mund të kuptohet edhe në vijim, është komunikimi në dy nivele që jep këtë rezultat. Gazetarët ndërkombëtarë realisht kishin fikserët vendorë si burim të besuar, ndërsa mediat publikonin informacionin e mbledhur pikërisht nga këta gazetarë. Në këtë formë informacioni rrjedh në dy nivele dhe ndikon në audiencë.

Një element tjetër është fakti që propaganda ka ekzistuar për të dyja palët. Vendet postkomuniste e kanë të pamundur të dalin nga kornizat e sfondit të vet historik. Në këtë aspekt mund të themi se ekziston një ndryshim i veçantë midis propagandës serbe dhe asaj shqiptare. Nëse propaganda serbe u drejtohej dhe u servirej gazetarëve ndërkombëtarë, ajo shqiptare u drejtohej vendasve, duke i drejtuar që të ishin konform me rregullat dhe pritshmëritë e gazetarëve ndërkombëtarë dhe duke e kthyer vëmendjen e tyre krejtësisht ndaj palës shqiptare.

“Propaganda ka qenë jashtëzakonisht e madhe nga mediumet serbe, sidomos agjencitë e lajmeve serbe, sikurse TANJUG dhe të tjera. Kanë përdorur propagandë për të portretizuar se refugjatët që po lëshojnë Kosovën, po e bëjnë për shkak të bombardimeve të NATO-s. Ne kemi intervistuar refugjatët për t'i pyetur për këto dhe ata kanë treguar se për çfarë arsyesh janë larguar nga Kosova, jo për shkak të NATO-s, por për shkak të dëbimit nga forcat serbe.”
(Avni Ahmetaj, Sky News).

Kishte raste kur informacionet dhe lajmet ndërthureshin me të dhëna nga mediat serbe, mirëpo në këto raste mediat ndërkombëtare kanë cituar burimin e informacionit duke theksuar se e dhëna është marrë nga medime/agjenci lajmesh serbe dhe nuk janë konfirmuar me burime të pavarura. Një pjesë e informacioneve janë dhënë edhe nga intervistat e realizuara me autoritete ndërkombëtare dhe vendore që në atë kohë luanin rol

në ngjarjet në Kosovë. Gjatë periudhës së luftës, në Sky News, lajmet për Kosovën kanë qenë zakonisht lajme kryesore të paraqitura ashtu siç janë parë nga terreni.

“Për shkak të rrezikshmërisë së madhe dhe pamundësisë për të përcjellur ngjarjet nga afër gjatë luftës, para bombardimeve në Kosovë pika më e afërt për informim ka qenë Beogradi. Janë agjencitë shtetërore që janë përdorur për informacion, kryesisht agjencitë e lajmeve me korrespondentët serbë. Ndërsa, gjatë periudhës së bombardimeve ka patur mundësi raportimi nga vendi i ngjarjes drejtpërdrejtë, por më lirshëm gjatë hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë është raportuar kryesisht nga vendi i ngjarjes.” (Avni Ahmetaj, Sky News)

Deklarimet e mësipërme janë zgjedhur pikërisht për të faktuar mënyrën e ushtrimit të propagandës nga të dyja palët. Sikurse mund të shihet edhe nga përgjigjet e të intervistuarve, informacioni që është raportuar është filtruar më përpara prej tyre. Edhe pse është e pamundur për të provuar në mënyrë faktike nëse kjo formë e të vepruarit ka ardhur në mënyrë të pavullnetshme prej tyre, apo ka qenë në një mënyrë e vetëdijshme dhe është mësuar prej gazetarëve ndërkombëtarë, duket qartë se ndryshimi i perceptimit bëhet nëpërmjet propagandës që ushtrojnë fikserët kundrejt vetë vendasve.

Ndonëse perceptimi për UÇK-në fillon të ndryshojë qysh pas publikimit të lajmeve të para për refugjatët dhe masakrat që po kryheshin ndaj shqiptarëve, realisht ai ndryshoi krejtësisht pas fillimit të bombardimeve dhe hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë. Sidoqoftë është interesante të vihet në vëmendje se perceptimi i UÇK-së filloi të ndryshojë në periudhën kur gazetarët ndërkombëtarë ishin duke raportuar drejtpërdrejtë nga terreni. Konsiderohet se fokusimi i propagandës nga ana e fikserëve ndaj popullatës vendase dhe udhëzimi i tyre për t’iu përshtatur pritshmërive të ndërkombëtarëve, bëri të mundur që të ndodhte ky ndryshim.

Siç është argumentuar nga studime të mëparshme, ndryshimi i pritshmërisë së medimeve sjell në mënyrë të patjetërsueshme dhe ndryshimin në pritshmërinë e audiencës (Robinson, 2005), në rastin tonë të audiencës ndërkombëtare. Ishte pikërisht ky ndryshim që solli dhe ndikimin më të madh në perceptimin e Kosovës dhe është pikërisht ky ndryshim që e përkufizon edhe sot Kosovën në arenën ndërkombëtare. Parë në këtë këndvështrim është e vështirë që të mund

të kontestojmë faktin se si ndikuan këta sekserë në mënyrën e zhvillimit të ngjarjeve në tërësinë e tyre. Duke përdorur ndoshta naivitetin për të treguar se kombi i tyre ishte i pafajshëm dhe se ata që quheshin terroristë ishin në të vërtetë pjesëtarë të shoqërisë që po persekutohej dhe po bënin përpjekje të mbronin popullatën e pafajshme. Ka incidente të ndryshme të përshkruara gjatë raportimit që nëse do të shihen në mënyrë të veçantë duket se nuk kanë rëndësi, por kur merren dhe vendosen së bashku tregojnë një tablo krejt tjetër. Në këtë formë, komunikimi propagandistik, që është një karakteristikë e vendeve lindore, merr një rol krejt të ri, dhe ndonëse vazhdon të jetë një armë e fuqishme manipulimi, në rastin konkret kthehet në një armë fituese dhe ndryshon perceptimin e gazetarëve dhe si rrjedhojë edhe raportimin që bëjnë mediat për të cilat ata punojnë. Pra, mund të thuhet se jo vetëm që ndikimi mediatik ka luajtur një rol të rëndësishëm gjatë krizës së Kosovës, por që gjithashtu pjesa më e rëndësishme e saj, vetë mënyra se si ajo ka ndryshuar perceptimin e saj ka ardhur nga vetë fikserët. Rasti i ndryshimit të perceptimit të UÇK-së është ai që e pasqyron më së miri këtë realitet. Parë në këtë këndvështrim, nëse ballafaqohen përgjigjet e të intervistuarve dhe krahasohen me të dhënat nga dy analizat e para, shohim në mënyrë të qartë se evoluimi i perceptimit të medias ndërkombëtare lidhur me Kosovën është në përpjesëtim të drejtë me raportimin që bëhej nga vendi ku po zhvillohej konflikti. Sa më shumë u angazhuan fikserët vendorë në shoqërimin dhe përfshirjen në raportimet ndërkombëtare, aq më shumë ndryshoi perceptimi i mediave ndërkombëtare lidhur me atë çka po ndodhte në Kosovë, dhe po aq më shumë u rrit ndikimi i saj pro Kosovës, duke qëndruar konform fenomenit të mostjetërsimit të informacionit, por ndryshimit të perceptimit të audiencës lidhur me realitetin.

Gjithashtu, mënyra se si komunikimi vendoset në një plan tredimensional për rrjedhjen e informacionit, tregon edhe njëherë se ndonëse iniciativa është me shkak vendor, mënyra se si rrjedh dhe ushtron ndikimin e saj në planin trepalësh, shërben si një shtysë për fuqizimin e mesazhit që ajo përmban, duke u kthyer në një influencë të drejtpërdrejtë ndaj faktorëve

që ndikojnë në politikat e jashtme, duke përdorur presionin e opinionit publik (Robinson, 2005). Kjo është ajo që i jep një shtysë të veçantë rrjedhshmërisë së ngjarjeve në arenën ndërkombëtare.

Pra, pavarësisht ngjarjeve të tjera që e vendosin Kosovën në një dritë jo shumë të pastër pas përfundimit të luftës (akuzat e Dik Martit), sërisht vihet re një dashamirësi e tre mediave kryesore në studim kundrejt Kosovës dhe një prirje për të besuar në pafajësinë e saj, apo për t'i përlligjur këto ndodhi si pasoja të shkaktuara nga lufta. Vlen të theksohet se kjo është një dukuri specifike për Kosovën.

Ndonëse ka dhe raste të tjera kur media luan një rol të rëndësishëm në legjitimimin e sovranitetit të provincave të tjera që kanë pasur pavarësi nga shtetet përkatëse, siç janë Pakistani dhe Taivani, nuk gëzojnë të njëjtën vëmendje mediatike sikurse Kosova, dhe bazë për këtë është pikërisht fakti që u cek më sipër, drejtimi i propagandës nga fikserët kundrejt popullatës vendase dhe parashtrimi i fakteve aktuale për sa i përket pjesës tjetër të informacionit. Duke bërë përhapjen e informacionit në këtë mënyrë në dy nivele, fikserët vendorë e ushtruan influencën e tyre në mënyrë të tërthortë tek mediat ndërkombëtare, që si pasojë janë duke ushtruar influencë në arenën ndërkombëtare duke çuar në konformimin e tyre me kërkesat shekullore të shqiptarëve.

Në paragrafët e mëposhtëm është bërë një perifrachim i ecursisë së ngjarjeve, përshkruar nga këndvështrimi i njërit prej fikserëve të asaj kohe. Është përzgjedhur gazetarja Jeta Xharra, jo vetëm për arsye të ndikimit dhe rolit që ka pasur në atë kohë, por sepse ajo edhe sot e kësaj dite vazhdon të jetë një prej figurave të njohura të arenës gazetareske në Kosovë.

Duke pasur parasysh moshën e re të së intervistuarës, si dhe rolin që ka luajtur gjatë dhe pas luftës, rëndësi të veçantë merr mënyra se si është arritur deri tek modifikimi i opinionit të gazetarëve ndërkombëtarë, si dhe ai i aktorëve kryesorë të asaj periudhe brenda në vend. Natyrisht që mosha e re ka luajtur një rol të rëndësishëm në mënyrën se si e ka përjetuar

dhe se si është integruar në këtë fushë, por përshkrimi i saj, sidomos për kohën e luftës, pasqyron një tablo shumë të qartë të asaj çka po ndodhte në kuadër të bashkëpunimit me gazetarët e huaj, si dhe mënyrës se si kanë bërë të mundur integrimin e aktorëve kryesorë të asaj periudhe, sikurse është UÇK-ja, konform ndryshimit që kanë perceptuar gazetarët ndërkombëtarë gjatë ndërveprimit me ta. Me rëndësi është të theksojmë se pavarësisht mënyrës së ndikimit, personat që realisht e kanë ushtruar këtë ndikim nuk kanë qenë të vetëdijshëm për atë çka po bënin. Ata i janë përshtatur situatave dhe janë munduar të pasqyrojnë realitetin. Pasojat e tjera që kanë ardhur si rrjedhojë e kësaj, nuk kanë qenë të studiuara dhe më pas të aplikuara në terren, por kanë ardhur si pasojë e situatës së krijuar dhe bashkëveprimit që ka ndodhur midis lokalëve dhe gazetarëve profesionistë ndërkombëtarë.

“Ne kemi qenë përgjegjës që t’i informojmë për ngjarjet çfarë po ndodhte në Kosovë. Në lajme ka pasur përfshirje të mirë UÇK-ja. Ngjarjet me masakra sikurse në fshatin Qirez dhe Likoshan, masakrat e Prekazit dhe Reqakut, janë katër masakrat kryesore me mbi 10 deri 50 njerëz të vararë për të cilat kam raportuar. Këto kanë mjaftuar për të paraqitur realitetin se çfarë po ndodh me popullatën civile në Kosovë, bashkë me imazhin e UÇK-së që kemi arritur ta dëshmojmë se nuk janë terroristë, por mbrojtës të viktimave, por nuk janë ushtri profesionale, por që nuk mund t’i mbijetojnë atyre çfarë po i bënte Serbia shqiptarëve në Kosovë, kemi arritur të paraqesim se rasti i Kosovës nuk është konflikt religjioz ku fajtorë janë myslimanët dhe se shqiptarët nuk ishin as terroristën as komunistë e majtistë siç pretendohet atë kohë nga propaganda e Serbisë. Edhe gazetarët ndërkombëtarë kishin ardhur nga Sarajeva dhe nga Beogradi me këto përshtypje në fillim.” (Jeta Xharra, BBC)

Kosova nuk ishte një vend i panjohur për arenën ndërkombëtare fillimisht. Pavarësisht kësaj, informacioni ishte i kufizuar për arsye se vinte nga organe zyrtare, sikurse ishin mediat serbe, kryesisht, duke i dhënë atij nuancat nacionaliste serbe dhe duke pasqyruar një realitet ku mbroreshin interesat serbe dhe jo ato shqiptare.

“Ngjarjet për Kosovën kanë qenë top lajme në edicionet qendrore të lajmeve edhe gjatë luftës edhe pasi ka hyrë NATO në Kosovë.” (Jeta Xharra, BBC)

Edhe pse shumica e dokumentarëve që kanë pasqyruar luftën e Kosovës dhe gjenocidin ndaj shqiptarëve janë filmuar gjatë periudhës së krizës, në formën reale të dokumentarëve, janë publikuar 3 deri në 4 vjet pas mbarimit të luftës. Është me interes për t’u përmendur fakti që shumica e këtyre publikimeve, përveç emrave të gazetarëve ndërkombëtarë si raportues, kanë

të përfshirë edhe emrat e gazetarëve vendorë. Kur flasim për këtë pjesë, përveçse faktorëve normalë që ndikojnë në bashkëveprimin e fikserëve me gazetarët ndërkombëtarë, nuk duhet lënë jashtë diskutimit edhe një element tjetër i rëndësishëm që është lidhja emocionale. Përvojat që ndajnë qeniet njerëzore në situata ekstreme, kontribuojnë në krijimin e një lidhje të ngushtë emocionale, që ndikon në mënyrën se si ata shohin kolegët e tyre në atë situatë dhe rrisin aftësitë e tyre njohëse për të ndarë të njëjtin këndvështrim dhe botëkuptim shpirtëror, pavarësisht prejardhjeve të ndryshme sociale që ata kanë (Pettijohn, 2005).

Në rastin e bashkëpunimit mes gazetarëve ndërkombëtarë dhe fikserëve ka pasur një ndikim të dyanshëm. Ndonëse jo në nivelin profesional të kolegëve të tyre të huaj, fikserët vendorë jo vetëm që ndihmuan dhe u frymëzuan prej tyre, por gjithashtu u aftësuan deri në atë pikë sa filluan dhe ata të ushtrojnë influencën e tyre mes kolegeve të huaj.

Një tjetër aspekt interesant i të intervistuarve është momenti kur nga përkthyes ata kaluan në rolin e gazetarëve, gjithmonë nën mbikëqyrjen e gazetarëve të huaj.

Një nga elementët kryesorë që sjell bashkimin e opinionit të huaj me atë vendor është aspekti humanitar i përfshirë në këtë konflikt.

Në kundërshtim me atë çka pretendonin mediat serbe se ky qe një konflikt me karakter fetar, duke përdorur atë që ne e njohim si 'Teoria autoritare' dhe duke e drejtuar propagandën kundrejt aktorëve vendorë dhe jo atyre ndërkombëtarë, këta fikserë arritën ta kthenin opinionin ndërkombëtarë në favor të shqiptarëve të Kosovës. Ata u bënë ura lidhëse që transmetonte në nivele shumëplanëshe mesazhe të ndryshme.

Kundrejt UÇK-së dhe politikanëve ata përdorën politikën e propagandës, duke shfrytëzuar në mënyrë figurative perceptimin individual si një armë për t'i kthyer personazhet kyçe të ngjarjeve në favor të pritshmërisë së tyre, duke bërë njëjtësimin e UÇK-së me organizata terroriste nga njëra anë dhe duke iu ofruar një zgjidhje për ta çmontuar këtë imazh nga ana tjetër.

Gjithashtu, duke iu përshtatur njohurive të kolegëve të tyre ndërkombëtarë, ata arritën të fokusonin njohuritë e tyre për historinë e vendit dhe atë që realisht po ndodhte, dhe të komunikonin me ta në të njëjtin nivel komunikimi, ose e thënë ndryshe, iu përshtatën nocioneve bazë të teorive të libertarianizmit dhe përgjegjësisë sociale.

Duke pasur si fokus kryesor elementin human në raportimet e tyre, ata në mënyrë efektive u bënë përçuesit kryesor të informacionit, dhe si pasojë elita selektive, e cila me filtrimin dhe më pas me publikimin që u bën informacioneve, del në plan të parë dhe sjell atë që ka patur më shumë ndikim në arenën ndërkombëtare, që është influenca mediatike në politikën e jashtme të vendeve të zhvilluara dhe ndryshimi i tyre duke bërë presion me anë të manipulimit të opinionit publik (Robinson, 2005).

Jeta Xharra më vonë u angazhua me punë në Institutin për Luftë dhe Paqe, në atë kohë i quajtur si IVPR, ndërsa në fund të vitit 2004 u themelua si BIRN.

“Krejt fikserët e BBC kanë qenë target nga forcat serbe gjatë periudhës së bombardimeve., edhe unë jam larguar për pak kohë, pra deri me 10 prill kam qenë në Shqipëri. Më vonë, pas luftës ndër ngjarjet që kanë pasur shumë vëmendje dhe që e ngritën tensionin për të shkuar deri në Pavarësi të Kosovës, ishin trazirat e marsit 2004.” (Jeta Xharra, BBC)

Të intervistuarit janë angazhuar spontanisht në medime ndërkombëtare që raportojnë për Kosovën, në disa raste si refugjatë që kishin kaluar në Maqedoni. Ky ka qenë një faktor i rëndësishëm në ndërtimin e raporteve midis fikserëve vendorë dhe gazetarëve ndërkombëtarë. Të ardhur nga kultura të ndryshme sociale, fakti që nga njëra anë kemi të rinj të rritur me një konservatorizëm të theksuar, ku vlerat morale janë ende shumë të forta dhe janë forcuar edhe më shumë për arsye mbijetese, të gatshëm të rrezikonin për ardhmërinë e vendit të tyre, ndërsa nga ana tjetër kemi një moshë më madhore e cila vjen nga një kulturë individualiste, ku kulti i njeriut është i bazuar në të drejtat themelore të njeriut dhe ndjenja e sakrificës është më së shumti kundrejt rrethit të ngushtë familjar dhe nocioneve kombëtare, sesa kundrejt të panjohurve, ishte dhe njëri prej aspekteve që i ofroi më së shumti këta individë të sfondeve kaq të ndryshëm.

Së fundmi, është dhe pjesa që kanë luajtur gazetarët të cilët kanë punuar në median e asaj kohe. Në këtë aspekt, i kam kushtuar një pjesë të veçantë analizimit të njërës prej mediave me më shumë influencë të asaj periudhe, më anë të intervistimit të njërës prej gazetarëve të parë që kanë punuar për këtë medium. Bëhet fjalë për gazetaren Garentina Kraja të gazetës Koha Ditore, e cila ka qenë një ndër mediumet që ka pasur një rol të rëndësishëm informativ në atë periudhë dhe që është identifikuar si burim informacioni dhe nga mediat ndërkombëtare në shumë raste.

Nga intervista dhe rrëfimet e znj. Kraja, mund të shqyrtohet se si ka evoluar situata dhe se si i ka bashkërenduar media vendore influencat e saj në përshtatshmëri me ato ndërkombëtare, duke krijuar një sferë unike influence. Të vetmet burime të pakontrolluara nga kjo sferë influence vinin nga ana e palës kundërshtare dhe aleatëve të saj, por duke pasur parasysh mbështetjen që ekzistonte për palën shqiptare nga mediat kryesore botërore, kjo kundërshti ishte e papërfillshme.

Është interesante të studiohet se si evoluoi situata dhe se si Koha Ditore kaloi nga një institucion i kufizuar nga autocensura në fillimet e konfliktit, në një institucion denoncimi social. Duhet pasur parasysh vështirësitë që kishte ky medium për të mbijetuar në një situatë konflikti të vazhdueshëm, pa asnjë garanci për ekzistencën dhe se si u transformua në një ndër mediat vendore që ushtronin më së shumti ndikim tek mediat ndërkombëtare.

Theksohet ky aspekt për faktin që edhe pse kërkimi nuk është thelluar në studimin e kësaj medie, për arsye të zgjerimit të madh që do të kishte punimi, është cituar dhe publikuar si e plotë intervista me znj. Kraja, pikërisht për të ilustruar evoluimin e medias në fjalë.

Garentina Kraja ka punuar në Koha Ditore nga muaji prill i vitit 1997, deri në shtator të vitit 2000. Pastaj ajo u angazhua me punë për agjencinë e lajmeve AP, ku punoi deri në vitin 2007.

Roli i gazetës KOHA DITORE

Rol të veçantë në paraqitjen e ngjarjeve për Kosovën kanë luajtur edhe mediat vendore, të cilat si misionare të së vërtetës, bënë përpjekje të ndryshonin opinionin publik ndërkombëtar që qarkullonte fillimisht për arsye të citimit të mediave serbe.

Koha Ditore ka luajtur një rol të rëndësishëm në informimin vendor dhe të bashkësisë ndërkombëtare. Ajo kishte një ekip gazetarësh që mbulonin ngjarjet në terren dhe përmes korrespondentëve nëpër rajone informoheshin mbi ngjarjet për arrestime, bastisje, dëbim me dhunë dhe të tjera.

“Roli që ka luajtur Koha Ditore sot gjykohet që ka raportuar kundër një pale apo tjetrës, por ne kemi qenë në favor të informimit objektiv të asaj çfarë po ndodhte në Kosovë, për dallim prej gazetarëve ndërkombëtarë që kanë ardhur në Kosovë dhe kanë parë objektivisht ngjarjet. Ne kemi qenë kosovarë që kemi përjetuar vet ngjarjet, dëbimin me dhunë nga shtëpitë dhe kemi pasur të vështirë të distancohemi nga ngjarjet në terren. Lufta ka qenë e jona kemi pasur subjektivitet po aq të prekur nga lufta sa që nuk kemi mundur të distancohemi...mediat ndërkombëtare kanë ardhur në Kosovë pasi kanë përcjellë një luftë, pra luftën në Bosnjë. Çfarë mund të ndodh dhe kush është fajtori, si gazetë ne nuk kemi pasur nevojë t'i bindim, sepse e kanë parë gjenocidin në Bosnjë dhe kanë pasur njohuri pak a shumë se si do të manifestohet lufta. Por ka pasur mungesë të burimeve të informacionit, sepse interneti ka qenë i limituar. Ne si gjeneratë kemi punuar me gazetarët më të mirë ndërkombëtarë.” (Garentina Kraja, Koha Ditore)

Ajo rrëfen mbi mënyrën e depërtimit tek informacioni dhe publikimin e tyre me gjithë vështirësitë dhe rrezikun.

*“Kemi krijuar përmbledhje të lajmeve dhe fotografive të ditës që i kemi dërguar në shumë adresa elektronike, ku kemi paraqitur civilët e vrarë, për të informuar opinionin publik ndërkombëtar dhe diplomatët për ngjarjet që po ndodhin... Të gjithë diplomatët dhe personalitetet ndërkombëtare kanë pasur pikë referimi Kohën Ditore për atë se çfarë po ndodh në Kosovë. Nuk ka qenë e rëndësishme çështja e ekskluzivitetit të lajmit, por informimi sa më shumë i opinionit.”*⁵³

Ajo paraqet mënyrën e ruajtjes së dëshmive gjatë filmimit të tyre në terren, së bashku me kolegët e saj, me gjithë rrezikun që u kanosej gjatë lëvizjes në terren, sidomos në cilësinë e gazetarit.

“Kam mbajtur fotografi nga terreni të fshehura edhe në pjesë intime të trupit, deri në zyrat e gazetës Koha Ditore në Prishtinë. Filmat e aparateve fotografikë të kolegëve i kam fshehur në pjesë të trupit, që t'i shpëtoja fotografitë për t'i sjellë në redaksi për publikim, sepse ato kanë

⁵³ Intervistë me Garentina Kraja, më 8 maj 2015. Intervista është realizuar në zyrën e saj në Presidencë, ku aktualisht punon si këshilltare e Presidentes Atifete Jahjaga.

ngritur kredibilitetin tonë si gazetar dhe kemi arritur t'i tregojmë botës se kjo është diçka që po ndodh."⁵⁴

Sipas Garentina Krajës, nga këtu ka filluar edhe interesimi më i madh i diplomatëve ndërkombëtarë të akredituar në Beograd, të cilët kishin vizituar zyrat e Kohës Ditore për t'u informuar mbi ngjarjet.

Garentina Kraja në vijim thekson se rol të rëndësishëm dhe dëshmi faktike për opinionin ndërkombëtar kanë luajtur fotografitë e kolegut të saj, fotoreporterit Visar Kryeziu. Atë kohë, ai ishte pjesë e stafit të Koha Ditore. Është ndër fotoreporterët që ka fotografuar masakrat në fshatrat Qirez dhe Likoshan. Fotografitë e tij duke u përcjellë edhe në formë elektronike ndezën alarmin për botën ndërkombëtare dhe ishin dëshmia e parë e madhe që në Kosovë kishte filluar lufta ndaj civilëve.

"Personalitetet ndërkombëtare janë adresuar tek Koha Ditore për t'u informuar mbi atë që po ndodh, sepse Koha Ditore ka pasur kredibilitet atë kohë. Ka qenë i besueshëm si institucion dhe ka shërbyer si qendër informimi lokal, ndërkombëtar dhe diplomatik.

Më 28 shkurt 1998, Koha Ditore ka qenë qendër informimi për diplomatët ndërkombëtarë, sepse kanë ardhur fillimisht në zyrat tona. Është ndër mediat e para lokale që kishte internetin në kuadër të asaj që ishte agjencia e lajmeve ART, ku kemi krijuar përmbledhje të lajmeve dhe fotografive të ditës që i kemi dërguar në shumë adresa elektronike për të informuar opinionin publik dhe diplomatët ndërkombëtarë, për civilët e vrarë dhe për ngjarjet që po ndodhin. Fotografitë kanë rritur kredibilitetin tonë si gazetarë, duke paraqitur se kjo është diçka që po ndodh. Përmes Kohës dhe agjencisë Arta kemi bërë mobilizimin e opinionit brenda dhe jashtë vendit, që realisht Kosova është në gjendje lufte."⁵⁵

Sipas Visar Kryeziut, deri në muajt qershor-korrik 1998, protestat e studentëve kanë qenë ngjarjet kryesore në media, pastaj tematika e ngjarjeve në Kosovë u bënë masakrat që po bëheshin ndaj popullatës civile, në veçanti masakra e Reçakut, që ngjalli interesimin e bashkësisë ndërkombëtare për Kosovën.

"Në vitin 1998, përkatësisht me datat 5 dhe 6 mars kur u sulmuan Jasharajt, kemi qenë në shtëpi, në ora 05:00 të mëngjesit na kanë njoftuar në telefon për ngjarjet dhe kemi dalë si ekip në zyrë. Jemi nisur në drejtim të Drenicës, por policia serbe na kanë kthyer prapa. Mirëpo, korrespondenti i BBC, Voughan Smith, ka qenë i pari kameraman që ka arritur të depërtojë në kodër në Prekaz, për t'i filmuar tanket dhe granatat. Atë e kanë qëlluar me snajper, por meqë plumbi nuk ka arritur t'i depërtojë në trup, ka shpëtuar. Ky xhirim me artilerinë e rëndë të granatimit të fshatit Prekaz është ngjarja që bëri mjaft bujë atë kohë në mediat ndërkombëtare." (Garentina Kraja, Koha Ditore)

⁵⁴ Intervistë me Garentina Kraja më 8 maj 2015. Intervista është realizuar në zyrën e saj në Presidencë, ku aktualisht punon si këshilltare e Presidentes Atifete Jahjaga.

⁵⁵ Intervistë me fotoreporterin Visar Kryeziu, realizuar më 8 maj 2015, në zyrat e AP në Prishtinë.

Të intervistuarit theksojnë se deri në fillimin e bombardimeve nga forcat ushtarake të NATO-s, ka pasur liri të kufizuar të lëvizjes, ndërsa gjatë bombardimeve janë përndjekur të gjithë nga Kosova së bashku me misionin e OSBE-së.

“Më 24 mars 1999, pas një viti intensiv të luftës në terren, kemi menduar se do të kthehemi në punë në zyrë. Kemi pasur parasysh rrezikun, sepse kanë qenë shënjestër gazetarët e Koha Ditore, meqë kanë sfiduar regjimin serb duke publikuar mjerimin dhe praninë e UÇK-së. Koha Ditore ka përgatit opinionin për atë që po pritet të ndodh në Kosovë, ka bërë rezistencë të ‘status quos’ që atë kohë ishte okupimi... Më datë 5 dhe 6 mars ’98, Koha Ditore ka shitur 70 mijë kopje. Ka pasur shumë impakt, është testament për kredibilitetin që ka treguar atë kohë, pavarësisht vështirësive për të raportuar ftohtë pa emocione atë periudhë, por e kemi arritur ta bëjmë.” (Garentina Kraja, Koha Ditore)

Gjatë vitit 1997, mediat ndërkombëtare bënë kohë pas kohe lajme për ngjarjet në Kosovë, por nuk kishin të vendosur prani të përhershme në vend.

“Në vitin 1997 është rasti i parë kur UÇK ka dalë publikisht. Më 5 mars 1998, kur ndodhi sulmi në Prekaz, disa nga mediat ndërkombëtare ishin prezente në Kosovë dhe qëndruan deri më 24 mars 1999, kur u përndjekën nga forcat serbe.” (Garentina Kraja, Koha Ditore).

Garentina Kraja ka pasur rastin të bashkëpunojë me korrespondentë ndërkombëtarë, si gazetarët Kurt Schork, Jacky Rowland, Paul Wood nga BBC, Marie Colvin nga Sunday Times dhe të tjerë. Ajo thekson më tej se me t’u informuar mbi ngjarjet në terren, së bashku me korrespondentët ndërkombëtarë shkonin në vendngjarje. Pikërisht, pasqyrimi i masakrave më të mëdha dhe zhvillimi i luftës në të gjitha zonat, u mbuluan nga korrespondentët ndërkombëtarë, gjë që ngriti interesimin e politikës ndërkombëtare për të parë Kosovën nga një këndvështrim paksa më ndryshe sesa deri atë kohë. Me informimin e opinionit ndërkombëtar, rol të rëndësishëm luajtën edhe organizatat humanitare ndërkombëtare dhe ato për të drejtat e njeriut, që shpërndanin lajmet për abuzimin dhe shkeljen e të drejtave të njeriut.

“Koha Ditore ka pasur partneritet me agjencinë e lajmeve Beta dhe B92. Kështu kemi kuptuar qëndrimet e palës serbe...kemi takuar njerëzit e parë të UÇK-së në fshatin Llaushë, por nuk kemi mundur t’i pyesim shumë kush kanë qenë, si janë të organizuar, sepse kemi pasur autocensurë në informacion, në mbledhje dhe në shkrime; shkrimet janë të shkruara me një metaforë, ka nëntekst ku nuk thuhet të dhënat troç, sepse kemi pasur frikë se mund të mbyllet gazeta, ndërsa njerëzit duhet me qenë të informuar. Mision i gazetës ka qenë të njoftojë opinionin publik, jo ta përshtaste lajmin me një agjendë të caktuar. E rëndësishme ishte të tregohej ajo që po ndodh në Kosovë, sepse ka qenë një terr informativ, ka pasur ditë që nuk kemi patur ide çfarë po ndodh në disa pjesë të Kosovës.” (Garentina Kraja, Koha Ditore)

Gjithashtu, është interesant fakti që në këtë moment ekziston një ndasi të mirëfilltë midis propagandës dhe marrëdhënieve me publikun (PR); ndonëse shpeshherë shumica e njerëzve këto dy fusha i vlerëson si të njëjta, por në realitet nuk janë. Edhe pse të dyja janë produkte mediatike dhe përfshihen në fushën e “opinion maker”, të dyja targetojnë një audiencë të caktuar dhe të dyja manipulojnë pritësin e mesazhit në veprimin e kërkuar; ato kanë një ndasi themelore që është e vërteta. Në rastin e propagandës kemi një mesazh të shtrembëruar që mund të ketë një farë vërtetësie ose jo dhe që jepet si mesazh për të manipuluar opinionin publik në një mënyrë ose në një tjetër. Ndërsa në rastin e PR-së kemi përhapjen e një mesazhi të vërtetë që realisht ndikon në ndërtimin e një marrëdhënieje besimi midis një organizate dhe produkteve të saj me audiencën e targetuar. Pika më e fortë që i dallon këto të dyja është fakti se mesazhi i PR-it është lehtësisht i vërtetueshëm, ndërsa ai i propagandës nuk ka shumë hapësirë për vërtetim. Por në rastin e vendeve në zhvillim ekonomik dhe destabilitet politik siç është Kosova, këto linja që janë në përgjithësi të qarta kthehen në problematike. Ajo çfarë është më interesante për t’u vënë re, është fakti se dhe vetë institucionet që janë mbartëset e këtij mesazhi nuk janë gjithmonë të qarta në tejçimin e këtij mesazhi. Kjo situatë bëhet akoma më intriguese në aspektin e Kosovës, që jo vetëm vjen nga një sistem politik komunist, por është dhe një vend relativisht i ri në aspektin e vetëqeverisjes.

Një prej hipotezave për lindjen e PR është se vetëm "ndikimi" i gazetarisë dhe presioni publik social frymëzuan profesionistët e PR për të përcaktuar fushën e tyre, që tregon ndikimin social dhe shoqëror. Presionet ishin faktorë me ndikim në fushën e marrëdhënieve publike, siç ishin pasiguritë e botës bashkëkohore, kriza ekonomike, konfliktet politike dhe luftërat, si dhe ndryshimi i klimës që kanë ndryshuar rrethanat ku PR aspiron të paraqesë legjitimitetin e raportimit. Vëmendja tani është kthyer në drejtim të të vënit në dyshim legjitimitetin e çdo raportimi dhe çdo veprimi. Ashtu si të gjitha vendimet shoqërore që janë vënë në provë në

ndikimin e opinionit publik, edhe marrëdhëniet publike luajtën një rol të madh në zgjidhjen e rasteve të interesave në shoqëri.

6.1 Roli i mediave

Mediat veprojnë si një kanal komunikimi dhe si një pjesëmarrës aktiv në procesin e reformave. Roli i dytë që ka luajtur, është ai që nëse nuk ka një program të komunikimit të qeverisë, media mund të krijojë programin e vet dhe mund të jetë pozitiv ose negativ. Pyetja për qeverinë është se si duhet ta përcjellë mesazhin e saj për median që ushtron një fuqi të madhe të pushtetit në çdo demokraci (Castells, 2000).

Qeveritë dhe administratat duhet të mësojnë që të tolerojnë dhe të vlerësojnë rolin e një medie të pavarur në procesin e reformës, si një kanal komunikimi. Efektiviteti i mediave në rolin e vetë si kanal komunikimi varet, megjithatë, nga gjendja e përgjithshme të mediave, si për realitetin dhe perceptimin e pavarësisë së saj. Ata që janë në sektorin publik duhet të aplikojnë një numër të parimeve dhe teknikave të përgjithshme gjatë komunikimit me mediat.

Qeveritë dhe grupet reformatore duhet të llojnë për mbështetjen e reformave të tyre. Të gjitha analizat në shtyp dhe kontaktet nuk duhet të jenë ngjarje të lajmeve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në mjedisin kompleks të medias në Evropën Qendrore dhe Lindore, ku ka diversitet të madh dhe një ambient të lirë për të gjithë, dhe ku media krijon vetë besueshmërinë e saj, duke shfaqur aftësinë e saj për të kritikuar në një mënyrë konstruktive (Castells, 2000).

Roli i historisë botërore në zhvillimin e marrëdhënieve me publikun ka rëndësi të madhe të studiohet për të kuptuar zhvillimet e tyre në shekullin XX. Gjysma e dytë e shekullit XIX tregoi fillimin e revolucionit industrial, që bëri të mundur lindjen e një nevojë të madhe për të menaxhuar marrëdhëniet e organizatave me palët e tjera, veçanërisht me klientët, por edhe me median dhe sferën publike. Nevoja socio-ekonomike për komunikim dhe ndërveprim në shoqëritë demokratike i dha mundësi lindjes së termit "marrëdhënie

publike" në fund të shekullit XIX. Megjithatë, nuk mund të kundërshtojmë se ndonëse si term përdoret në mënyrë të mirëfilltë, marrëdhëniet publike si një filozofi operative mund të kenë ekzistuar edhe më herët (Castells, 2000).

Qysh në vitin 1928, Bernays ka deklaruar se PR dhe propaganda janë të njëjta. Por konteksti në të cilin Bernays dhe Goebbels bënë këto deklarata është krejtësisht i ndryshëm (Baskin, Arnoff, 1992). Fakti bazë është se këto dy forma të komunikimit, të cilat ndërhyjnë në të gjitha proceset e komunikimit janë të ndryshme. Pas praktikave konkrete të komunikimit dhe të ndërtimit të marrëdhënieve me publikun në shtetet totalitare, fjala është për shtetet fashiste siç ishin Gjermania, Spanja dhe Italia, si dhe ato komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Ballkanit, pas deklaratave konkrete ideologjike të liderëve totalitarë, ishte e qartë se ideologjia e marrëdhënieve publike ishte e papërshtatshme për ideologji totalitare. Me fjalë të tjera, propaganda dhe marrëdhëniet me publikun nuk ndajnë të njëjtat vlera. Si rrjedhim, një përfundim logjik ishte se PR nuk ka të bëjë aspak me propagandën, ndonëse propaganda është vetëm një mjet, ka një vlerë ambivalente: nuk është as e keqe, por as e mirë.

Revolucionet sociale të dekadave të para të shekullit XX, bënë një ndarje të të gjitha kombeve në dy sisteme politike, demokraci dhe totalitarizëm, ndarje e cila vazhdoi deri në vitet 1990. Çdo sistem politik ka gjithmonë ideologjitë bazë që janë bazuar në vlerat kryesore mbi të cilat është ndërtuar vetë sistemi; Sartori identifikon gjashtë kushtet më të rëndësishme të një shoqërie totalitare që janë ideologjia zyrtare, vetëm një parti në masë të kontrolluar, një qeveri me kontroll monopolist apo vendosur në bazë të ushtrisë (forcat e armatosura), një qeveri me kontroll monopolist apo vendosur në bazë të kontrollit të masmedias, një sistem policor terrorist dhe një ekonomi e menaxhuar nga qendra (Sartori, 1987).

Colin Sparks në studimin e tij mbi komunizmin, kapitalizmin dhe mediat masive, argumenton se marrëdhënia e shoqërisë me masmedia karakterizon dallimin në mes të një

shoqërie komuniste dhe një shoqëri kapitaliste demokratike (Baskin, Arnoff, 1992). Për më tepër, në një shoqëri demokratike, ekonomia dhe politika janë të ndara. Ana ekonomike përfaqësohet zakonisht nga interesat private dhe politikanët i përqendrojnë përpjekjet e tyre te interesi publik dhe mirëqenia publike. Kontrolli dhe pushteti janë të ndarë në mes grupeve shoqërore në një shoqëri demokratike (Baskin, Arnoff, 1992).

Gjatë mesit të shekullit XX, e veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, shtetet totalitare gradualisht u bënë më të mbyllura dhe u zhvendosën drejt entropisë. Kontrasti bazë ishte mjedisi social i shteteve demokratike të bazuar në lirinë e fjalës, transparencës, zgjedhjeve të lira dhe në elementë të tjerë demokratikë që ndikuan në krijimin e një mjedisi më elitare e gjithëpërfshirës (Lauritin, Vihalemm, Rosengren, Weibull, 1997).

Propaganda mund të shërbejë për t'i mbledhur njerëzit pas një arsyeje, apo një kauze, por shpesh me koston e ekzagjerimit, shtrembërimit, ose madje edhe duke gënjyer në lidhje me çështjet në mënyrë që të fitohet mbështetja e synuar. Ndërsa, nga ana tjetër, PR, kërkon një pjesëmarrje të drejtpërdrejtë nga masmedia dhe qytetari.

Ndonëse çështja e propagandës shpesh është diskutuar në kontekstin e militarizmit, luftës dhe luftë-mbështetjes, ajo është rreth nesh në të gjitha aspektet e jetës.

Duke përdorur një gamë të ngushtë të ligjërimit ku gjykimet janë bërë më të shpeshta, ndërsa kufiri i vet ligjërimit ose kuadri brenda të cilit janë formuar opinionet, as që diskutohet fare, por anashkalohet si një raportim i drejtpërdrejtë i fakteve. Fokusi i ngushtë pastaj ndihmon për t'u shërbyer interesave të propagandistëve. Në disa nga seksionet e mëposhtme shohim se si propaganda është përdorur në mënyra të ndryshme duke zgjeruar listën e mësipërme të taktikave dhe pajisjeve (Baskin, Aronoff, 1992).

Ottosen-i identifikon disa faza kryesore të një fushate ushtarake për të zbutur opinionin publik përmes medias, në përgatitje për një ndërhyrje të armatosur. Këto faza kanë të bëjnë me portretizimin e vendit në fjalë në lajme dhe me mënyrën se si portretizohet, duke rritur

shqetësimin për shkak të varfërisë, diktaturës dhe anarkisë. Fazë tjetër është arsyetimi, gjatë të cilit lajmi i madh është prodhuar për të dhënë ndihmë urgjente, si për shembull me rastin e ndërhyrjes së armatosur për të sjellë një rikthim të shpejtë të 'normalitetit'; Pason faza tjetër që është pasoja, gjatë të cilës situata normalisht është portretizuar për të paraqitur se si qetësia është kthyer në rajon, para se kjo edhe një herë të mos përmendet më në agjendën e lajmeve. Ushtria shpesh i manipulon mediat kryesore, duke kufizuar apo menaxhuar çfarë informacioni do t'i paraqitet publikut (Baskin, Aronoff, 1992). Kjo mund të përfshijë të gjithë gamën e veprimtarive duke filluar nga organizimi i seancave të mediave dhe njoftimeve të përditshme të shtypit, apo për të siguruar qasje të menaxhuar në zonat e luftës, duke siguruar në këtë formë edhe 'mbjelljen' e historisë. Si shembull mund të sjellim bombardimet e NATO-s mbi Serbinë, të cilat filluan 24 mars 1999, që nga disa kritikë vlerësojnë se janë shoqëruar apo janë mbuluar nga mediat kryesore që kanë impakt botëror, me njëanshmëri, mungesë objektiviteti ose një vështrim realist ndaj alternativave.

"Informacioni është monedha e fitores", thuhet në një publikim të ushtrisë së SHBA-së në manualin e ndërveprimit në terren, të vitit 1996. Nga perspektiva e një ushtrie, lufta për informacionin është një tjetër front në të cilën një betejë duhet luftuar. Megjithatë, ashtu siç kanë nevojë për të mashtruar kundërshtarët për të ruajtur mbështetjen publike, po ashtu edhe informacioni për publikun e tyre duhet pa dyshim të menaxhohet. Kjo ka kuptim nga pikëpamja ushtarake. Por, një situatë e tillë mund të çojë gjithashtu në papërgjegjësi dhe kur informacioni që paraqitet se është menaxhuar në binarë të tillë, në fund rezultati më i shpeshtë është propaganda. Beelman përshkruan se si kjo formë e ashtuquajtur Menaxhimi i Informacionit të Operacionit është përdorur për të menaxhuar informacionin (Baskin, Aronoff, 1992).

Lufta e Kosovës dhe ajo e Bosnjës u karakterizuan nga mbulimi sensacional, manipulues, i njëanshëm dhe nganjëherë i shtrembëruar të medias. Gazetari francez Jacques Merlino ishte një ndër të parët që ka analizuar fushatën sistematike propagandistike të luftës civile në Bosnjë.

Në vitin 1993, Peter Brock-u përshkruan mbulimin mediatik amerikan të luftës civile boshnjake në “Dateline Yugoslavia: The Partisan Press”, një publikim i tij në çështje të politikës së jashtme, e viteve 1993-1994, si vijon:

“Lexuesit dhe shikuesit kanë marrë raportet më të gjalla të mizorisë, tragjedisë dhe barbarizmit... Ky ishte një sulm i paparë dhe i paepur, duke kombinuar teknikat moderne të mediave me gazetarinë e avokimit ... media u bë një lëvizje, një bashkë-palë ndërluftuese me palët e tjera dhe nuk është më e maskuar si jopjesëmarrëse dhe jopartiake. Lajmet e publikuara gjatë luftës së Bosnjës dhe asaj të Kosovës kanë qenë shumë të detajuara dhe mizoria, terrori dhe barbarizmi janë bërë publike në mënyrën më të detajuar të mundshme... Qëllimi ishte i qartë, detyrimi i domosdoshëm i qeverive që të ndërhyjë ushtarakisht.”
(Peter Brock, “Dateline Yugoslavia, The Partisan Press”, publikuar në "FOREIGN POLICY", nr. 93, 1993-1994, faqe 152 – 172)

Është bërë kjo paraqitje, pasi Kosova që pas mbylljes së konfliktit, si një shtet relativisht i ri, është ende në forcimin e strukturave shtetërore dhe mënyrave se si ato bashkëpunojnë me median. Duke qenë se dhe sot e kësaj dite shumë nga shkollat e gazetarisë marrin si përvojë dhe bazë për përgatitje shkollën amerikane, atëherë është logjike që do të bien pre e të njëjtave praktika. Kjo pjesë bëhet akoma më shumë e rëndësishme pasi ndonëse në vendet e zhvilluara perëndimore është një praktikë e vendosur dhe ka shumë elementë që mundësojnë një zbatim të nocioneve bazë të ndryshimit mes Propagandës dhe PR-it, në vendet e brishta siç është Kosova, ose edhe vendet e tjera të ish-sistemeve diktatoriale, këto elemente ose mungojnë, ose janë të deformuar deri diku dhe funksionojnë me gjysmë kapaciteti (Baskin, Aronoff, 1992). Është interesante se ndonëse nocionet e gazetarisë janë të përfshira dhe bëhen në aspektin teorik, në zbatimin praktik ka shumë mangësi dhe në disa raste edhe injorancë. Sidoqoftë, kjo është një shoqëri në zhvillim dhe shumë elementë ndryshojnë nga viti në vit, por aktualisht ajo çfarë është paraqitur në vijim është realiteti aktual i tanishëm në Kosovë. Pas kësaj, kalohet në fazën e dytë të analizimit, që është pjesa e periudhës pas përfundimit të konfliktit dhe shpallja e Pavarësisë së Kosovës. Kjo pjesë është më së shumti e ndikuar edhe nga burimet e tjera të informacionit të cilat kalojnë në formë më zyrtare. Kjo është një prej etapave që ndryshojnë deri diku perceptimin se si po shihet Kosova.

Është interesante që deri më tani, ndikimi i vetëm vinte vetëm nga fikserët dhe mediat vendore, ndërsa tashmë kalon në një format të ri, ku shumica e informacioneve të referuara vjen nga ana e institucioneve ndërkombëtare, sikurse OSBE, UNMIK, si dhe burime të tjera zyrtare. Në këto momente kemi kalimin e ndryshimit të sferës së influencës nga një filtrim totalisht vendor, në një filtrim ndërkombëtar. Megjithatë, vazhdon të ekzistojë një pritshmëri në media për sa i përket Kosovës, edhe pse konflikti ka përfunduar, ajo përsëri vazhdon të shihet më tepër si një viktimë e rrethanave nga media ndërkombëtare, se sa si një aktore e drejtpërdrejtë në rrjedhën e ngjarjeve që vijnë.

Fakti më i qartë i këtij fenomeni është mënyra se si u miratua Kushtetuta e Kosovës, që i dha edhe sovranitetin Kosovës, si një shtet i ri. Duke qenë se Kushtetuta është elementi bazë dhe themelor që i jep kuptim sovranitetit, të gjitha vendet e mirëfillta e miratojnë këtë dokument me një votim popullor.

Sipas Fjalorit të drejtësisë së Bouvier-it, botimi i vitit 1856, '*shtet sovran*' e përkufizon atë vend që qeveris veten në mënyrë të pavarur nga çdo fuqi tjetër e huaj (Bouvier Law Dictionary, 1856).⁵⁶

Një përkufizim i sovranitetit sipas fjalorit etimologjik nënkupton "epërsi", si një fjalë që rrjedh nga shprehja anglo-franceze '*sovereynete*', që do të thotë autoritet, sundim, epërsia e pushtetit; Një qeveri mund të përgjigjet si shembull për kritikën nga qeveritë e huaja të mënyrës së trajtimit të qytetarëve të saj duke cituar të drejtat e tij të sovranitetit (Dictionary.com, 2015). Ky është përkufizimi i përgjithshëm i fjalës sovranitet. Ekziston edhe një nocion tjetër, që është ai i ligjit ndërkombëtar, i cili jep një përkufizim të ngjashëm, por njëkohësisht edhe shumë të ndryshëm nga ai i fjalorit të përgjithshëm. Sipas këtij fjalore, sovranitet do të thotë: zotërimi i pushtetit sovran; autoritet suprem politik; kontrolli i lartë i kushtetutës dhe kornizës së qeverisjes dhe administrimit të saj; burimi i vetëmjaftueshëm i fuqisë politike, nga i cili

⁵⁶ Linku: http://www.constitution.org/bouv/bouvier_s.htm , parë në gusht 2015

realizohen të gjitha fuqitë e veçanta politike; pavarësia ndërkombëtare e një shteti, e kombinuar me të drejtën dhe fuqinë e rregullimit të punëve të saj të brendshme pa diktatin e huaj; gjithashtu, një shoqëri politike, apo shtet, i cili është sovran dhe i pavarur.

Pra, në bazë të këtyre përkufizimeve më lartë duhet që legjitimiteti i sovranitetit të Kosovës të jetë në përputhje me normativat dhe ligjet ndërkombëtare, e të miratohet nga vetë popullata vendase. Por në të vërtetë kjo nuk është ajo çka ndodhi. Miratimi i Kushtetutës së Kosovës, që është dhe ligji themeltar i shtetit sovran, kaloi nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nuk ka marrë asnjëherë votim të drejtpërdrejtë nga populli i Kosovës. Më poshtë është paraqitur kronologjia e ngjarjeve që rrodhën deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të Kushtetutës, siç edhe janë të cituara në faqen elektronike zyrtare të Republikës së Kosovës.

Drafti i Kushtetutës së re të Republikës së Kosovës u përgatit dhe u publikua në muajin prill të vitit 2008. Shumë nga nenet e draftit të Kushtetutës së re u bazuan dhe rrodhën nga Plani Gjithëpërfshirës i Ahtisaarit, kështu që Kushtetuta u garanton të drejta të veçanta grupeve të minoriteteve dhe siguron një mjedis më të sigurt për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

17 Shkurt, 2008 – Kosova u shpall shtet sovran, i pavarur më 17 Shkurt të 2008, në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës. Deklarata e Pavarësisë ishte një Akt i Kuvendit të Kosovës si Institucion i Përkohshëm i Vetë-Qeverisjes, i pranuar unanimisht nga të gjithë anëtarët e pranishëm të kuvendit, 109 anëtarë. Deklarata e Pavarësisë u lexua nga Kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaqi.

2 Prill, 2008 – Komisioni Kushtetues miratoi tekstin e Projekt – Kushtetutës së Republikës të Kosovës. Po në këtë ditë u certifikua Projekt – Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

8 Prill 2008 – Kushtetuta e Republikës së Kosovës u nënshkrua nga Presidenti i Republikës së Kosovës në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, Prishtinë, Kosovë.

9 Prill 2008 – Draft - Kushtetuta e Republikës së Kosovës u ratifikua në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

15 Prill 2008 – Kushtetuta e Republikës së Kosovës u fuqizua plotësisht si akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës.

Para nënshkrimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si shtet Kosova qeverisej në kuadër të Kushtetutës së Përkohshme, bazuar në Rezolutën 1244 e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara. Kjo rezolutë më vonë u ratifikua në vitin 2001, çka fuqizoi Institucionet e Përkohshme të Vetë-qeverisjes, duke i lënë autoritetin final një Përfaqësuesi Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.⁵⁷

Kushtetuta e Kosovës, në preambulën e saj hapet me fjalët solemne: “Ne populli i Kosovës... në mënyrë solemne miratojmë këtë kushtetutë.” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008). Në këtë vështrim nuk vë në dyshim legjitimitetin e sovranitetit të Republikës së Kosovës, por ky legjitimitet nuk buron më nga ligji ndërkombëtar, pavarësisht miratimit final, por nga vetë media, e cila është e para që e popullarizoi dhe vendosi themelet e sovranitetit të Kosovës.

6.3 Pse Kosova në qendër të vëmendjes dhe jo Pakistani apo Tajvani?

Në vijim është paraqitur një vështrim i mënyrës se si Kosova u bë lajm ndërkombëtar, ku konflikti i saj nuk vështrohej më vetëm si çështje e brendshme, ndërsa Pakistani dhe Tajvani mbetën pothuajse në të njëjtin ritëm të raportimit dhe të vëmendjes në diplomacinë ndërkombëtare. Për të bërë një krahasim ndërmjet këtyre vendeve, tek pjesa e anekseve në fund të punimit, në një tabelë të veçantë janë paraqitur të dhënat e përmendjes së fjalëve kyçe ‘Pavarësi’, ‘Gjenocid’ dhe ‘Refugjatë’, në tre mediat kryesore në studim, krahasuar me Pakistanin dhe Tajvanin gjatë periudhës 1990-2012. Për të pasur të qartë arsyen e krahasimit të këtyre vendeve me Kosovën, në vijim është paraqitur një sfond historik i vendeve të lartpërmendura. Të dhënat historike janë marrë nga arkiva e tre mediave në studim.

Konflikti Pakistan - Indi një histori e shkurtër

⁵⁷Cituar nga portali elektronik zyrtar i RKS:

<https://www.rks-gov.net/sq-AL/Republika/Pages/Kushtetuta.aspx>, parë më 11 Gusht, 2015.

Qysh me ndarjen e nënkontinentit në vitin 1947, kur Britania shpërbëu perandorinë e saj indiane, India dhe Pakistani kanë qenë rivalë. Armiqësia e tyre i ka rrënjët e saj në religjion dhe në histori, ndërsa karakterizohet nga konflikti i gjatë që vazhdon dhe sot e kësaj dite, lidhur me përkatësinë e krahinave të Jammu dhe Kashmir.⁵⁸ Kjo ka përshkallëzuar kohët e fundit në një garë të rrezikshme të armëve bërthamore.

Emri i Pakistanit rrjedh nga një ide e sugjeruar për herë të parë në vitin 1933, kur një student, Chaudhuri Rahmat Aliu, propozoi që duhet të ketë një shtet të veçantë i cili do të përbëhet nga krahinat me shumicë myslimane në veri-perëndim, duke marrë parasysh dhe afërsinë demografike të gjakut princëror të personit në fjalë, do të përfshinte dhe krahinat e Jammu dhe Kashmir.⁵⁹ Emri është formuluar me domethënien e shkronjave të përshkruar në vijim nga P – Punjab, A-për afganët që banojnë në kufirin veri-perëndimor, K-për Kashmir, S-për Sind dhe Tan për të theksuar përkatësinë me Baluchistan. Në gjuhën urdu, fjala Pakistan gjithashtu do të thotë ‘vendi i pastër’. Ndarja e nënkontinentit megjithatë, çoi në një shpërngulje me dhunë të popullatës, qofshin këta myslimanët, sikh-ët apo hindutë, të cilët e gjetën veten në anën e gabuar të krahinave të ndarë të Punjab-it dhe Bengal-it. Ky i fundit u bë Pakistani Lindor. Sipas të dhënave të përgjithshme, rreth një milion njerëz kanë vdekur gjatë dhunës që u ushtrua për shpërnguljen komunale, ndërsa miliona të tjerë mbetën të pastrehë.⁶⁰ Jammu dhe Kashmir, një tërësi krahinash të rajoneve të ndryshme kulturore, u sollën formalisht nën sundimin e sikh-ëve në fillim të shekullit XIX.

Mbi 50 vjet më vonë, pakistanezët ende besojnë se Jammu dhe Kashmir duhej të ishin bërë pjesë e Pakistanit, për shkak se shumica e popullsisë së këtij shteti të përqendruar në luginën e Kashmirit, është e besimit mysliman. India, nga ana tjetër thotë se shteti i Jammu dhe Kashmir i përket Indisë. Duke u bazuar në dokumentin e hartuar në tetor të vitit 1947 për anëtarësimin e krahinave të ndara, Maharaja (sundimtari i krahinave në fjalë) më në fund ra dakord për t'u

⁵⁸ <http://www.bbc.com/archives/1990-2012/india/pakistan.html>, parë në maj 2015

⁵⁹ <http://www.bbc.com/archives/1990-2012/india/pakistan.html>, parë në maj 2015

⁶⁰ <http://www.cnn.com/archives/1990-2012/india/pakistan.html>, parë në maj 2015

bashkuar me Indinë. Për herë të parë në gati 30 vjet, në maj të vitit 1999⁶¹, India filloi sulmet ajrore kundër forcave pakistaneze, duke përdorur si arsyetim faktin që Pakistani kishte shkelur kufirin administrativ në malet e Kashmirit, në veri të Kargilit (BBC, 1999).

Pakistani iu përgjigj sulmit duke vënë trupat e veta në gatishmëri të lartë dhe luftimet që filluan degjeneruan drejt një konflikti të drejtpërdrejtë në mes të dy shteteve.⁶² India disa herë ka pohuar se forcat e këmbësorisë veriore pakistaneze, duke përdorur si bazë pjesën Sinde të administruar nga Pakistani, ishin të angazhuar në operacionet, një pretendim të cilin Pakistani e ka mohuar vazhdimisht. Ky vend iu përgjigj këtyre akuzave duke këmbëngulur që forcat që gjendeshin në atë pjesë ishin "luftëtarë të lirisë" të cilët luftonin për të çliruar nga administrimi indian krahinat e Jammu-t dhe Kashmir-it. Në kulmin e konfliktit, mijëra predha janë gjuajtur gati çdo ditë dhe India nisi sulmet ajrore. Kryqi i Kuq raportoi se së paku 30 000 njerëz ishin të detyruar të linin shtëpitë e tyre në anën pakistaneze të Linjës së Kontrollit. Korrespondentët raportuan se rreth 20 000 njerëz shkuan refugjatë në anën indiane.

Të dyja palët deklaruan fitoren e konfliktit që përfundoi kur nën presion nga Shtetet e Bashkuara, kryeministri Nawaz Sharif u bëri thirrje forcave ndërhyrëse për t'u tërhequr.

Në tetor të vitit 1999, gjenerali Pervez Musharraf udhëhoqi një grusht shteti ushtarak në Pakistan⁶³, duke rrëzuar në këtë mënyrë qeverinë e zgjedhur me votën e popullit dhe kryeministrin Nawaz Sharif. Ky grusht shteti i Gjeneralit Musharraf për marrjen e pushtetit u legjitimua më vonë nga Gjykata e Lartë e Pakistanit brenda një periudhë prej tre vjetësh. Megjithatë, grushti i shtetit u dënua nga komuniteti ndërkombëtar i cili bëri thirrje për zgjedhje dhe një kthim të menjëhershëm në qeveri civile. Pavarësisht kësaj, konflikti midis këtyre dy shteteve vazhdon dhe sot e kësaj dite.

Një histori e shkurtër e marrëdhënieve Tajvan - Kinë

⁶¹ <http://www.cnn.com/archives/1990-2012/india/pakistan.html>, parë në maj 2015

⁶² <http://www.Reuters.com/archives/1990-2012/india/pakistan.html>, parë në maj 2015.

⁶³ <http://www.Reuters.com/archives/1990-2012/india/pakistan.html>, parë në maj 2015.

Tajvani është një ishull prej 23 milion banorësh, që gjendet në bregdetin jugor të Kinës. Ky ishull iu la Japonisë në vitin 1895 dhe është qeverisur si një koloni japoneze deri në vitin 1945.⁶⁴ Japonia hoqi dorë zyrtarisht nga qeverisja e këtij ishulli në vitin 1952. Në vitin 1949, Partia Nacionaliste Chiang Kai-shek, i cili kishte qeverisur Kinën për dekada të tëra dhe mori pjesë në konferencat e pas-luftës si përfaqësues të Kinës, iku në Tajvan pas humbjes së luftës civile dhe fitores së komunistëve. Por Chiang këmbënguli që Kuomintangët e tij (KMT) ose partia nacionaliste, të vazhdonin të ishin përfaqësuesit e popullit të tij. Uashingtoni dhe shumica e fuqive perëndimore që ishin aleatë me qeverinë Chiang gjatë luftës kundër Japonisë, e legjitimuan këtë qeveri dhe refuzuan të njohin qeverinë komuniste në Pekin, si qeveri legjitime të Kinës. Partia e Chiang, KMT, parashtrroi programin e saj si alternativë ndaj sundimit komunist dhe shpreson ende që një ditë të kthehen në pushtet në Pekin. Kësaj situate iu dha fund kur politika e jashtme e administratës së Niksonit çoi në ndryshime në politikën amerikane që përfundimisht rezultoi në njohjen formale të Republikës Popullore të Kinës në vitin 1979 ("One China Notion", 1990).⁶⁵

KMT ka qeverisur Tajvanin nga viti 1949 deri në vitin 2000, shpesh në mënyrë të ashpër, duke vendosur edhe ligjin ushtarak. Ligjet diskriminuese kundër tajvanezëve që kanë banuar në këtë ishull që para vitit 1949 dhe shtypja e disidencës politike ishte një gjë e zakonshme gjatë kësaj periudhe. Pas gati dyzet vjetësh, ligji ushtarak u hoq në vitin 1987. KMT historikisht e ka parë Tajvanin si një pjesë e "One China" dhe nuk e mbështesin pavarësinë tajvaneze. Pas vitit 2000, KMT ka qenë shpesh në kundërshtim me partitë që përfaqësojnë tajvanezët që kishin jetuar në ishull që para vitit 1949 dhe pasardhësve të tyre.⁶⁶ Por, KMT edhe pse karakterizohet nga një fraksionizëm i brendshëm ndërmjet anëtarëve të vet, mbetet një parti e fuqishme dhe kundërshton fuqishëm lëvizjet që çojnë drejt pavarësisë së ishullit.

⁶⁴ <http://www.bbc.com/archives/1990-2012/china/taiwan.html>, parë në maj 2015

⁶⁵ <http://www.bbc.com/archives/1990-2012/china/taiwan.html>, parë më maj 2015

⁶⁶ <http://www.bbc.com/archives/1990-2012/china/taiwan.html>, parë më maj 2015

Në vitin 2008, KMT i fitoi të dyja zgjedhjet, legislative dhe ato presidenciale. Rivali kryesor KMT-së, Partia Progresive Demokratike (DPP), themeluar në vitin 1986 për të kundërshtuar KMT dhe vetëm u bë i ligjshëm në vitin 1989, pasi ligji i vjetër që ndalonte krijimin e partive opozitare u hoq. DPP ka si bazë të programit të vet që ta shohë Tajvanin si një komb të pavarur, të ndarë nga Kina. Sovraniteti i Tajvanit është çështja e parë dhe më themelore në platformën elektorale të kësaj partie.

Lëvizja e Pavarësisë në Tajvan

Edhe pse në Tajvan shumë janë mbështetës të idesë së pavarësisë, sondazhet sugjerojnë se ata janë të tërhequr dhe jo shumë entuziastë në realizimin e kësaj ideje. Të rinjtë tajvanezë, në veçanti, priren të jenë pragmatikë dhe me mendje të hapur kur bëhet fjalë për marrëdhëniet ndërshtetërore.

Që nga momenti kur KMT u zgjodh në pushtet në vitin 2008, afrimi i presidentit Ma me qeverinë e Pekinit ka nxitur protesta pro pavarësisë. Presidenti Ma premtoi integrim më të madh ekonomik me Kinën për tajvanezët si një mënyrë për të rritur ekonominë, por efektet e recesionit ekonomik global janë ndjerë rëndë në Tajvan dhe e kanë dëmtuar pjesën më të madhe të mbështetjes së publikut ndaj presidentit të vendit. Megjithatë, disa analistë thonë se recesioni në Tajvan do të ishte shumë më i rëndë po të mos ishte për rritjen e volumit të tregtisë me Kinën.⁶⁷ Ata parashikojnë që përfitimet ekonomike nga rritja e volumit të tregtisë me Kinën, në kuadrin ekonomik afatgjatë, do të çojnë në rritjen e mbështetjes publike për lidhje më të ngushta ekonomike me kontinentin.

Ishulli dhe OKB-ja

Si bazë themelore për të mbijetuar i pavarur nga kontinenti komunist, Tajvani konsideron marrëdhëniet diplomatike me bashkësinë ndërkombëtare. Pavarësisht nga përpjekjet e Tajvanit për të pasur më shumë mbështetje, më shumë se tridhjetë vende e kanë kaluar fokusin e marrëdhënieve të tyre diplomatike në Pekin. Ky transferim ndodhi në momentin kur Shtetet e

⁶⁷ <http://www.cnn.com/archives/1990-2012/china/taiwan.html>, parë më maj 2015

Bashkuara të Amerikës transferuan marrëdhëniet diplomatike nga Tajvani në Kinë, në vitin 1979. Rreth 24 qeveri mbajnë ende lidhje të plota diplomatike me qeverinë Tajvaneze.⁶⁸ Trendi në këtë konkurs për njohjen ose jo të pavarësisë, është në pjesën më të madhe një reagim ndaj premtimeve të ndihmave zhvillimore apo kërcënimeve me sanksione ekonomike, nga i ashtuquajtur libër xhepi i diplomacisë (Forbes, 2012). Media më popullore në fushën e financave, *The Economist*, vëren se që nga momenti kur Ma zgjidhet si president i vendit, të dyja palët kanë pushuar lojën për të marrë mbështetjen nga vendet ndërkombëtare për njohjen ose jo të Pavarësisë së Tajvanit.

Sipas ish-presidentit Chen, qeveria tajvaneze ka pasur si objektiv në luftën e saj për njohjen e pavarësisë, jo pavarësinë, por rimarrjen e pozitës së saj në Kombet e Bashkuara, të cilën ajo humbi me hyrjen e Kinës në këtë organizatë në vitin 1971 (Forbes, 2012). Kina argumenton se "përfaqësimi i Kinës në Kombet e Bashkuara sigurisht përfshin edhe Tajvanin", por Tajvani ngulmon se Rezoluta 2758 po përdoret si një armë për ta përjashtuar Tajvanin nga mundësia e përfaqësimit në OKB. Përpjekja e fundit e Tajvanit për të rifituar një vend në OKB, përmes një referendumi kombëtar në mars të vitit 2008, u kundërshtua publikisht nga Shtetet e Bashkuara, Rusia, dhe shtete të tjera, dhe u refuzua nga votuesit tajvanezë. Megjithatë, pjesëmarrja e fundit e Tajvanit si vëzhgues në Asamblenë Botërore të Shëndetësisë, është një hap i rëndësishëm. Analistët thonë se ka të ngjarë që Tajvani përfundimisht të fitojë statusin e vëzhguesit në shumë agjenci të OKB-së, por paralajmërojnë se ka një "kufi të caktuar për të, dhe se nuk dihet se sa Kina do të pajtohet me panoramën që Tajvani po vepron si një shtet i pavarur."⁶⁹

Është parashtruar ky sfond historik i këtyre dy vendeve, pasi që janë situata që kanë një ngjashmëri me Kosovën dhe në një aspekt më të gjerë kanë gati të njëjtin zhvillim historik sikurse Kosova. Pjesa më e rëndësishme që përpiqemi të evidentojmë, janë pikërisht ngjashmëritë e tyre.

⁶⁸ <http://www.Reuters.com/archives/1990-2012/china/taiwan.html>, parë më maj 2015.

⁶⁹ <http://www.Reuters.com/archives/1990-2012/china/taiwan.html>, parë më maj 2015.

Nëse bëjmë një tabelë krahasimi ndërmjet tyre, do të shohim se këto tre vende kanë tipare të ngjashme, pra janë vende të shkëputura nga shteti amë, nën administrimin e një pale të tretë (në rastin e konfliktit mes Pakistanit dhe Indisë, fokusi është i vendosur tek krahinat, jo tek shtetet që po i kontestojnë ato); vende që gëzojnë një lloj autonomie në periudha të ndryshme historike, vende me një territor dhe një popullatë të vogël dhe si pasojë, vende që influencën më të madhe në politikat e tyre e luan politika ndërkombëtare dhe ajo vendore. Pjesa kyçe e ngjashmërive është se që të gjitha këto vende kanë një të përbashkët, duan të jenë të pavarura. Ndërsa, pikërisht këtu përfundojnë ngjashmëritë politike ndërmjet këtyre tri vendeve.

Kosova e fitoi pavarësinë dhe sovranitetin si shtet, ndërsa krahinat e Jammu dhe Kashmir-it, si dhe ishulli i Tajvanit, janë ende nën të njëjtin sovranitet. Për më tepër, mund të themi se pikërisht këto dy situata, janë arsyeja kryesore që Kina dhe India nuk pranojnë të njohin pavarësinë e Kosovës. Në vijim, tek pjesa e anekseve (shtojca 3), është bashkëngjitur tabela që paraqet përmendjen e Kosovës krahasuar me dy vendet tjera, të ndara sipas epiteteve pavarësi gjenocid/përndjekje dhe refugjatë, për periudhën kohore 1990-2012.

Për të ilustruar impaktin që media pati në arenën ndërkombëtare, në tabelën në fjalë është pasqyruar se si është raportuar Kosova krahasuar me dy vende të tjera të cilat deri diku ndajnë të njëjtën situatë sikurse Kosova në arenën ndërkombëtare dhe të cilat kanë kaluar kriza në të njëjtën periudhën si Kosova. Duke u nisur nga të dhënat statistikore, mund të vihet re se si fokusi i këtyre tri mediave ndërkombëtare është i përqendruar më së shumti në situatën që ndodhi në Kosovë. Kjo jo vetëm për shkak të faktorit human dhe gjenocidit që po përjetonte vendi, por edhe sepse informacioni që vjen nga Kosova është më i drejtpërdrejtë dhe pasqyron realitetin e palës së dëmtuar.

Mënyra e drejtpërdrejtë e infiltrimit të këtij informacioni, bën që edhe media të asociohet me vendin në fjalë dhe duke fokusuar përqendrimin më të madh të mundshëm pikërisht tek Kosova, ajo bën që edhe opinionin publik ta kthejë fokusin e vet nga ky vend.

Informacioni i vazhdueshëm dhe i drejtpërdrejtë nga Kosova, besohet se solli dhe krijimin e një ndjenje simpatie tek opinionin publik dhe në këtë mënyrë ndikoi drejtpërdrejtë në krijimin e perceptimit lidhur me këtë vend (Jaramillo, 2009). Nisur nga ky perceptim, opinionin publik kthehet në një aktor të drejtpërdrejtë në konfliktin që po zhvillohet.

Duke e parë luftën në Kosovë si një përndjekje e të pafajshmëve pa shkak, apo edhe nga këndvështrimi mediatik, si spastrim etnik, ky opinion publik kthehet në një forcë ndërvepruese dhe ushtron një tryzni të drejtpërdrejtë ndaj organeve autoritare vendore..

Duke qenë se për shkak të zhvillimit të madh të teknologjisë që ka në dispozicion media mund të arrij deri në cepat më të largët të botës dhe njëkohësisht ka dhe aftësinë që të ndërveprojë dhe të ushtrojë ndikim jo vetëm brenda sferës vendore të influencës, por edhe asaj të jashtme, impakti që ka ndaj opinionit publik nuk kufizohet vetëm brenda territorit nacional që i përket, por zgjerohet edhe më shumë në sferën ndërkombëtare.

Në sajë të teknologjisë dhe zhvillimeve të fundit, aftësia e shpërhapjes së informacionit qoftë nëpërmjet formave të mëparshme tradicionale të medias, qoftë atyre bashkëkohore, u shtohet dhe një element tjetër që është ndërveprimi që ekziston midis mediave të transmetimit dhe mediave sociale. Është pikërisht ky dualitet që rrit më së shumti influencën dhe ndikimin e medias në arenën ndërkombëtare, që njëherazi është edhe një influencë gjithmonë e më shumë në rritje. Duke u bashkërenduar këto dy forma dhe duke mbuluar njëra-tjetrën, njëra palë me përshkrimin e informacionit dhe pala tjetër me komentimin dhe analizimin e situatës në zhvillim, ky dualitet arrin të ketë një impakt gjithmonë e më të madh. Ndërsa, duke parë mënyrën se si po avancon teknologjia, ky është një ndikim që do të rritet gjithmonë e më shumë.

Pavarësisht se nga analizat të dhënat janë sistematike dhe japin një tablo të qartë se ku është fokusuar interesi i medias, si dhe arsyet se pse ekziston një interes kaq i madh (nuk mund të anashkalojmë në këtë analizë edhe faktin që media është gjithashtu një biznes dhe lajmet më të shitura janë lajmet e luftës dhe fatkeqësive), prapëseprapë ekziston një mospërputhje në atë çka

pasqyron interesin e medias. Të tre vendet ndajnë një situatë të ngjashme politike. Ndonëse mund të kenë disa dallime të vogla në kontekstin historik, sfondi i ngjarjeve është shumë i ngjashëm; megjithatë dy vendet e tjera shpërfillen në krahasim me Kosovën. Për më tepër, është vetë media ajo që bëhet avokati më i madh i Kosovës, që ndjek zhvillimet e këtij vendi qysh nga fillimi i konfliktit e në vazhdim.

